

2024-2025



**UTICA
COMMUNITY
SCHOOLS**

**DORACAKU PER
PRINDERIT DHE NXENESIT**

SHERBIMET E NDIHMES GJUHESORE

Shërbimet e ndihmës gjuhësore për çështjet në lidhje me qarkun shkollor të UCS, janë në dispozicion të familjeve LEP (me Njohuri të Kufizuara të Gjuhës Angleze) që kanë nevojë ose kërkojnë mbështetje për të komunikuar (folur, lexuar, shkruar ose kuptuar gjuhën Angleze). Këto shërbime ofrohen falas nga Qarku dhe përfshijnë ndihmën me përkthimin dhe interpretimin.

Një kërkesë e juaja për ndihmë gjuhësore konfirmon që ju keni një nevojë të tillë. Verifikimi i mëtejshëm nuk është i nevojshëm.

Për informacion ose për të kërkuar shërbimet ju lutemi na kontaktoni:

translations@uticak12.org
(586) 797 – 6946.

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT THELBESORE

Si pjesë e planit strategjik, Ekipi Drejtues Ekzekutiv i Shkollave Komunitare të Utikës bashkëpunoi me Bordin e Arsimit për të rivlerësuar dhe rigjallëruar vizionin, misionin dhe vlerat tona për të pasqyruar më mirë të ardhmen e qarkut shkollor. Vizioni dhe deklaratat e misionit të mëposhtëm u miratuan nga Bordi i Arsimit i UCS më 15 gusht 2022.



VIZIONI

Përkufizimi: Një shprehje kolektive e aspiratave të një organizate.

Shkollat Komunitare të Utikës, në partneritetet me komunitetin tonë, do të fuqizojnë nxënësit për të transformuar pozitivisht të ardhmen e tyre dhe shoqërinë.



MISIONI

Përkufizimi: Një vështrim i përgjithshëm i hapave për të arritur vizionin e ardhshëm të një organizate. Shkollat Komunitare të Utikës ndezin pasionin për të mësuar tek të gjithë nxënësit. Ne forcojmë komunitetin tonë duke mirëpritur të gjithë nxënësit, duke respektuar kulturën dhe duke frymëzuar zhvillim dhe arritje të jashtëzakonshme.

Ne e arrijmë këtë nëpërmjet:

- Vendosjes së nxënësve në qendër të të gjitha vendimeve
- Bashkëpunimit me të gjitha palët e interesuara
- Sigurimit të një mjedisi të sigurt dhe mbështetës
- Inkurajimit të mendjeve që janë të hapura për inovacion
- Transformimit të shkollës në versionin e saj më të mirë të mundshëm.
- Promovimit të standardeve të larta në të gjitha Shkollat Komunitare të Utikës
- Angazhimit në drejtim të përsosmërisë dhe arritjeve për të gjithë

VLERAT THELBESORE

Përqendrimi tek nxënësi

Ne do të sigurohemi që nevojat individuale dhe kolektive të nxënësve janë parësore në marrjen e vendimeve.

Mundësite e Barabarta

Ne do të ofrojmë për nxënësit, familjet dhe personelin përvojat dhe burimet që u nevojiten për të përparuar.

Bashkëpunimi

Ne do të angazhohemi, të bashkëpunojmë me nxënësit, familjet, anëtarët e stafit dhe komunitetin në përgjithësi, për të arritur qëllimet tona.

Mirëqenia

Ne do të promovojmë mirëqenien e përgjithshme (shëndetin mendor, social dhe fizik) për të gjithë nxënësit dhe anëtarët e stafit.

Përsosmëria

Ne angazhohemi për sigurimin e cilësisë më të lartë për çdo ndërveprim, përvojë dhe produkt pune.



TABLE OF CONTENTS

VIZIONI YNE K-12 PER PERSOSMERI

AKADEMIKE	8
Cikli Fillor	8
Cikli i Lartë Fillor	9
Cikli i Mesëm i Ulët	9
Cikli i Mesëm	10
Arritje Studentore të Jashtëzakonshme	11
Shkolla Fillore	11
Programi “Young Fives”	14
Programi “Montessori”	14
Programi SACC School Age Child Care	14
Shkolla e Mesme	15
Junior High	15
Programi Mësimor i Shkollës së Mesme	15
Kërkesat për Diplomim	16
Programet e Specialitetit	17
Akademia e Utikës për Studimet	
Ndërkombëtare Gene L. Klida	17
Qendra e Utikës për, Matematikën,	
Shkencën dhe Teknologjinë	17
Qendra e Utikës për Shkencën dhe	
Industrinë	18
Akademia Stevenson e Fabrikimit,	
Automatizimit dhe Projektimit	18
Akademia e Shëndetit dhe Shërbimeve	
Njerëzore	19
Aktivitetet Jashtëshkollore	19
Asamblatë dhe Eventet	20
Programet e Mbrëmjes në Shkollat Junior	
High	20
Mbrëmjet e Vallëzimit	20
Shoqëria Kombëtare e Nderit	21
Atletika	21
Sportet për ciklin shkollor “Junior High”	22
Kriteret e Pranimi në Atletikë për “Junior	
High	23
Sportet në High School	24

Kriteret e Pranimi në Atletikë për “High	
School”	25
Burimet e Kritereve të Pranueshmërisë	27
Transporti në Ditën e Ndeshjes	28
Shërbimet për Nxënësit	28
Këshillim në Shkollë	28
Ligji “McKinney-Vento” i Ndhmës për të	
Pastrehët	29
Programet për Nxënësit e Gjuhës	
Angleze	29
Njoftimi i Nenit 504	30
Njoftimi i Arsimit Special / Child Find	30
Burimet Komunitare	31
Sigurimi në Shkollë	31
Autorizimi për Punë	32
BASHKEPUNIMI ME PRINDERIT	
SIGURON SUKSES	33
Si të Ndhmoni Fëmijën Tuaj të Mësojë	33
Përgatitja dhe Aftësitë që Sigurojnë	
Sukses	33
Komunikimin i Prindërve me Shkollën	34
Të Rejat nga Qarku dhe Shkolla	34
PowerSchool	35
Pasqyra Periodike e Notave	35
Përiudhat e Vlerësimeve	36
Pasqyrat e Notave	36
Sistemi Qarkor i Vlerësimit	37
Konferencat Prindër-Mësues	37
Xello	38
Për Pyetje ose Shqetësime Kontaktoni	38
Përfshirja e Prindërve në Arsimim	38
Fondet Federale “Title I”	40
Ligji për të Drejtat e Arsimimit dhe	
Privatësisë Familjare	40
Forcat e Armatosura të Shteteve të	
Bashkuara	42
Agjencitë dhe Institucionet e Tjera	42
Respektimi i Kërkesave	43
Mosha Madhore	43

Inspektimi i Materialeve Mësimore nga Prindërit/Kujdestarët	43	Njoftimi Paraprak për Aplikimin e Pesticideve	56
Privatësia e Nxënësve dhe Qasja e Prindërve tek Informacioni	43	Shërbimet Ushqimore	57
Refuzimi i Edukimit Shëndetësor	44	Menytë	57
SIGURIA NE SHKOLLE	45	Formularët e Aplikimeve për Përfitimet Arsimore dhe Ushqimin	58
Vizitorët	45	Pagesa për Ushqimin	58
Kontrolli i Historisë Penale për Vullnetarët	45	Alergjitë Ushqimore	58
Armët në Mjediset, Pronat, Automjetet		Çfarë Pritet nga Nxënësit në Mensë	59
Shkollore ose Veprimtaritë e Sponsorizuara nga Shkolla	48	Udhëzime për Pushimin e Nxënësve të Fillores	60
Dispozitivët e Identifikimit të Nxënësve	48	Sendet e Humbura dhe të Gjetura	60
Udhëzime rreth Skedave Identifikuese të Nxënësve	49	TEKNOLOGJIA	61
Mbyllja Emergjente e Shkollave / Ditët me Mot të Ashpër	50	Udhëzimet për Teknologjinë:	61
Mesazhet Telefonike të Automatizuara	50	Pajisjet Elektronike Jo-Shkollore të Komunikimit	62
SHENDETI DHE MIREQENIA E NXENESIT	51	Protokolli i Përdorimit të Pajisjeve Elektronike në Testimet Shtetërore	63
Risorsat e UCS për Mirëqenien	51	Protokollet për Nxënësit	63
Promovimi i Shëndetit	51	Pasojat e Nxënësve për Shkeljen e Protokolleve	64
Mjekimi	52	Sigurimi i Pajisjes së Nxënësit	64
Kërkesat e Imunizimit	52	UDHETIMI PER DHE NGA SHKOLLA	66
Kontrolli i Dëgjimit, Shikimit dhe Dhëmbëve	53	Udhëtimi Këmbësor	66
Rikuperimi në Shtëpi	53	Udhëtimi me Bicikletë	66
Trajtimi i Aksidenteve	54	Udhëtimi me një Automjet Familjar	66
Informacioni i Kontaktit Emergjent	54	Nxënësit që Ngasin Automjetet	66
Ndërgjegjësimi rreth Konkusioneve	55	Transporti me Autobusë të UCS	67
Informacioni Shëndetësor	55	Informacion Rreth Autobusit	68
Syzet Mbrojtëse	55	Udhëzime rreth Udhëtimit me Autobus	68
Sigurimi për Nxënësin	55	PJESEMARRJA DHE SUKSESI I NXENESVE	69
Mbrojtja e Ambientit Shkollor nga Droga dhe Alkoli.	56	Frekuentimi	69
Njoftimi i Inspektimit për Asbest të Objekteve Shkollore	56	Raportimi i Mungesave	69
		Sëmurja Gjatë Orarit të Mësimit	70
		Dalja e Parakohshme nga Mësimi	70
		Mungesat e Paracaktuara	70

Mungesat dhe Detyrat e Prapambetura	70	Masat Disiplinore	92
Përditësimi i të Dhënave të Kontaktimit	71	Konsiderimet Para Zbatimit të Masës Disiplinore	92
Shkolla Filllore	71	Praktikat Restauruese	93
Shkolla e Mesme e Ulët	72	Masat Administrative	94
Mungesat e Tepërta	72	Pezullimi nga Shkolla	94
Shkolla e Mesme	73	Hetimet Policore	96
Rishqyrtimi i Kreditit	74	Transferimi i Rekordeve Disiplinore	96
Të Gjitha Shkollat e Mesme	76	Hazing	97
Mungesat e Pajustificuara dhe Pezullimet	76	Bullizmi në Përgjithësi dhe ai Kibernetik	97
		Bandat Studentore	98
		Raportimi i Shqetësimeve	98
KODI I SJELLJES SE NXENESIT	77	Rregullorja dhe Procedura e Ngacmimit	
Qytetaria	77	Seksual	99
Liria e Shprehjes	77	Armët, Sjellja Kriminale Seksuale, Zjarrvënia dhe Agresioni Fizik kundrejt një Punonjësi	99
Veshja dhe Paraqitja e Përshtatshme në Shkollë	79	Ri-Pranimi në Shkollë	101
Rregullat e Qarkullimit nëpër Korridoret e Shkollës	80		
Dollapët e Shkollës	80	RREGULLORJA E MOS-DISKRIMINIMIT	103
Përdorimi i Ligjshëm i Dollapëve të Shkollës	80	Raportimi i Shkeljeve	104
Kontrolli i Përmbajtjes së Dollapëve	81		
Disiplina	82		
Proçesi i Rregullt	83		
Sjelljet e Papranueshme / Veprimet e Ndaluar	85		

MIRESEVINI NE VITIN SHKOLLOR 2024 – 2025

Të dashur Prindër,

Përsosmëria është një traditë e trashëguar brez pas brezi në Shkollat Komunitare të Utikës. Ne e ruajmë këtë traditë duke siguruar për komunitetin një mjedis mësimor dhe mundësi që frymëzojnë nxënësit tanë për arritje të jashtëzakonshme. Vizioni, misioni dhe vlerat tona thelbësore qëndrojnë në bazë të së ardhmes së qarkut shkollor të UCS.

Një mjedis mësimor i sigurt dhe pozitiv për nxënësit është i domosdoshëm për suksesin tonë. Ne dëshirojmë që nxënësit tanë të jenë të motivuar dhe me një ndjenjë përkatësie.

UCS do të përparojë drejt këtij qëllimi duke vazhduar traditën e saj të ndërtimit të marrëdhënieve të forta me prindërit dhe kujdestarët. Ndihma juaj është një faktor thelbësor për arritjen e këtij qëllimi. Ju lutemi të familjarizoheni me informacionin, rregulloret dhe procedurat që përmban ky manual dhe të diskutoni përmbajtjen me fëmijën tuaj.

Ne shpresojmë në një partneritet të vazhdueshëm që frymëzon nxënësit tanë të punojnë për një të ardhme më të mirë për ata dhe për botën.

Sinqerisht,



Robert S. Monroe
Superintendent of Schools



Mary K. Thomas, Ph.D.
President, Board of Education

Bordi Arsimor

Mary K. Thomas, Ph.D. – President, Denyeal Nesovski – Vice President, Michele Templeton – Treasurer, Kelli Rankin – Secretary, Kimberly Becker – Trustee, Steven R. Meyer, Ph.D. – Trustee, Machele Fitzpatrick – Trustee, Robert S. Monroe – Superintendent of Schools

Vizioni ynë K-12 për përsosmëri akademike

Nga Kindergarten deri në klasën e 12^{të}

Planifikimi për sukses

Ju jeni një partner i rëndësishëm në planin tonë K-12 (*Kindergarten-12 grade*) për fëmijën tuaj. Ndërkohë që eksploroni mundësitë e ardhshme për fëmijën tuaj, në çdo nivel shkollor, duhet të mbani parasysh dhe të konsideroni disa aspekte të rëndësishme.

Cikli Fillor

Kindergarten dhe Klasat 1, 2, 3

Çdo gjë është e re! Mirë se erdhët në klasën tuaj K-12!

Disa pika të rëndësishme për tu konsideruar:

- Kontaktoni mësuesit nëse keni ndonjë pyetje gjatë vitit shkollor. Kalendari ynë ju ofron disa mundësi për të marrë informacion rreth përparimit dhe pritshmërisë që keni për fëmijën tuaj. Këto mundësi përfshijnë një Mbledhje të Hapur në Shtator, dëftesat (*report cards*) katër herë në vit dhe konferencat e mësuesve dhe prindërve në vjeshtë dhe pranverë. Nxënësit e kopshteve (*kindergarten*) do të testohen me NWEA (në vazhdim deri në klasën e 10-të) dhe nxënësit e klasës së tretë fillojnë Testimin Shtetëror të Michigan-it për Përparimin Arsimor të Nxënësve.
- “PowerSchool” është një mjet thelbësor për familjet për tu informuar rreth arritjeve të nxënësit të tyre. Aty bëhen të disponueshme dëftesat dhe rezultatet e NWEA dhe, duke filluar nga klasa e tretë, gjenden notat e afishuara nga mësuesit.
- Fëmijës tuaj do t'i ofrohet një iPad i qarkut për të mundësuar mësimin në kopsht dhe në klasën e parë. Ky iPad do të jetë gati për përdorim dhe do të përmbajë aplikacione që mësuesi do të përdorë për të zhvilluar mësimin gjatë vitit. Në klasën e dytë, fëmijës suaj do ti ofrohet një Laptop.

VIZIONI YNE K12

Çdo shkollë përdor sisteme komunikimi të tilla si email-i, text-i dhe telefonatat e automatizuara. Informacioni shpërndahet nëpërmjet PowerSchool.

Nëse nuk merrni lajmërimi rregullisht nga shkolla juaj ose nga qarku, ju lutemi të rishikoni dhe plotësoni informacionin në profilin tuaj personal në PowerSchool.

Cikli Fillor i Lartë

Klasat 3, 4, 5, 6

Prindërit duhet të fillojnë të eksplorojnë programet dhe shërbimet e specializuara të ofruara në UCS që janë të fokusuara në stilet dhe interesat unike të të mësuarit të fëmijës suaj. Zgjedhjet e bëra në ciklin fillor të lartë do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në kriteret e regjistrimit në shumë lëndë dytësore.

Gjithashtu, nxënësit e klasës së gjashtë kanë mundësinë të zgjedhin një lëndë elektive si muzika vokale ose instrumentale, edukimi fizik, arti dhe qendra e medias. Gjithashtu, familjet duhet të konsiderojnë me vëmendje programet e përparuara të matematikës që ofron qarku dhe ndikimin që ato do të kenë në regjistrimin e ardhshëm.

Cikli i Mesëm i Ulët

Klasat 7, 8, 9

Programet dhe shërbimet tona të shkollës së mesme të ulët bazohen në themelin e fortë elementar që u krijua tek nxënësi juaj në UCS. Programet e ciklit të mesëm do të ofrojnë më shumë mundësi për nxënësit që fillojnë të eksplorojnë qëllimet e tyre të karrierës.

PATHWAYS TO SUCCESS – është një veprimtari qarkore që u mundëson prindërve të UCS eksplorimin e opsioneve të shumta që kanë në dispozicion në qarkun e dytë më të madh shkollor të Michigan-it. Këtë vit, kjo veprimtari do të zhvillohet në datën 5 Dhjetor tek Shkolla e Mesme Henry Ford II.



VIZIONI YNE K12

Shkollat tona punojnë në bashkëpunim të ngushtë për vazhdueshmërinë e mësimin të përqendruar në shkollë.

Përzgjedhja e lëndëve bëhet çdo vit në fund të dimrit/fillimit të pranverës. Këshilltarët janë në dispozicion duke filluar nga cikli "Junior High" për të ndihmuar nxënësit me seleksionimin e programeve që do të mbështesin më së miri interesat e tyre në rritje për karrierën.

Duke filluar nga klasa e 9-të, nxënësit kanë qasje në programe specialiteti unike: Akademia e Utikës për Studimet Internacionale Gene L. Klida (*Gene L. Klida Utica Academy for International Studies*), Qendra e Utikës për Matematikën, Shkencën dhe Teknologjinë (*Utica Center for Mathematics, Science and Technology*), Qendra për Fabrikimin, Automatizimin dhe Inxhinierinë e Projektimit, Stevenson (*Stevenson Center for Manufacturing, Automation and Design Engineering*), dhe e sapokrijura, Akademia e Shëndetit dhe Shërbimeve Humane (*Utica High School Health and Human Services Academy*). Periudha e aplikimit fillon në fund të dimrit.

"Xello" është një mjet i fuqishëm në dispozicion të prindërve dytësorë. "Xello" është një faqe interneti gjithëpërfshirëse dhe e optimizuar për "Mobile", të cilën familjet mund ta përdorin për të bërë plane rreth kolegjeve dhe karrierës.

Cikli i Mesëm

Klasat 10, 11, 12

Prindërit duhet të njihen me kriteret e diplomimit të shkollës së mesme dhe ndikimin që ato kanë në diplomimin e fëmijës suaj. Për të përmbushur kriteret minimale për diplomim, duhet të fitohen gjithsej 22 kredite të shkollës së mesme; një gjysmë krediti ofrohet falas për çdo semestër. Përveç kësaj, nxënësit kanë qasje në një sërë klubesh dhe sportesh të ofruara nëpërmjet shkollave të tyre të mesme gjithëpërfshirëse.



akademike, profesionale dhe personale për të ardhmen."

Tejaswi Krishnan

"UCS më ka ofruar Risorsat dhe mbështetjen e nevojshme për suksesin tim. Mësuesit dhe bashkëmohatarët e mi gjatë gjithë kohës në qark më kanë ndihmuar të arrij qëllimet e mia

INSPIRING
Remarkable
ACHIEVEMENT

Arritje Studentore të Jashtëzakonshme

UCS ndërton tek nxënësit tanë një themel të fortë që shërben si bazë për diplomimin dhe zhvillimin e mëtejshëm. Arsimimi në UCS është një proces K-12 që i dedikohet frymëzimit për sukses, fuqizimit të nxënësve tanë dhe ndezjes së pasionit për arsimim.

Qarku ofron një larmi shërbimesh të cilat krijojnë një bazë të fortë, klasë pas klase, për rritjen e aftësive që mundësojnë meritimin e një diplome të UCS që njihet në nivel kombëtar.

Shkolla Fillore

Arritjet e nxënësve janë qëllimi kryesor i Shkollave Komunitare të Utikës dhe vijimi drejt Gatishmërisë për Kolegjin dhe Karrierën (*College and Career Readiness*) fillon në shkollën fillore. Programi mësimor i nivelit fillor është përshkruar shkurtimisht më poshtë. Nëpërmjet një programi mësimor rigoroz, nxënësit nxiten të arrijnë potencialin e tyre më të lartë dhe inkurajohen të marrin përgjegjësi për arsimimin e tyre.

Artet Gjuhësore

Programi i Arteve Gjuhësore u mundëson nxënësve zhvillimin dhe përvetësimin e aftësive të pavarura dhe strategjike të komunikimit oral dhe të shkruar, të nevojshme në shekullin e 21-të. Mësimi ditor në klasë përfshin:

- Leximin - Nxënësit instruktohen për shkrim dhe lexim të bazuar në materiale letrare dhe informative duke u përqendruar në kuptueshmërinë, fjalorin, gjuhën e folur, rrjedhshmërinë, tingujt, dhe aftësitë e referimit dhe studimit.
- Shkrimin - Zhanri dhe procesi i shkrimit mësohet nëpërmjet Kuadrit të Punës së Shkrimtarit. Nxënësit zhvillojnë aftësinë të kuptojnë llojet e ndryshme të shkrimit dhe shkruajnë një sërë pjesësh si Proza, Informacioni, dhe Opinioni.
- Studimi i fjalëve/Drejtskrimi - Nxënësit mësojnë strategji që u mundësojnë atyre të njohin, të shqiptojnë, të përdorin, të aplikojnë dhe të kuptojnë fjalët që ndeshen në fusha të ndryshme të përmbajtjes
- Shkrimi i dorës - Nxënësit fillojnë me shkrimin me shkronja shtypi dhe kalojnë në shkrimin e dorës, zakonisht në klasën e dytë dhe të tretë.

Matematika

Programi i matematikës i fillores përmban strategji dhe teknika praktike, të tilla si renditja, mbledhja e të dhënave, matja, përpunimi, prezantimi grafik dhe llogaritjet. Këto strategji ndihmojnë nxënësit të:

- Kuptojnë problemet dhe të vijojnë me zgjidhjen e tyre.
- Arsyetojnë në mënyrë abstrakte dhe sasiore.
- Modelojnë me matematikë dhe të përdorin mjetet e përshtatshme strategjiksht.
- Kuptojnë në thellësi si funksionon matematika duke e aplikuar në të gjitha fushat lëndore dhe ato të jetës së tyre.
- Lidhin mësimin e matematikës të të gjitha klasave me konceptimin algjebrik nëpërmjet përvojave të përshtatshme të matematikës në çdo klasë.

Për më shumë, nxënësit kanë në disponim materiale dixhitale për të mbështetur kuptimin e koncepteve matematikore.

Shkencat

Programi shkencor i UCS-së i kushtëzon nxënësit të bëjnë pyetje që të kuptojnë dhe të vlerësojnë botën që i rrethon. Gjithashtu i mëson nxënësit të gjejnë zgjidhje për problemet nëpërmjet aktiviteteve praktike dhe materialeve dixhitale, duke u bazuar në modelin mësimor "5E":

- Angazhohu (*Engage*)
- Eksploro (*Explore*)
- Shpjego (*Explain*)
- Përpuno (*Elaborate*)
- Vlerëso (*Evaluate*)

Studimet Sociale

Programi i studimeve sociale inkurajon nxënësit të bëhen qytetarë të pavarur, të përgjegjshëm dhe të kujdesshëm duke stabilizuar lidhjen mes tyre dhe familjeve të tyre me qeveritë lokale, shtetërore dhe kombëtare.

Programi mësimor mbulon:

- Histori
- Gjeografi
- Qytetari
- Ekonomi
- Kulturë

Qendra Mediatike

Në zemër të çdo shkolle fillore të UCS, është një qendër e pasur me teknologji në të cilën nxënësit mund të kërkojnë, konsultojnë, përmbledhin, organizojnë, analizojnë dhe vlerësojnë informacionin. Mësuesit e qendrës së mediave udhëzojnë nxënësit rreth mënyrave të përshtatshme të përdorimit të informacionit dixhital dhe teknologjisë së komunikacionit. Nxënësit mësojnë parimet e qytetarisë dixhitale dhe fillojnë t'i aplikojnë ato njohuri nëpërmjet përdorimit strategjik të mediave dixhitale. Mësuesit e qendrës së mediave orientojnë nxënësit në projekte të pavarura ose të përbashkëta me klasën duke përdorur një bibliotekë të pasur me literaturë dhe informacion, nga një gamë e gjerë autorësh, stilesh shkrimi, zhanresh dhe formatesh.

Edukimi Fizik

Qëllimi kryesor i programit të edukimit fizik në shkollat fillore të UCS është të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë dhe praktikojnë aktivitete që kanë një ndikim pozitiv gjatë gjithë jetës së tyre. Nxënësit prezantohen, nëpërmjet lojërave dhe aktiviteteve, me alternativa të shëndetshme të mënyrës së jetesës që promovojnë:

- Aktivitetin fizik
- Njohuritë për mirëqenien dhe formën fizike
- Aftësitë motore
- Punën ekipore
- Qëndrime dhe aftësi pozitive personale/sociale

Arti

Programi i artit i UCS promovon individualitetin e çdo nxënësi duke eksploruar pikë-vështrimet e shumta krijuese rreth një situatë të caktuar. Duke filluar me njohuritë bazë për ngjyrat dhe format në kopësht, programi elementar i artit lidhet me fushat e tjera të programit mësimor nëpërmjet mediave të ndryshme duke i prezantuar nxënësit me:

- Vizatimin
- Pikturën
- Litografinë
- Skulpturën
- Historinë e Artit
- Influcencën e artit në Kulturën Botërore

Muzika

Mësimi i këngës dhe ritmit, i përshtatshëm për nivelin/klasën, krijon kushtet për të gjithë nxënësit që të mësojnë stile të ndryshme muzikore, të zhvillojnë talentin e tyre dhe një interes të përjetshëm për një sërë aktivitete muzikore. Nxënësit e klasës së gjashtë kanë mundësinë të zgjedhin muzikën instrumentale dhe/ose vokale si lëndë elektive, gjatë gjithë semestrit.

Programi “Young Fives”

Programi i UCS “Young Fives” është në dispozicion të fëmijëve, ditëlindja e të cilëve bie brenda periudhës 1 Shtator – 1 Dhjetor. Këta fëmijë pozicionohen në bazë të një vlerësimi profesional të bërë nga qarku. Pasi fëmijët të mbarojnë një viti në “Young Fives” do të fillojnë “Kindergarten” në vjeshtë.

Pas përfundimit të një viti në “Young Fives”, nxënësit mund të fillojnë kopshtin (*Kindergarten*) në vjeshtën e ardhshme.

Programi “Montessori”

Shkollat Komunitare të Utikës ofrojnë një program “Montessori” në Shkollën Fillore Messmore.

Programi SACC “School Age Child Care”

Kujdesi për Fëmijët e Moshës Shkollore

“School Age Child Care” ofron një kujdes dhe mbikëqyrje cilësore për fëmijët para dhe pas shkollës në disa nga shkollat fillore. Programi zakonisht ofrohet nga ora 6:45 deri në kohën që fillon mësimi dhe pas shkollës deri në orën 6:00pm. (Oraret mund të ndryshojnë në disa vende. Për informacion dhe tarifa kontaktoni Qendrën Arsimore Komunitare të UCS (*UCS Community Education Center*).

VIZIONI YNE K12



Shkolla e Mesme

UCS është e angazhuar të përgatisë nxënësit tanë për suksese të mëtejshme pas diplomimit të shkollës së mesme, duke ofruar një program mësimor gjithëpërfshirës brenda një klime arsimore të sigurt dhe mbështetëse. Departamentet janë orientime drejt karrierave të mbështetura nga programet dhe shërbimet e UCS. Nxënësit i zgjedhin lëndët gjatë karrierës së tyre.

Junior High

Klasat 7, 8

Junior High School është koha kur nxënësit fillojnë të qartësojnë interesat dhe qëllimet e tyre të karrierës. Programi mësimor për nxënësit përfshin lëndët e Gjuhës Angleze, Matematikës, Shkencës, Shkencave Shoqërore, Edukimit Fizik dhe Shëndetësor, Gjuhëve të Huaja, Artit, Muzikës Instrumentale dhe Vokale, Arteve Teatrorë, Arsimit Teknik dhe të Karrierës.

Programi Mësimor i Shkollës së Mesme

Klasat 9, 10, 11

Hapat e parë drejt plotësimit me sukses të lëndëve që kërkohen për diplomim nga shkolla e mesme hidhen në klasën e nëntë, e cila është koha kur një nxënës fillon të fitojë kredite për diplomim. Nxënësit dhe prindërit e tyre duhet të kenë parasysh kriteret e Programit për Meritim dhe Diplomës (*Michigan Merit Curriculum*) të shtetit të Michigan-it kur zgjedhin lëndët për çdo semestër. Kini parasysh që, këto janë kërkesat minimale të shtetit dhe mund të mos përmbushin të gjitha kriteret e pranimit të disa institucioneve të arsimit të lartë. Të gjithë nxënësit janë të detyruar të marrin një program të plotë-ditor çdo vit.

VIZIONI YNE K12

KERKESAT PER DIPLOMIM

Lënda	Përshkrimi	Kurrikula Personale Klasat 10-12	Modifikime
English 4.0 Kredite	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. <ul style="list-style-type: none"> English 9 ose Honors English 9 English 10 ose Honors English 10 English 11 ose AP English Language & Composition English 12 ose AP English Literature & Composition EL English Niveli 1, 2, 3, ose 4 	Asnjë Opcion për Kurrikul Personale.	AP Seminar mund të zëvendësojë English 11 ose kërkesën për English 12 nëse AP Seminar mbahet nga një Mësues i Çertifikuar i Gjuhës Angleze
Mathematics 4.0 Kredite	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. <ul style="list-style-type: none"> Algebra I Geometry Algebra II Një kredit shtesë për matematikën ose një lëndë që lidhet me matematikën në vitin e fundit të shkollës së mesme. 	Për Opsionet e Kurrikulës Personale të Matematikës vizitoni UticaK12.org/GraduationRequirements . Shënim: Duhet të përputhet me Planin e Zhvillimit Arsimor	Nuk Modifikohet
Science 3.0 Kredite	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. <ul style="list-style-type: none"> Biology Chemistry ose Physics 1 Kredit shtesë për Science 	Asnjë Opcion për Kurrikulën Personale	Nuk Modifikohet
Social Studies 3.0 Kredite	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. <ul style="list-style-type: none"> 0.5 Civics 0.5 Economics U.S. History dhe Geography World History dhe Geography 	Të gjithë nxënësit Plotësojnë: <ul style="list-style-type: none"> 2 kredite në Social Studies, duke përfshirë Civics. Opsionet e Kurrikulës Personale. 1 Kredit shtesë në English Language Arts, Mathematics, Science ose në një gjuhë tjetër të ndryshme nga ajo Angleze, OSE 1- Career Technical Education Program (shih Shënimin V at UticaK12.org/GraduationRequirements). Shënim: Duhet të përputhet me Planin e Zhvillimit Arsimor 	Nuk Modifikohet
Health and Physical Education 1.0 Kredit	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit.	Të gjithë nxënësit Plotësojnë: <ul style="list-style-type: none"> 2 Kredite në Social Studies, duke përfshirë Civics. Opsionet e Kurrikulës Personale. 1 Kredit shtesë në English Language Arts, Mathematics, Science ose në një gjuhë tjetër të ndryshme nga ajo Angleze, OSE 1- Career Technical Education Program (shih Shënimin V at UticaK12.org/GraduationRequirements). Shënim: Duhet të përputhet me Planin e Zhvillimit Arsimor 	Kredit për Physical Education mund të jepet nëpërmjet një opsiioni përshatës për nxënësit që marrin pjesë në sporte jashtëshkollore ose aktivitete të tjera fizike të miratuara nga qariku
Visual, Performing, Applied Arts, CTE 1.0 Kredit	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. <ul style="list-style-type: none"> 1 Kredit duhet të jetë për lëndët e Visual, Performing, Applied Arts ose CTE 	Të gjithë nxënësit Plotësojnë: <ul style="list-style-type: none"> 2 kredite në Social Studies, duke përfshirë Civics. Opsionet e Kurrikulës Personale. 1 Kredit shtesë në English Language Arts, Mathematics, Science ose në një gjuhë tjetër të ndryshme nga ajo Angleze, OSE 1- Career Technical Education Program (shih Shënimin V at UticaK12.org/GraduationRequirements). Shënim: Duhet të përputhet me Planin e Zhvillimit Arsimor 	Nuk Modifikohet
Eksperienca e Mësimit On-line	Një lëndë ose eksperiencë e të mësuarit on-line është i përfshirë në secilin kredit të kërkuar.	Asnjë Opcion për Kurrikulën Personale	Nuk Modifikohet
World Languages 2.0 Kredite	Në përputhje me përmbajtjen e parashikuar të lëndës që është zhvilluar nga Departamenti dhe miratuar nga Bordi Shtetëror i Arsimit. Nxënësit duhet të plotësojnë 2 kredite në klasat K – 12 që i përshatën nivelit, për një gjuhë tjetër përveç English ose për aktivitete mësimore, ose përvoja të tjera mësimi që vlejné 2 kredite.	Asnjë Opcion për Kurrikulën Personale	Nxënësit mund të fitojné <ul style="list-style-type: none"> 1 Kredit për kompletimin e një Career Technical Education Program (shih Shënimin V at UticaK12.org/GraduationRequirements, ose të 1 Lëndë të Visual, Performing, Applied Arts ose CTE,PLUS 4 kredite të tjera elektive
Personal Finance 0.5 Kredit (fillon në vitin 2028)	Mund të merret si Lëndë e pavarur ose e përfshirë në Economics	Asnjë Opcion për Kurrikulën Personale	Nuk Modifikohet
Michigan Merit Exam	Nxënësit duhet të marrin pjesë		Përcaktuar nga Shteti i Michigan-it i zbatueshëm për Nxënësit e Arsimit Special
Miratimet në Dispozicion	UCS Seal of Global Language Ndiqni këtë link për opsionet e shumta të UCS Seal of Global Language	Miratuar nga STEM <ul style="list-style-type: none"> 6 Kredite për Mathematics 6 Kredite për Science 0.5 Kredite për Aktivitete Teknologjike 0.5 Kredite për Aktivitete Inxhinierike 	AP Capstone Diploma Vlerësim 3 ose më lart në provimet e: <ul style="list-style-type: none"> AP Seminar Exam AP Research Exam,PLUS 4 AP Exams shtesë

Për listën e plotë të kriterëve të diplomimit, vizitoni UticaK12.org/GraduationRequirements

Programet e Specialitetit

Akademia e Utikës për Studimet Ndërkombëtare Gene L. Klida

(Gene L. Klida Utica Academy for International Studies (UAIS))

Misioni i UAIS është të angazhojë nxënësit tanë dhe të kultivojë aftësitë e tyre nëpërmjet vëmendjes së individualizuar dhe mbështetjes së komunitetit tonë të edukatorëve, nxënësve dhe prindërve.



Ky mjedis bashkëpunues dhe programi mësimor rigoroz, gjithëpërfshirës dhe me vizion ndërkombëtar e inkurajojnë nxënësin të zhvillojë personalitetin dhe aftësitë akademike.

Ndërsa nxënësit tanë rriten dhe bëhen qytetarë të dalluar dhe të vetëdijshëm për kulturën globale, aftësitë dhe botëkuptimi që ata krijojnë në UAIS do t'i aftësojë ata të udhëheqin të sotmen dhe të përmirësojnë të ardhmen.

Qendra e Utikës për, Matematikën, Shkencën dhe Teknologjinë

(Utica Center for Mathematics, Science and Technology (UCMST))

Kjo qendër është formuar për nxënësit që kanë interes në matematikë, shkencë, informatikë dhe teknologjinë e integruar në program.

Të gjithë nxënësit kanë një gjysmë dite punë për lëndët në shkollat e tyre të mesme, duke përfshirë Anglishten, Studimet Sociale dhe lëndët elektive. Nxënësit transportohen në qendrën e tyre për mësimin e matematikës, shkencës dhe teknologjisë.



UCMST është anëtare aktive e Konsorciumit Kombëtar për Shkollat e Mesme të Specializuara për Matematikë, Shkencë dhe Teknologji *(National Consortium for Specialized Secondary Schools of Mathematics, Science and Technology)*.

Programi i Stazhit për të Rinjtë e UCMTS njihet nga Departamenti Arsikor i Michigan-it. Çdo nxënësi të vitit të tretë i ofrohet një përvojë karriere në një mjedis profesional të zgjedhur. Çdo nxënës përpilon një prezantim formal të përvojës së tij ose të saj në vjeshtën e vitit të maturës.

Qendra e Utikës për Shkencën dhe Industrinë

(Utica Center for Science and Industry (UCSI))

UCSI është një ndërthurje e njohurive rigoroze akademike me aplikimet më domethënëse të këtyre njohurive nëpërmjet projekteve. Nxënësit e UCSI kanë mundësinë të mësojnë duke punuar, nëpërmjet praktikës, mentorimit dhe stazhit. Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë ndjekin kursin “CSI Design Principles”, që përqendrohet në konceptet bazë të artit, të ilustrimit teknik (CAD) dhe të procesit të ideimit të projekteve. Ata gjithashtu ndjekin dy lëndë themelore, “English” dhe “Geometry”, të dyja të ofruara në formatin konstruktiv, nxënësi-si-zbulues. Nxënësit e klasës së dhjetë zgjedhin një nga tre opsionet e Karrierës dhe Arsimit Teknik: Prodhimin Multimedial (*Multimedia Production*), Sistemet e Avancuara Robotike (*Mechatronics*) ose Teknologjinë Inxhinierike (*Engineering Technology*), dhe regjistrohen në lëndët elective përkatëse të opsionit që zgjedhin. Nxënësit gjithashtu ndjekin lëndën “English 10” dhe njërin nga dy lëndët e matematikës: “Algjebra I” ose “Algjebra II”.



Akademia Stevenson e Fabrikimit, Automatizimit dhe

Projektimit *(Stevenson Manufacturing, Automation, and Design Engineering Academy (MADE))*

Stevenson MADE ofron një kombinim të programeve rigoroze akademike me aplikime relevante të jetës së përditshme, nëpërmjet marrëdhënieve dhe partneriteteve të forta me biznese të fushës së Prodhimit të Avancuar. I gjithë programi i kursit zhvillohet mbi bazat e Projektimit, Zhvillimit të Ideve, dhe Zgjidhjes së problemeve thelbësore.

Të gjithë nxënësit e klasës së nëntë do të ndjekin një kurs të plotë të ideimit të projekteve që fokusohet në zhvillimin e aftësive për të kuptuar procesin e Ideimit të projekteve. Si nxënës të klasës së dhjetë, nxënësit do të përqendrohen në një kapitull eksplorues 10-12 javor për secilën nga tre përqendrimet e akademisë: Fabrikimin, Automatizimin, ose Inxhinierinë e Projektimit. Në Junior High, nxënësit do të zgjedhin një fushë përqendrimi dhe do të fillojnë të përqendrohen në sfidat e propozuara nga partnerët e industrisë për të zhvilluar aftësitë e tyre për karrierë. Nxënësit e vitit të fundit të MADE do të përgatisin një Project Final dhe do të kenë mundësi të shumta stazhi/praktike. Të gjitha standardet e Matematikës, Studimeve Sociale, Anglishtes dhe Shkencës që mësohen në Akademinë MADE do të kombinohen në përshtatje me çdo fushë përqendrimi të akademisë.



Akademia e Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore

(Utica High School Academy of Health and Human Services (UAHHS))

Kjo akademi do të jetë në dispozicion të nxënësve të klasave të 9-ta dhe të 10-ta për Vitin shkollor 2024 -2025. UAHHS do të përdorë tema të tilla si ato të shërbimeve terapeutike mjekësore, të sigurisë publike dhe rehabilitimit për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësitë teknike dhe analitike, ndërsa përballen së afërmi me sfida të tilla në fushën e mjekësisë.



Aktivitetet Jashtëshkollore

Pjesëmarrja në aktivitete jashtëshkollore siguron një përvojë të çmuar edukative. Më shumë se një mjet për tu argëtuar ose për të qenë me shokët dhe shoqet, aktivitetet ndihmojnë në mbështetjen e misionit akademik të shkollës dhe janë një zgjerim i një programi arsimor cilësor.

Shkollat fillore të UCS ofrojnë shumë aktivitete para dhe pas shkollës dhe në mbrëmje. Nxënësit mund të sfidojnë krijimtarinë dhe aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve duke marrë pjesë në një sërë programesh si “Academically Talented and Gifted”, “Geography Bees”, “Destination Imagination”, “Science Olympiad”, “Math Olympiad”, “Social Studies Olympiad”, “Lego Robotics”, “Chess Club” dhe të tjera, Gjithashtu programet edukative të komunitetit, “Scout Troops” dhe programet sportive të të rinjve janë shpesh të përqendruara në shkolla.

Faqet informative të shkollës ofrojnë informacione për pjesëmarrjen. Prindërit janë përgjegjës për transportin e fëmijëve të tyre në aktivitetet jashtë programit të rregullt shkollor. Patrulla e sigurisë dhe të rriturit që mbikëqyrin kalimin e rrugës nuk janë në disponim për nxënësit që ndjekin funksionet pas shkollës

Pavarësisht nga lloji i karrierës që një nxënës dëshiron të ndjekë, qoftë ajo në fushën e mjedisit, eventeve sociale, shërbimeve në komunitet, udhëheqjes studentore, kulturës botërore, robotikës, arteve të bukura dhe performuese apo shumë të tjera, shkolla e tij/saj ofron një aktivitet apo organizatë të posaçme.

VIZIONI YNE K12

Nxënësit që marrin pjesë në aktivitete jashtëshkollore kanë tendencë të kenë një mesatare më të lartë të notave, rekord frekuentimi më të mirë, probabilitet më të ulët për të lënë shkollën dhe më pak probleme disiplinore në krahasim me nxënësit që nuk marrin pjesë. Nëpërmjet përfshirjes së tyre, nxënësit mësojnë vetë-disiplinimin, ndërtojnë vetë-besimin dhe zhvillojnë aftësi për të trajtuar të gjitha llojet e situatave.

Asamblëtë dhe Eventet

Asamblëtë e shkollave dhe eventet sportive zhvillohen në të gjitha shkollat e ciklit Junior High dhe nxënësit inkurajohen të marrin pjesë. Respektimi i rregullave të shkollës, në mënyrë të veçantë sportiviteti i respektshëm, pritet në të gjitha këto evente. Spektatorët duhet të jenë të rregullt dhe të sjellshëm. Ata duhet të përdorin duartrokitjet vetëm për të treguar respekt për njerëzit e përfshirë në evente.

Programet e Mbrëmjes në Shkollat Junior High

Normalisht, nxënësit nuk do të ndjekin aktivitete pas shkollës, të tilla si koncerte, shfaqje apo evente sportive, përveçse kur shoqërohen nga një i rritur ose janë pjesëmarrës në program ose event.

Mbrëmjet e Vallëzimit

Vallëzimet planifikohen periodikisht gjatë vitit shkollor. Të gjitha rregulloret e qarkut dhe normat e sjelljes janë në fuqi gjatë vallëzimeve. Veshje normale kërkohet në të gjitha vallëzimet e shkollës, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe. Privilegji i pjesëmarrjes në vallëzim është një privilegj që mund të varet nga notat në lëndën e qytetarisë. Çdo vallëzim i "Junior High" zgjat afërsisht dy orë. Nxënësit duhet të arrijnë në kohë dhe të mos largohen para kohe. Mysafirë nga shkollat e tjera nuk do të pranohen. Në ciklin e mesëm, biletat shiten në shkollë para çdo vallëzimi. Çdo nxënës që largohet nga vallëzimi përpara kohës së mbylljes nuk do të lejohet të ri-kthehet. Për vallëzime të veçanta, personave që nuk janë nxënës mund tu kërkohet të regjistrohen si mysafirë shumë përpara mbrëmjes. Administrata rezervon të drejtën të kufizojë pjesëmarrjen.



"Programi MADE në bashkëpunim me UCS mundësoi zhvillimin e aftësive të mija profesionale. Me ndihmën e instruktorëve dhe nxënësve të tjerë, unë arrita të zhvilloj aftësitë e duhura për të punuar."

Kristina Kopp

INSPIRING
Remarkable
ACHIEVEMENT

Shoqëria Kombëtare e Nderit

(National Honor Society)

Kapitujt e Shoqërisë kombëtare të nderit të "Junior High" dhe të "High School" shprehin mirënjohje të veçantë për nxënësit që kanë treguar përsosmëri në mësim, udhëheqje, shërbim dhe karakter. Organizata sponsorizohet nga Shoqata Kombëtare e Drejtorëve të Shkollave Sekondare (*National Association of Secondary School Principals*). Anëtarësia qeveriset nga ligjet kombëtare. Nxënësit kualifikohen gjatë viteve "Junior – Senior". Një komitet i fakultetit është përgjegjës për vendimet në lidhje me anëtarësimin.

Shënim: Pjesëmarrja në aktivitete jashtëshkollore, duke përfshirë edhe ato më sipër, kërkon që një nxënës të jetë i pranishëm në shkollë për gjysmën e ditës shkollore në ditën e eventit.

Atletika

Atletika mund të luajë një rol të rëndësishëm në kompletimin e përvojës arsimore. Përveç zhvillimit të aftësive fizike, pjesëmarrja sportive inkurajon vendosjen e qëllimeve, zhvillimin e aftësive organizative dhe të menaxhimit të kohës, dhe sportivitetin.

Në UCS, pjesëmarrja në sporte nuk është një e drejtë, por një privilegj. Një nxënës mund t'i tërhiqet e drejta e pjesëmarrjes sportive për mos-përmbushje të standardeve dhe kërkesave të ekipit, shkollës, qarkut ose të Shoqatës Atletike të Shkollave të Mesme të Michigan-it (*Michigan High School Athletic Association (MHSAA)*).

Një nxënës duhet të kalojë një ekzaminim fizik dhe të paraqesë rezultatet e tij para se të kërkojë të bëhet pjesëtar i një ekipi. Asnjë provë nuk do të lejohet pa rezultatet e ekzaminimit fizik të vitit aktual. Shumica e shkollave organizojnë ekzaminime fizike të arsyeshme për nxënësit çdo pranverë dhe vjeshtë.



Nathan Steinwascher

Detroit City FC Goalkeeper

"Vlerat që kam zhvilluar në vitet e mia në sistemin UCS më kanë formuar të përmbush të gjitha qëllimet e mia personale dhe profesionale."

INSPIRING
Remarkable
ACHIEVEMENT

VIZIONI YNE K12

Nxënësit e klasës së shtatë ose të tetë duhet të kenë kaluar të paktën 50 për qind të lëndëve të semestrit të mëparshëm dhe të kalojnë të paktën 50 për qind të lëndëve të tij/saj aktuale në mënyrë që tu lejohet pjesëmarrja në sport.

Për tu ushtruar ose për të marrë pjesë në një lojë, një nxënës duhet të jetë i pranishëm për tre orë shkollore të asaj dite.

Një pagesë është e nevojshme për pjesëmarrjen në atletikë. Kontaktoni drejtorin e atletikës të shkollës për informacione specifike. Pagesa mund të ndryshojë në varësi të sportit dhe kostoja mund të shtohet.

Rregullorja e Bordit të Arsimit parashikon që nxënësve tu ndalohet përdorimi i çfarëdo substance që përmirëson performancën, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, ato të ndaluara nga ligjet e Shoqatës Kombëtare të Atletikës për Kolegjet (*National Collegiate Athletic Association (NCAA)*) dhe me ato që mund të jenë renditur nga Departamenti i Shëndetit dhe i Shërbimeve Njerëzore të Michigan-it (*Michigan Department of Health and Human Services*). Masat disiplinore për nxënësit që shkelin këtë rregullore mund të përfshijnë paralajmërimet, ndalimet, pezullimet deri dhe përjashtimin. Për më shumë informacion, kontaktoni drejtorin e atletikës së shkollës suaj.

Transporti për ditën e ndeshjes: Transporti i qarkut për atletët do të sigurohet vetëm në vajtje për në event (me përjashtim të futbollit, për shkak të pajisjeve). Prindërit/Kujdestarët do të jenë përgjegjës për transportimin e fëmijës së tyre në kthim.

Sportet për ciklin shkollor “Junior High”

Vjeshtë	Dimër	Pranverë
8 ^{të} Futboll	8 ^{të} Basketboll për Djem	8 ^{të} Vrapim për Djem
7 ^{të} Futboll	7 ^{të} Basketboll për Djem	7 ^{të} Vrapim për Djem
8 ^{të} Volejbol	8 ^{të} Basketboll për Vajza	8 ^{të} Vrapim për Vajza
7 ^{të} Volejbol	7 ^{të} Basketboll për Vajza	7 ^{të} Vrapim për Vajza
8 ^{të} Sideline Cheer	8 ^{të} Competitive Cheer	
7 ^{të} Sideline Cheer	7 ^{të} Competitive Cheer	

Kriteret e Pranimit në Atletikë për “Junior High”

Kriteret e pranimit në sport të renditura më poshtë, janë ato të Shoqatës Atletike të Shkollave të Mesme të Michigan-it (*Michigan High School Athletic Association*), dhe zbatohen për nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë që marrin pjesë në garat sportive.

Nxënësit duhet të jenë të regjistruar në shkollë përpara të premtës së katërt pas “Labor Day” ose të premtës së katërt të muajit Shkurt të sezonit në të cilin nxënësi merr pjesë. Nxënësit e klasës së shtatë që marrin pjesë në çfarëdo gare sportive ndërshkollore duhet të jenë nën 14 vjeç me përjashtim të nxënësve, ditëlindja e 14-të e të cilëve bie në ose pas 1 Shtatorit të vitit shkollor në vazhdim, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë për kohën që mbetet nga ai vit shkollor.

Nxënësit e klasës së tetë që marrin pjesë në çfarëdo gare sportive ndërshkollore duhet të jenë nën 15 vjeç me përjashtim të nxënësve, ditëlindja e 15-të e të cilëve bie në ose pas 1 shtatorit të vitit shkollor në vazhdim. Këta të fundit kanë të drejtë të marrin pjesë për kohën që mbetet nga ai vit shkollor. Nuk ka limit për semestrat e regjistrimit ose sezonet e pjesëmarrjes për nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë.

Një dokument i një ekzaminimi fizik aktual të bërë në ose pas 15 Prillit të vitit të mëparshëm shkollor duhet të jetë në dosjet e shkollës.

Një nxënës nuk mund të jetë një diplomant i “Junior High” ose “Middle School” dhe duhet të ketë fituar kredite për 50 për qind të programit të semestrit të mëparshëm. Një nxënës duhet të kompletojë 50 për qind të programit të semestrit në vazhdim brenda shtatë ditëve nga pjesëmarrja. Një nxënës-atlet nuk mund pranojë ASNJË çmim me vlerë më të madhe se \$40. Një student nuk mund të pranojë para, dhurata, kredi, mallra, anëtarësime, privilegje, shërbime apo konsiderata të tjera të vlefshme për pjesëmarrje në çfarëdo forme të sportit, atletikës, lojërave apo garave atletike ndërshkollore zyrtare, përveçse siç lejohet në Interpretimet e broshurës së MHSAA, të renditura në rregulloren I, seksioni II.

Një nxënës nuk mund të marrë pjesë në një aktivitet të jashtëm gjatë sezonit në të cilin ai atlet merr pjesë në të njëjtin sport në shkollë. Në këtë rregullore përfshihen edhe turnetë e basketbolli tre-me-tre.

Shënim: Në të gjitha sportet, përveç futbollit, gjatë sezonit të “Junior High/Middle School” (që nga pjesëmarrja e parë e një nxënësi në një garë ose ndeshje miqësore deri në ditën e fundit të garës për atë nxënës) një pjesëmarrës i ekipit të shkollës në një sport mund të marrë pjesë në jo më shumë se dy (2) ndeshje që nuk sponsorizohen nga shkolla e tij/saj në atë sport, ndërkohë që nuk përfaqëson shkollën e tij/saj.

VIZIONI YNE K12

E vlefshme vetëm për këtë paragraf: Një aktivitet që zgjat jo më shumë se tre (3) ditë kalendarike të njëpasnjëshme konsiderohet një ndeshje e vetme. Për informacion të plotë rreth broshurës informative sportive MHSAA, ju lutemi kontaktoni drejtorin e sporteve të shkollës suaj.

Sportet në High School

Vjeshtë	Dimër	Pranverë
Varsity Football	Varsity Basketball - Djem	Varsity Baseball
J.V. Football	J.V. Basketball - Djem	J.V. Baseball
Football - Klasa e 9 ^{te}	Basketball - Klasa e 9 ^{te} - Djem	Baseball- Klasa e 9 ^{te}
Varsity Volleyball	Varsity - Basketball- Vajza	Varsity Softball
J.V. Volleyball	J.V. Basketball - Vajza	J.V. Softball
Volleyball - Klasa e 9 ^{te}	Basketball- Klasa e 9 ^{te} -Vajza	Softball - Klasa e 9 ^{te}
Swim - Vajza	Varsity Wrestling	Varsity Soccer - Vajza
Varsity Soccer - Djem	J.V. Wrestling	J.V. Soccer - Vajza
J.V. Soccer - Djem	Swim - Djem	Soccer- Klasa e 9 ^{te} -Vajza
Soccer - Klasa e 9 ^{te} - Djem	Varsity Competitive Cheer	Varsity Tennis - Vajza
Cross Country-Djem	J.V. Competitive Cheer	J.V. Tennis - Vajza
Cross Country - Vajza	Competitive Cheer-Klasa e 9 ^{te}	Golf - Djem
Golf - Vajza	Varsity Hockey*	Varsity Track - Djem
Varsity Tennis Djem	J.V. Hockey*	Varsity Track - Vajza
J.V. Tennis - Djem	Bowling* - Djem	Varsity Lacrosse* - Djem
Varsity Sideline Cheer	Bowling* - Vajza	JV Lacrosse* - Djem
JV Sideline Cheer	Varsity Dance*	Varsity Lacrosse* - Vajza
Sideline Cheer- Klasa e 9 ^{te}	JV Dance*	JV Lacrosse* - Vajza
Varsity Dance*		
J.V. Dance*		

*Club Sports:

Ekipet e klubeve mund të mos jenë të pranishëm në çdo shkollë për shkak të mungesës së interesit nga ana e nxënësve.

Kriteret e Pranimit në Atletikë për “High School”

Për të marrë pjesë në sportet e High School, një nxënës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Regjistrimi:

- Eshtë regjistruar në “High School” brenda të Premtes së katërt pas “Labor Day” (semestri i parë) ose brenda të Premtes së katërt të Shkurtit (semestri i dytë). Nxënësi duhet të jetë i regjistruar dhe të ketë kompletuar me sukses të paktën 66% të programit të plotë (katër lëndë) në shkollën për të cilën ai/ajo konkurren.

Mosha

- Eshtë nën moshën 19 vjeç në kohën e aktivitetit sportiv, përveç rastit kur ditëlindja e tij/saj e nëntëmbëdhjetë bie në ose pas 1 Shtatorit të vitit shkollor në vazhdim. Në këtë rast nxënësi ruan të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha sportet, për kohën e mbetur të atij viti shkollor.

Ekzaminimet fizike

- Ka bërë një ekzaminim fizik të vitit në vazhdim që përmbush kriteret për pjesëmarrje në sport. Një dokument i këtij ekzaminimi duhet të jetë në dosje në zyrën e shkollës. Deklarata e një mjeku për vitin shkollor në vazhdim konsiderohet e baraz-vlerëshme me çdo ekzaminim fizik të bërë në ose pas 15 Prillit të vitit të mëparshëm shkollor.

Semestrat e pjesëmarrjes

- Pas regjistrimit në klasën e nëntë, sipas rregullores së MHSAA, paragrafi 4, nxënësi do të lejohet të marrë pjesë në katër semestra të parë dhe katër semestra të dytë. Në rastin kur ofrohen dy sezona për të njëjtin sport, që rezultojnë në një kampionat shtetëror, atletit i lejohet të marrë pjesë vetëm në një sezon.

Semestrat e Regjistrimit

- Nuk ka qenë i/e regjistruar për më shumë se tetë (8) semestra gjatë kohës që përfshin klasa 9, 10, 11,12. Semestri i shtatë (7) dhe tetë (8) duhet të jenë të njëpasnjëshëm. Regjistrimi në shkollë në një datë që bie pas së Premtes së 4-t në vijim të “Labor Day”, ose pas së Premtes së 4-t të Skurtit, ose pjesëmarrja në 1 ose më shumë gara atletike, konsiderohen si një semestër regjistrimi.

Pozicioni i jo maturantit

- Nuk është maturant në “High School”

Rekordi i semestrit të mëparshëm

- Ka plotësuar me sukses të paktën 66% të programit të plotë të krediteve (katër lëndë) gjatë semestrit të mëparshëm të regjistrimit.

Rekordi i semestrit aktual

- Kërkohen kontrole të standardeve akademike çdo pesë deri në dhjetë javë. Një nxënës që në momentin e kontrollit nuk ka plotësuar me sukses të paktën 66% të programit të plotë të krediteve (katër lëndë) nuk lejohet të marrë pjesë në aktivitetin sportiv deri në kontrollin tjetër (për jo më pak se një javë, duke filluar nga dita e Hënë në vijim).

Transferimet

- Zakonisht, një ndryshim i plotë dhe komplet i banesës (siç parashikohet nga Manuali MHSAA, paragrafi 9) së prindit, kujdestarit ose një personi tjetër me të cilin atleti/ja ka jetuar gjatë periudhës së regjistrimit të tij/saj të fundit në "High School", kërkohet nga qarku pranues ose zona e shërbimit të shkollës, në mënyrë që atleti të pranohet gjatë semestrit të parë të pjesëmarrjes.

Ndikimi i pajustificueshëm

- Përdorimi i ndikimit të pajustificueshëm për qëllime sportive nga cilido person ose persona të lidhur drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me shkollën për të siguruar ose inkurajuar qëndrimin e një nxënësi ose prindërve ose kujdestarëve të nxënësit si banorë të qarkut të shkollës, do të shkaktojë skualifikimin e nxënësit për një periudhë që mund të zgjasë nga një semestër deri në një vit. Shembuj të ndikimit të pajustificueshëm përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me ofertat ose pranimin e ndihmës financiare për prindërit, kujdestarët apo nxënësit; reduktimin ose eliminimin e tarifave dhe/ose pagesave të shkollimit; privilegjet e veçanta që nuk u ofrohen nxënësve të tjerë, qofshin atletë apo jo; shërbimi i transportimit; preferencat në caktimin e detyrave; dhomës, bordit apo veshjeve.

Vlerësimet

- Atletët nuk do të pranojnë asnjë vlerësim ose mall që vlen më shumë se 40 dollarë për performancën atletike. Atletët që pranojnë anëtarësime, privilegje, shërbime dhe/ose certifikata të negociueshme të parave, janë në shkelje.

Statusi i amatorit

- Nuk ka pranuar para, dhurata, kredi, mallra, anëtarësime, privilegje, shërbime apo konsiderata të tjera të vlefshme për pjesëmarrje në

VIZIONI YNE K12

çfarëdo forme të atletikës, sportit ose ndeshjeve, ose për arbitrim në garat atletike ndërskollore, ose nuk ka nënshkruar një kontratë profesionale bejsbolli. (Në rast të kundërt statusi do të pezullohet për një vit). Një nxënës mund të kompensohet për mësimdhënie në një kamp rinor ose program rekreativ, por nuk mund të jetë njëkohësisht kampist apo pjesëmarrës në program.

Kufizimi i Anëtarësimit Ekipor

- Nuk ka marrë pjesë në gara të jashtme sportive gjatë të njëjtit sezon në të cilin atleti ka përfaqësuar shkollën e tij/saj në të njëjtin sport, përveçse gjatë sezonit të High School në sportet individuale, një anëtar i ekipit të shkollës në atë sport mund të marrë pjesë në jo më shumë se dy takime apo gara jo-shkollore, ndërkohë që nuk përfaqëson shkollën e tij/saj. Nuk ka marrë pjesë në një konkurs të ashtuquajtur “all-star” ose ekspozim gjatë vitit shkollor. Përveç kësaj, pjesëmarrja e një anëtari të ekipit ndërskollor të një shkolle në një ndeshje 3 me 3 (ose më shumë) shkollore dhe jo-shkollore në atë sport gjatë sezonit MHSAA do të shkaktojë skualifikim të atletit sipas kësaj rregulloreje.

Frekuentimi i nevojshëm për pjesëmarrje

- Shkollat Komunitare të Utikës kërkojnë që një nxënës të jetë i pranishëm për tre orë shkollore në ditën e një gare sportive, për t'i lejuar pjesëmarrjen.

Burimet e Kriteve të Pranueshmërisë

Rregullorja e UCS për Sjelljen e Nxënësve Atletë (*UCS Student Athlete Code of Conduct*), Doracaku i Trajnerëve të Atletikës (*UCS Athletic Coaches Handbook*) dhe Doracaku i Shoqatës Atletike të Shkollave të Mesme të Michiganit (*Michigan High School Athletic Association Handbook*).

Shënim: Nxënësit e klasës së nëntë të një shkolle të caktuar të ciklit “Junior High/Middle School”, në një qark me shumë shkolla të cikleve “Junior High” dhe “Senior High” mund të konsiderohen për pjesëmarrje atletike dhe për këtë arsye i plotësojnë kriteret e pranimit në shkollën e mesme të ciklit “Senior High” të caktuar për zonën ku banojnë. Nxënësit e klasës së nëntë të UCS që nuk banojnë në zonën e shkollës së mesme të caktuar mund të marrin pjesë në sporte në shkollën e mesme të caktuar. Çdo nxënës i klasës së nëntë që garon në nivelin e shkollës së mesme, në çdo sport, pritet të marrë pjesë në shkollën e mesme përkatëse të tij/saj, jo në një shkollë tjetër të mesme jashtë zonës së tij/ saj të frekuentimit.

Transporti në Ditën e Ndeshjes

Transporti i UCS për atletët do të sigurohet vetëm në vajtje për në vendin ku zhvillohet ndeshja (me përjashtim të futbollit, për shkak të pajisjeve).

Prindërit/Kujdestarët do të jenë përgjegjës për transportimin e fëmijës së tyre nga vendi i ndeshjes në shtëpi.

*Për sqarime rreth manualit MHSAA, ju lutemi drejtohuni tek Drejtori i atletikës i shkollës suaj.

Shërbimet për Nxënësit

Këshillimi në Shkollë

Çdo nxënësi të ciklit “Junior High” dhe “High School” i caktohet një këshilltar për të ndihmuar me përzgjedhjen e lëndëve mësimore dhe planifikimin e programeve.

Këshilltarët janë gjithashtu në dispozicion, të takohen për të diskutuar çështje akademike, shqetësime personale ose planifikimin e karrierë. Është e rëndësishme që nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre të njihen me këshilltarin në mënyrë që të gjithë të mund të punojnë së bashku për të mirën e nxënësit.

Departamenti i këshillimit ofron shumë shërbime për nxënësit, duke përfshirë përzgjedhjen e lëndëve, planifikimin e programeve, testimin, administrimin dhe interpretimin, planifikimin për kolegjin dhe ndihmën financiare, planifikimin profesional, punësimin, udhëzime personale dhe shoqërore dhe rekomandime për punësim. Informacione të kompjuterizuara rreth karrierës, kolegjeve, shkollave profesionale dhe bursave janë gjithashtu në dispozicion.

Situatat që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme do të trajtohen menjëherë. Prindërit/kujdestarët dhe mësuesit mund të kërkojnë shërbime këshillimore për një nxënës. Këshilltarët janë në dispozicion për tu takuar me prindërit gjatë ditëve shkollore për të diskutuar programin mësimor ose shqetësimet individuale të nxënësit.

Aplikimet në kolegji, aplikimet për teste dhe vende pune janë të disponueshme nëpërmjet burimeve on-line. Nxënësit që plotësojnë aplikimet për në kolegji këshillohen të rrinë në kontakt me këshilltarët e tyre të shkollës së mesme për tu siguruar që të gjitha materialet që nevojiten për një aplikim të suksesshëm të kompletohen korrektësisht. Nxënësit mund të marrin një takim me këshilltarin e tyre nëpërmjet plotësimit të një kërkesë nga zyra e këshillimit ose duke e kërkuar takimin personalisht.

Prindërit/kujdestarët mund të telefonojnë këshilltarin për informacione ose mund të lënë një takim.

Ligji “McKinney-Vento” i Ndhmës për të Pastrehët

(McKinney-Vento Homeless Assistance Act)

Qarku, në përputhje me ligjin e ndihmës për të pastrehët (*McKinney-Vento Homeless Assistance Act*), do të sigurojë që fëmijët dhe të rinjtë e pastrehë në tranzicion, të kenë mundësinë për një arsimim publik falas dhe të përshtatshëm, duke përfshirë parashkollorët, dhe tu jepen mundësi të plota për të marrë pjesë në të gjitha testimet shtetërore dhe të qarkut.

Një nxënës mund të konsiderohet i kualifikuar për shërbime nëse jeton aktualisht dhe përkohësisht në një banesë të përbashkët, në një strehim ose në një program të përkohshëm jetese; në një hotel/motel, kamp apo situatë të ngjashme për shkak të mungesës së mundësive alternative; në një stacion autobusi, park, makinë ose ndërtesë të braktisur; ose nën një kujdestari të përkohshme ose kalimtare.

Bordi i Arsimit ka caktuar Drejtorin e Shërbimeve Studentore si koordinator të qarkut sipas “Homeless Assistance Act”. Për pyetje dhe ndihmë, ju lutemi kontaktoni drejtorin e Shërbimeve Studentore në (586) 797-1120 ose vizitoni Zyrën e Shërbimeve Studentore që ndodhet në 11303 Greendale në Sterling Heights gjatë orarit normal zyrtar 8:00 – 16:30.

Programet për Nxënësit e Gjuhës Angleze

Prindërit e nxënësve me njohuri të kufizuara të gjuhës angleze (*(LEP) Limited English Proficiency*) që marrin pjesë në një program mësimor gjuhësor, do të informohen jo më vonë se 30 ditë pas fillimit të vitit shkollor

- Vendosjen dhe arsyen për të cilën fëmija i tyre u identifikua si LEP
- Nivelin e arritjeve akademike të nxënësit dhe nivelin e njohurive të gjuhës Angleze (duke përfshirë metodën e vlerësimit)
- Metodot e përdorura për mësimin e gjuhës
- Si do t'i plotësojë programi i gjuhës nevojat mësimore të nxënësit
- Si do ta ndihmojë ai program fëmijën të mësojë gjuhën Angleze dhe të përmbushë standardet akademike të kërkuara për avancim ose diplomim
- Kërkesat për të dalë nga programi i mësimin të gjuhës, dhe
- Një shpjegim i të drejtave prindërore, duke përfshirë të drejtën e prindit/kujdestarit për të regjistruar ose për të hequr një fëmijë nga programi i mësimin të gjuhës.

Nxënësit e Anglishtes (EL) / Të sapoardhurit

Një program intensiv ofrohet për nxënësit e regjistruar në Shkollat Komunitare të Utikës, të cilët kanë njohuri të kufizuara ose nuk e njohin gjuhën Angleze. Aftësitë e nxënësve sillen në një nivel rrjedhshmërie që do tu mundësojë atyre të marrin pjesë në programin e rregullt të lëndës. Pas përfundimit të programit fillestar, nxënësit e fillores mund të vazhdojnë të ndihmohen sipas nevojës.

Njoftimi i Nenit 504

Shkollat Komunitare të Utikës kanë për detyrë të lokalizojnë, vlerësojnë dhe identifikojnë çdo fëmijë që banon në Qark, që kualifikohet për ndihmë sipas paragrafit 504 të Ligjit për të Pastrehët (*Homeless Assistance Act*) të vitit 1973 ose për shërbime. Fëmijët që kualifikohen për ndihmë ose shërbime sipas paragrafit 504 përfshijnë edhe ata që kanë një dëmtim fizik ose mendor, që kufizon ndjeshëm një aktivitet të rëndësishëm jetësor. Nëse dyshoni se fëmija juaj ka një paaftësi dhe mund të ketë nevojë për ndihmë sipas paragrafit 504, ju lutemi kontaktoni drejtorin e shkollës suaj për informacion.

Njoftimi i Arsimit Special / Child Find

Shkollat Komunitare të Utikës kanë për detyrë të lokalizojnë, vlerësojnë dhe identifikojnë çdo fëmijë që banon në qark, i cili kualifikohet për shërbime të Arsimit Special. Fëmijët që kanë të drejtë për arsim special përfshijnë ata me aftësi të kufizuara si autizmi, dëmtimet vizuale, verbëria, vonesa e zhvillimit, sjellja emocionale e pazhvilluar, dëmtimi i dëgjimit, shurdhimi, paaftësia mendore, paaftësia e shumëfishtë, dëmtimet ortopedike, dëmtime të tjera shëndetësore, paaftësia specifike e të mësuarit, dëmtimi i të folurit ose gjuhës ose dëmtimi traumatik i trurit dhe ata që, për shkak të një dëmtimi të tillë, kanë nevojë për shërbime të arsimit special. Nëse dyshoni se fëmija juaj ka një paaftësi, ju lutemi kontaktoni drejtorin e shkollës suaj për informacione të mëtejshme.

Një pjesë përbërëse e Departamentit të Shërbimeve Speciale është ofrimi i shërbimeve të vlerësimit për nxënësit për të cilët dyshohet se kanë një paaftësi. Shërbimet e vlerësimit falas të "Child Find" kryhen nga një ekip specialistësh nga fusha e arsimit. "Child Find" kërkon të identifikojë dhe referojë individë me nevoja të veçanta, nga lindja deri në moshën 25 vjeç, për vlerësim dhe mundësi për ndihmë të veçantë. Çdo prind/kujdestar që ka një shqetësim në lidhje me zhvillimin e fëmijës së tyre mund të kontaktojë "Child Find". Të gjitha vlerësimet dhe shërbimet janë pa pagesë.

Për fëmijët nën moshën tre vjeç:

Nëse keni shqetësime në lidhje me zhvillimin e fëmijës suaj, mund të kontaktoni “Child Find” në “Macomb Intermediate School District(MISD)” në 586-228-3321 ose të vizitoni faqen e tyre të internetit “misd.net” në “Child Find”.

MISD ofron vlerësime falas në fushat e mëposhtme:

- Audiologji - Trajtimi i problemeve të dëgjimit
- Terapi Okupacionale - Ndihmë me aktivitetet e jetës së përditshme
- Terapi Fizike
- Psikologji
- Të folurit dhe Gjuha

Për fëmijët mbi moshën tre vjeç:

Shkollat Komunitare të Utikës ofrojnë shërbime vlerësimi dhe referimi për nxënësit që janë nga tre deri në pesë vjeç. Këto shërbime ofrohen nëpërmjet Qendrës për Vlerësimet e Hershme të Shkollave Komunitare të Utikës (*Utica Community Schools Early Assessment Center*) për fëmijët për të cilët dyshohet se kanë vonesa në komunikim, vështirësi për të menduar, mungesa në shoqërim dhe zhvillim të përgjithshëm. Nëse keni shqetësime në lidhje me zhvillimin arsimor të fëmijës suaj, ju lutemi kontaktoni Departamentin e Shërbimeve Speciale të UCS (*UCS Special Services Department*) në adresën 11303 Greendale, Sterling Heights, MI 48312 ose në tel. 586-797- 1020.

Burimet Komunitare

Informacione në lidhje me burimet e komunitetit për nxënësit, të tilla si Qendra e Krizës e Qarkut të Macomb-it (*Macomb County Crisis Center*) dhe Departamenti Shëndetësor i Qarkut të Macomb-it (*Macomb County Health Department*), janë në dispozicion dhe ofrohen nëpërmjet zyrës së këshillimit. Qarku ynë është gjithashtu në partneritet me CARE SOLACE

Sigurimi në Shkollë

Shkollat Komunitare të Utikës ofrojnë falas një sigurim bazë për nxënësit në rast aksidenti. Sigurimi mbulon nxënësit kur janë në shkollë ose marrin pjesë në veprimtaritë e sponsorizuara nga shkolla. Një nxënës duhet të raportojë menjëherë çdo aksident në zyrën e shkollës. Për të marrë dëmshpërblim, një prind ose kujdestar duhet të plotësojë një formular deklarimi. Do të merren në konsideratë vetëm shpenzimet që nuk mbulohen nga sigurimet familjare, ato të punëdhënësit ose sigurimet në grup. Viktimave të aksidentit mund tu kërkohet të paguajnë një pjesë të dëmshpërblimit. Periudha e dëmshpërblimit zgjat 52 javë nga data e dëmtimit. Një sigurim 24-orësh mund të jetë në dispozicion me pagesë, dhe në mënyrë vullnetare.

Autorizimi për Punë

Çdo nxënës nën 18 vjeç duhet të marrë një leje pune në mënyrë që të punësohet. Shumica e punëdhënësve duhet të respektojnë ligjet shtetërore dhe federale të punësimit të fëmijëve në lidhje me orët dhe kushtet e punës. Aplikimet për leje pune janë në dispozicion nga zyra kryesore në çdo shkollë të mesme. Oferta e formularëve të punësimit, të cilat duhet të plotësohen nga një punëdhënës i mundshëm, mund të merret në zyrën e shkollës së mesme. Në zyrën e shkollës disponohen informacione për orët dhe kohën kur të miturit lejohen të punojnë.

Bashkëpunimi me Prindërit Siguron Sukses

Si të Ndhmoni Fëmijën Tuaj të Mësojë

Ndihma që i jepet fëmijës për të zhvilluar praktika të mira studimi dhe sigurimi i mjeteve dhe mjedisit të duhur të punës janë jetësore për suksesin akademik. Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të zhvillojë praktika të frytshme dhe të qëndrueshme studimi duke:

- Vendosur standarde të larta për studimin dhe për sjelljen.
- Ndjekur dhe zbatuar rregullat dhe praktikat e studimit.
- Krijuar një vend të qetë dhe të rehatshëm për të lexuar dhe studiuar.
- Siguruar materiale të tilla si një fjalor, enciklopedi ose materiale shkollore.
- Treguar interes për detyrat e shkollës dhe kontrolluar e detyrat e shtëpisë.
- Përgjegjësuar fëmijën për të ditur se çfarë detyrash kanë, për të sjellë në shtëpi tekstet shkollore dhe materialet e nevojshme për të kompletuar detyrat, për të kuptuar udhëzimet e mësuesit, për tu përqendruar gjatë kohës së studimit. Duke pyetur nëse ka materiale që duhen nënshkruar, shënime apo detyra që duhet të përfundohen dhe kthehen në shkollë, edhe në rastin kur fëmija juaj mendon se ato nuk janë të rëndësishme.
- Lexuar për fëmijën tuaj ose duke e nxitur fëmijën të lexojë çdo ditë, dhe duke i krijuar mundësinë fëmijës tu shohë kur ju lexoni.
- Ndhimuar fëmijën tuaj të zgjedhë libra proze dhe informacioni nga biblioteka ose libraria.
- Inkurajuar fëmijën të reflektojë dhe të shkruajë për atë që lexon ose mëson.

Përgatitja dhe Aftësitë që Sigurojnë Sukses

Shkollat Komunitare të Utikës janë të përkushtuara për të ndihmuar nxënësit të zhvillohen dhe të jenë të suksesshëm personalisht dhe akademikisht. Një nga mënyrat për të përshpejtuar këtë zhvillim është përqendrimi i vëmendjes në zhvillimin e Aftësive për Sukses (si më poshtë), të krijuara për të ndihmuar nxënësit që nga kopshti deri në kompletimin e shkollës së mesme të ndërtojnë karakter dhe vetëvlerësim.

Ky zhvillim demonstron duke:

- Treguar respekt dhe trajtuar të tjerët në të njëjtën mënyrë që ata dëshirojnë të trajtohen.
- Mbajtur përgjegjësi për atë që thonë dhe bëjnë.

BASHKEPUNIM I SUKSESSHEM

- Komunikuar pozitivisht duke qenë të vëmendshëm me fjalët dhe veprimet e tyre.
- Bërë më të mirën e mundshme duke u përpjekur me të gjitha aftësitë personale.
- Treguar integritet duke qenë të sinqertë dhe të besueshëm.

Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të zgjedhë një stil pozitiv jetese duke:

- Kuptuar fazat e zhvillimit të fëmijëve në mënyrë që të kuptosh sjelljet e tij/saj nga pikëvështrimi i duhur.
- Ofruar inkurajim me qëllim për të ndërtuar vetëbesim dhe vetëvlerësim tek fëmija, mundësitë për marrjen e vendimeve të përshtatshme për moshën dhe lavdërime për arritjet e tij/saj.
- Dëgjuar me vëmendje të përqendruar, si atë që thotë fëmija juaj, ashtu edhe mënyrën se si ai/ajo ndihet.
- Ndihmuar fëmijën të njohë dhe të pranojë ndjenja të tilla si lumturia, zemërimi ose zhgënjimi dhe duke i demonstruar se si të flasë në mënyrë konstruktive për to.
- Duke i mësuar fëmijës praktika të mira komunikimi, të tilla si ndershmëria, respekti, gjuha e pastër, korrektesa e paraqitjes në kohë, besimi dhe qëndrueshmëria.
- Përcaktuar standardet dhe pasojat për mosplotësimin e tyre, në mënyrë konstante dhe të vazhdueshme.
- Ndihmuar fëmijën tuaj të përgjegjësohet duke përjetuar rezultatet e vendimeve të tij/saj.

Komunikimi i Prindërve me Shkollën

Arsimimi është një përpjekje ekipore që përfshin nxënësin, prindin/kujdestarin dhe mësuesin. Një partneritet i fortë midis shkollës dhe familjes, i bazuar në komunikimin, bashkëpunimin dhe besimin e dyanshëm krijon themelin për suksesin arsimor të fëmijës suaj.

Komunikimi nëpërmjet email-it, telefonatat dhe takimet janë mënyra për tu angazhuar në një komunikim të dyanshëm. Shprehja e njohurive tuaja rreth pikave të forta dhe dobësive, interesave, arritjeve dhe traditave familjare të fëmijës suaj me mësuesit mund të plotësojë mungesat arsimore midis shtëpisë dhe shkollës. Prindërve/Kujdestarëve u rekomandohet të njohin drejtorin, mësuesit dhe stafin që punon çdo ditë me fëmijën dhe të marrin pjesë në ngjarjet dhe aktivitetet shkollore sa herë që është e mundur.

Për të mirë-informuar prindërit/kujdestarët ligjorë rreth ngjarjeve, programeve dhe përparimit të nxënësve, qarku dhe shkolla përdorin një larmi mënyrash komunikimi.

Të Rejat nga Qarku dhe Shkolla

Të rejat rreth programeve dhe aktiviteteve mësimore të qarkut dhe shkollës shpërndahen nëpërmjet faqes së internetit të qarkut www.uticak12.org,

BASHKEPUNIM I SUKSESSHEM

gazetave shkollore, faqeve të mediave sociale, UCS App, mesazheve, kanaleve televizivë të UCS (#15 për WOW) dhe (#22 për Comcast), dhe gazetës së qarkut “Focus for the Community”. Sistemi i automatizuar i thirrjeve telefonike/mesazheve dhe email-it përdoret për të njoftuar prindërit rreth ngjarjeve, aktiviteteve dhe ditëve kur shkollat janë të mbyllura. Sistemi text-email që përdor qarku dhe shkollat është i lidhur me llogarinë “PowerSchool” të nxënësit. Ju lutemi sigurohuni që informacioni juaj në “PowerSchool” është i saktë. Gjithashtu, qarku ka krijuar mundësinë që mësuesit të përdorin sistemin “Remind” të komunikimit me mesazhe.

PowerSchool

Portali On-line për Prindërit dhe Nxënësit

Prindërit/kujdestarët e nxënësve të ciklit të Lartë Fillor, Ciklit të Mesëm të Ulët dhe të Shkollës së Mesme mund të ndjekin progresin e fëmijës së tyre on-line duke përdorur Portalin e Prindërve “PowerSchool”, i cili është një sistem informacioni i UCS për planifikimin, frekuentimin, notat e nxënësve, etj.

Dëftesat (*Report Cards*) dhe rezultatet e NWEA gjithashtu, janë të disponueshme për familjet nëpërmjet “PowerSchool”. Kontaktoni shkollën për udhëzime rreth qasjes në informacionin e fëmijës suaj.

Pasqyra Periodike e Notave

Për klasat 3 – 12, në mes të çdo periudhe shkollore, drejtorët e shkollave do të njoftojnë prindërit në momentin që lista e plotë e notave është në “PowerSchool”.

E Re këtë vit!
UCS Mobile App
[Google Play App Store](#)



Periudhat e Vlerësimeve

Cikli Fillor

Periudhat e vlerësimeve janë katër (4) dhe pasqyrat periodike të notave janë të disponueshme në fund të çdo periudhe, në llogarinë e fëmijës suaj në “PowerSchool”.

Cikli i Mesëm

Viti shkollor zhvillohet në dy semestra. Çdo semestër përfshin dy periudha vlerësimi. Notat semestrale do të vendosen në bazë të kritereve të mëposhtme.

Duke filluar nga klasa e nëntë (9): Nëse brenda një semestri nxënësi ka dy (2) nota jo-kaluese, nota përfundimtare e semestrit do të jetë jo-kaluese. (p.sh., nota e periudhës 1 = F, nota e periudhës 2 = C dhe nota e provimit final = F, do të rezultojë në një notë finale jo-kaluese (F))

	Klasat 7, 8	Klasat 9, 10, 11, 12
Periudha e Vlerësimit 1 ose 3	45%	40%
Periudha e Vlerësimit 2 ose 4	45%	40%
Testimi Final	10%	20%
Nota Finale	100%	100%

Pasqyrat e Notave

Pasqyrat e notave lëshohen në fund të çdo periudhe vlerësimi. Ato janë të disponueshme në llogarinë “PowerSchool” të fëmijës suaj. Ju mund të hyni në llogarinë tuaj nëpërmjet një shfletuesi të rrjetit (Edge, Chrome, Firefox, Safari, etc.) Pasqyrat e notave nuk janë të disponueshme në “PowerSchool App”. Kur ato të bëhen të disponueshme, Shkollat Komunitare të Utikës do të lajmërojnë familjet nëpërmjet një emaili ose mesazhi.

Sistemi Qarkor i Vlerësimit

Ky sistem përdoret për pasqyrat periodike dhe semestrale të notave. Mësuesit mund të përdorin sisteme të ndryshme për vlerësimet e përditshme por në fund të periudhës të gjitha vlerësimet do të përputhen me sistemin e standardizuar të qarkut

Nota	Përqindja	Përgatitja për College GPA	Provimet shtetërore (p.sh., AP or IB)
A	94-100	4.00	4.50
A-	90-93	3.67	4.17
B+	87-89	3.33	3.84
B	83-86	3.00	3.50
B-	80-82	2.67	3.17
C+	77-79	2.33	2.83
C	73-76	2.00	2.50
C-	70-72	1.67	2.17
D+	67-69	1.33	1.83
D	63-66	1.00	1.50
D-	60-62	0.67	1.17
F	*50	0.00	0.00

Konferencat Prindër-Mësues

Prindërit/kujdestarët ftohen të takohen me mësuesit për të diskutuar rreth përparimit të nxënësve, në vjeshtë dhe në pranverë, gjatë ditëve të caktuara për konferencat. Në kohën e konferencës, mësuesit zakonisht sjellin informacion rreth aktivitetit të një nxënësi në klasë, listën e plotësimit të detyrave të shtëpisë dhe rezultatet e testeve. Prindërit/kujdestarët inkurajohen gjithashtu të kontaktojnë mësuesit me email, telefon ose të planifikojnë një konferencë nëse kanë nevojë të diskutojnë çështje specifike.

Korrespondenca me email midis prindit dhe mësuesit aktivizohet pas kërkesës së prindit nëpërmjet plotësimit të formularit elektronik (*Acceptable Use of Technology Parent Request for Academic Progress*) që është i disponueshëm në shkollë.

Xello

“Xello” është një risorsë interaktive on-line, në dispozicion të nxënësve, për përgatitjen për kolegji dhe karrierë, që mundëson anketimin e pikave të forta dhe interesave të tyre të karrierës dhe ofron informacion në lidhje me fushat e karrierës dhe arsimin post-sekondar. “Xello” është i disponueshëm për prindërit dhe nxënësit e “Junior High”.

Për Pyetje ose Shqetësime Kontaktoni:

Mësuesin e fëmijës suaj për:

- Programin mësimor në klasë, materialet, mësimin dhe/ose pyetje rreth testeve.
- Pyetje në lidhje me përparimin e nxënësit tuaj.
- Informacion që mund të ndikojë në arsimimin e fëmijës tuaj.

Drejtorin e fëmijës suaj për:

- Shqetësimet rreth programit dhe klasës, pas një bisede me mësuesin.
- Shqetësimet rreth disiplinës.
- Pyetje rreth menaxhimit të shkollës.

Qarkun Shkollor - Administratorin Ekzekutiv të Shkollave:

- Nëse pyetjet/shqetësimet nuk janë adresuar, pasi keni biseduar me drejtorin e shkollës, ju lutemi kontaktoni Administratorin Ekzekutiv të Qarkut Shkollor në numrin (586) 797-1114.
- Prindërit dhe nxënësit e interesuar që kanë pyetje ose shqetësime në lidhje me të drejtat e nxënësit mund të kontaktojnë Administratorin Ekzekutiv të Qarkut në numrin (586) 797-1114.

Përfshirja e Prindërve në Arsimim

Përfshirja e prindërve/kujdestarëve dhe anëtarëve të komunitetit është një komponent thelbësor për zhvillimin e nxënësve dhe për të siguruar që ata të jenë të suksesshëm. Shkollat Komunitare të Utikës do të bëjnë çdo përpjekje për të përfshirë prindërit/kujdestarët dhe konsideruar kontributin e komunitetit për të siguruar suksesin e nxënësve tanë.

Përfshirja e prindërve në shkollat “Title I” do të udhëhiqet nga Rregullat e parashikuara në Rregulloren 5510 të Bordit Arsimor të Shkollave Komunitare të Utikës. “Title I” është një program federal arsimor për shkollat në zonat demografike me të ardhura të ulëta. Pikësnyimi i “Title I” është ofrimi i mundësive të barabarta për nxënësit.

BASHKEPUNIM I SUKSESSHEM

Shkollat Komunitare të Utikës do të bëjnë të disponueshëm në rrjet artikujt në vijim:

- Informacion rreth Raportit Vjetor
- Kalendarin e Veprimtarive të Qarkut
- Faqet individuale të internetit për çdo shkollë
- Broshurën Prindër/Nxënës (*Parent/Student Handbook*)

Shkollat Komunitare të Utikës gjithashtu, do të ofrojnë për prindërit versionet on-line ose të shtypura të artikujve të mëposhtëm:

- Gazetën e UCS "Focus for the Community".
- Gazetat e shkollave (*School newsletters*)
- Broshurën Prindër/Nxënës (*Parent/Student Handbook*)

Shkollat Komunitare të Utikës ofrojnë informacion për prindërit/kujdestarët rreth aktiviteteve shkollore dhe përditësimeve qarkore, nëpërmjet stacionit televiziv kabllor të komunitetit.

Shkollat Komunitare të Utikës do të koordinojnë dhe integrojnë mundësinë për përfshirjen e prindërve/kujdestarëve në:

- Programet Mbështetëse Akademike
- Garat Akademike

Prindërit/Kujdestarët mund të përfshihen në aktivitetet shkollore duke:

- Ofruar Ndihmë Vullnetare në shkollë
- Ndihmuar fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë
- Marrë pjesë në "Open House"
- Marrë pjesë në takimet Prindër/Mësues
- Duke u antarësuar në Organizatën e Prindërve/Kujdestarëve.

Shkollat Komunitare të Utikës do të krijojnë kushtet e mëposhtme për ndërtimin e kapacitetit për një përfshirje të konsiderueshme të prindërve/kujdestarëve në shkollat tona:

- Ndihmë për prindërit/kujdestarët që të kuptojnë standardet shtetërore të përmbajtjes dhe arritjeve akademike, vlerësimeve shtetërore dhe lokale, dhe kërkesat e "Title I, Part A".
- Mundësi për prindërit/kujdestarët që të monitorojnë përparimin e fëmijëve të tyre dhe të punojnë me edukatorët.
- Materiale dhe burime për prindërit/kujdestarët për t'i ndihmuar ata të punojnë me fëmijët e tyre për përmirësimin e arritjeve akademike.
- Instruktim për administratorët dhe anëtarët e stafit rreth mënyrave të komunikimit dhe të punës me prindërit/kujdestarët si partnerë të barabartë.

BASHKEPUNIM I SUKSESSHEM

- Koordinim të aktiviteteve dhe përfshirjes së prindërve/kujdestarëve në programet e financuara nga shteti dhe që janë në dispozicion të nxënësve.
- Informacion në lidhje me shkollën dhe programet për prindërit/kujdestarët, të ofruar në një format të kuptueshëm dhe uniform, duke përfshirë edhe formate alternative, sipas kërkesave.

Fondet Federale “Title I”

Përfshirja e prindërve/kujdestarëve

Disa shkolla specifike të qarkut marrin fonde federale “Title I”. Në përputhje me ligjin, Bordi i Arsimit ka miratuar një rregullore për përfshirjen e prindërve. Qarku është i angazhuar për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie pozitive me familjet dhe komunitetin. Për këtë qëllim, qarku do të ofrojë një shumëllojshmëri mundësish për familjet dhe anëtarët e tjerë të komunitetit për tu përfshirë në edukimin e fëmijëve.

Prindërit/kujdestarët mund të bëjnë një kërkesë me shkrim për informacion rreth kualifikimeve profesionale të mësuesve të lëndës të nxënësit të tyre duke e paraqitur tek Drejtori Ekzekutiv i Burimeve Njerëzore. Prindërit mund të kërkojnë:

- Nëse mësuesi ka përmbushur kriteret e kualifikimit dhe licencimit të Michigan-it për nivelin e klasave dhe lëndëve për të cilat mësuesi jep mësim;
- Nëse mësuesi është duke dhënë mësim nën një status emergjence apo status tjetër provizor për arsye të të cilit janë pezulluar kriteret e kualifikimit shtetëror apo të licencimit;
- Informacion rreth Diplomës(ve) dhe certifikimeve të tjera të mësuesit, ose rreth fushës së Diplomës/certifikimeve;
- Nëse nxënësit i ofrohen shërbime nga një para-profesional dhe, nëse po, kualifikimet e para-profesionalit.

Ligji për të Drejtat e Arsimit dhe Privatësisë Familjare

(Family Educational Rights and Privacy Act (FERPA))

Të drejtat sipas FERPA

Ligji federal i njohur si “FERPA” (*Family Educational Rights and Privacy Act*) u jep prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve të kualifikuar që janë mbi 18 vjeç disa të drejta në lidhje me të dhënat arsimore të nxënësit. Këto të drejta janë:

1. E drejta për të inspektuar dhe shqyrtuar të dhënat arsimore të një nxënësi brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së një kërkesë për inspektim në qark. Prindërit/kujdestarët ose nxënësit e kualifikuar që dëshirojnë të inspektojnë të dhënat e tyre arsimore duhet t'i

BASHKEPUNIM I SUKSESSHEM

1. paraqesin drejtorit të shkollës një kërkesë me shkrim ku përcaktohen regjistrat që ata dëshirojnë të inspektojnë. Drejtori ose i emëruari i tij/saj do të krijojë mundësinë për inspektim dhe do të njoftojë prindin/kujdestarin ose nxënësin e kualifikuar për kohën dhe vendin në të cilin mund të inspektohen regjistrat.
2. E drejta për të kërkuar ndryshime të të dhënave arsimore që prindi/kujdestari ose nxënësi i kualifikuar beson se janë të pasakta, të parregullta, ose në çfarëdo mënyre, në shkelje të të drejtave të privatësisë së nxënësit sipas FERPA. Nxënësit e kualifikuar ose Prindërit/kujdestarët që dëshirojnë të kërkojnë nga qarku ndryshimin e të dhënave arsimore të tyre ose të fëmijës së tyre, sipas rastit, duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim tek drejtori i shkollës, në të cilën përcaktohen qartësisht të dhënat që ata dëshirojnë të ndryshojnë dhe të specifikohen arsyet për të cilat besojnë se duhet bërë ndryshimi. Nëse qarku vendos të mos e lejojë ndryshimin e të dhënave sipas kërkesës, shkolla do të njoftojë prindin/kujdestarin ose nxënësin e kualifikuar rreth vendimit dhe të drejtës së tyre për një seancë dëgjimore në lidhje me kërkesën për ndryshim. Informacion shtesë në lidhje me procedurat e dëgjimit do t'i jepen prindit/kujdestarit ose nxënësit të kualifikuar në momentin që ata njoftohen për të drejtën e një seance dëgjimore.
3. E drejta për të dhënë një aprovim me shkrim para se qarku të shpërndajë informacione personale të identifikueshme nga të dhënat arsimore të nxënësit, përveç rastit kur shpërndarja pa miratim është e autorizuar nga FERPA. Një përjashtim, që lejon shpërndarjen e të dhënave pa miratim bëhet për zyrtarët e shkollave me interesa të ligjshme arsimore. Konsiderohen si zyrtarë të caktuar të shkollës me interesa të ligjshme arsimore, personat e punësuar nga qarku si administratorë, mësues ose persona të tjerë të caktuar nga Bordi i Arsimit. Gjithashtu, konsiderohet si një zyrtar i caktuar, një oficer ndërlidhës policor, i cili, edhe pse nuk është i punësuar nga qarku, mund të ketë mundësinë e qasjes tek të dhënat arsimore të nxënësve (duke përfshirë pamjet filmike) nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e një administratori të shkollës. Ky konsiderim mund të përfshijë gjithashtu një kontraktor ose konsulent i cili, edhe nëse nuk është i punësuar nga qarku, kryen një shërbim apo funksion institucional (si projektimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kamerave të sigurisë së qarkut) për të cilin shkollës do ti duhej të përdorte punonjësit e vet dhe që është nën kontrollin e drejtpërdrejtë të qarkut gjatë përdorimit dhe mbajtjes së të dhënave personale arsimore të identifikueshme të nxënësve.
4. E drejta për moslejimin e shpërndarjes së Informacionit të Arkivuar. Informacioni i Arkivuar i një nxënësi mund t'i lëshohet, përveç nxënësit të kualifikuar ose prindit/kujdestarit, edhe çdo personi apo pale kërkuese, pa aprovim me shkrim. Bordi i Arsimit ka përcaktuar që, konsiderohen si

"informacione të arkivuara": emri; adresa; pjesëmarrja në aktivitete dhe sporte të njohura zyrtarisht; datat e pjesëmarrjes; peshë dhe gjatësia e anëtarëve të ekipeve atletike; notat, nderime dhe çmime të marra; informacione që gjenden përgjithësisht në librat vjetorë; Emrat, adresat dhe numrat e telefonit të nxënësve, vetëm kur kërkohen nga rekrutuesit ushtarakë. Nxënësit e kualifikuar dhe prindërit/kujdestarët mund ta ndalojnë shpërndarjen e pjesëshme ose të plotë të informacioneve të tilla të arkivuara, duke paraqitur një kërkesë me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së njoftimit publik nga qarku. Prindërit/Kujdestarët mund të paraqesin kërkesën me shkrim tek drejtori i shkollës së fëmijës së tyre.

5. Prindërit/kujdestarët dhe nxënësit e kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin një ankesë për qarkun, pranë Departamentit Amerikan të Arsimit për mosplotësim të kërkesave të FERPA. Emri dhe adresa e zyrës që administron FERPA-n është:

*" Student Privacy Policy Office
U.S. Department of Education
400 Maryland Avenue SW Washington DC 20202-5280"*

Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara

(United States Armed Forces)

Qarkut i kërkohet të ofrojë për rekrutuesit e Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara të njëjtën qasje ose më shumë, tek informacioni i arkivuar studentor që u ofrohet enteëve të tjera të cila ofrojnë mundësi edukimi ose punësimi për nxënësit siç është e lejuar dhe/ose e kërkuar nga ligji. Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara përbëhen nga forcat e armatosura, rezervistët, dhe Roja Bregdetare e Shteteve të Bashkuara. Një nxënës i kualifikuar ose prind/kujdestar mund të paraqesë në qark, një kërkesë me shkrim, të firmosur, në të cilën kërkohet që informacioni i arkivuar i nxënësit të mos qaset nga rekrutuesit e Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara. Në një rast të tillë, informacioni nuk do të shpërndahet.

Agjencitë dhe Institucionet e Tjera

Siç lejohet nga FERPA, qarku mund të përcjellë, pa aprovimin e nxënësit ose të prindërve, të dhëna arsimore në të cilat përfshihen edhe të dhënat disiplinore, në agjenci apo institucione të tjera në të cilat nxënësi kërkon ose ka ndërmend të regjistrohet ose është regjistruar, për derisa zbulimi i të dhënave bëhet për qëllime që lidhen me regjistrimin ose transferimin e nxënësit dhe nëpërmjet një kërkesë për të dhënat e shkollës ose arsimit të një nxënësi.

Respektimi i Kërkesave

Qarku do tu përgjigjet kërkesave legjitime për qasje në regjistrat arsimorë brenda një periudhe të arsyeshme, por jo më shumë se tridhjetë (30) ditë pas marrjes së kërkesës ose brenda një periudhe më të shkurtër siç mund të jetë ligjërisht e zbatueshme për nxënësit me aftësi të kufizuara. Palës kërkuese mund t'i kërkohej një tarifë për procedurën e informacionit.

Mosha Madhore

Pas një kërkesë me shkrim tek drejtori ose tek një person i autorizuar me shkrim nga drejtori, nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeç e lart mund të marrin të gjithë korrespondencën e tyre personale të shkollës, mund të kenë qasje në regjistrat e tyre shkollorë dhe mund të nënshkruajnë justifikime për vetveten.

Nxënësit në moshë madhore, gjithsesi, i nënshtrohen rregullave dhe rregulloreve të Bordit të Arsimit dhe të shkollës së tyre.

Inspektimi i Materialeve Mësimore nga Prindërit/Kujdestarët

Prindërit/kujdestarët kanë të drejtë të inspektojnë, me paraqitjen e një kërkesë, çdo material mësimor që përdoret si pjesë e programit arsimor të qarkut. Prindërve/kujdestarëve do tu mundësohet qasje në materialet mësimore brenda një periudhe të arsyeshme kohore pasi kërkesa të jetë marrë nga drejtori. Termi "material mësimor" do të thotë përmbajtja mësimore që i ofrohet një nxënësi, pavarësisht nga formati i tij, duke përfshirë materialet e integruara dhe përfaqësuese, materialet audio-vizive dhe materialet në formate elektronike ose dixhitale (të tilla si materialet që qasen nëpërmjet internetit). Ky term nuk përfshin testet apo vlerësimet akademike.

Privatësia e Nxënësve dhe Qasja e Prindërve tek Informacioni

Sipas Amendamentit federal për Mbrojtjen e të Drejtave të Nxënësve (*Protection of Pupil Rights Amendment*), asnjë nxënësi nuk do ti kërkohej, si pjesë e programit mësimor të shkollës ose të qarkut, pa pëlqimin paraprak të prindit/kujdestarit, që t'i nënshtrohet ose të marrë pjesë në ndonjë sondazh, analizë apo vlerësim që shpërndan informacione në lidhje me:

- Përkatësitë ose bindjet politike të nxënësit ose të prindit/kujdestarit të nxënësit;
- Probleme mendore ose psikologjike të nxënësit ose të familjes së nxënësit
- Sjelljen ose preferencat seksuale
- Sjellje të paligjshme, anti-sociale, vetë-inkriminuese ose poshtëruese
- Vlerësime kritike të individëve të tjerë me të cilët nxënësit kanë marrëdhënie të ngushta familjare;
- Marrëdhënie të privileguara dhe analoge të njohura ligjërisht, të tilla si me avokatë, mjekë dhe ministra;

- Praktikrat fetare, përkatësitë ose bindjet e nxënësit ose të prindit/kujdehtarit të nxënësit; ose
- Të ardhurat (përveç atyre që kërkohen nga ligji për të përcaktuar kriteret për pjesëmarrje në një program siç është ai i marrjes së ndihmës financiare).

Kjo kërkesë vlen edhe për mbledhjen, shpërndarjen, ose përdorimin e informacionit të nxënësve për qëllime marketingu (sondazhe marketingu), dhe për disa ekzaminime dhe kontrolle fizike.

Prindërit/kujdehtarët kanë të drejtë, me paraqitjen e një kërkesë, të inspektojnë një sondazh ose vlerësim të krijuar nga një palë e tretë përpara se sondazhi/vlerësimi të jetë administruar ose shpërndarë nga shkolla tek nxënësi. Prindit do t'i lejohet qasje në sondazh/vlerësim brenda një periudhe të arsyeshme kohore pas pasi drejtori të ketë marrë kërkesën.

Refuzimi i Edukimit Shëndetësor

Sipas Aktit Publik 226 të vitit 1977, prindërit/kujdehtarët ligjorë kanë të drejtë të shqyrtojnë materialet që do të përdoren në lëndët në të cilat mësohet shëndeti riprodhues. Ata kanë të drejtë të justifikojnë, pa asnjë pasojë, fëmijën e tyre për mungesë pjesëmarrjeje në një klasë ose kurs ku mësohet rreth shëndetit riprodhues dhe sindromës së fituar të immunodeficiencës (*Acquired immunodeficiency syndrome (AIDS)*). Mësimi rreth AIDS është i përfshirë në lëndët e Edukimit Shëndetësor.

Siguria në Shkollë

Shkollat Komunitare të Utikës janë të angazhuara për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të siguruar në të gjitha shkollat dhe programet, në të gjithë qarkun. UCS ka vënë në zbatim plane të plota sigurie dhe sigurimi për mirëqenien e nxënësve, stafit dhe vizitorëve. Këto plane përfshijnë instruktimin dhe praktikimin me nxënësit dhe stafin, rreth hapave që duhet të ndërmerren në rastet e situatave emergjente. Çdo shkollë bën simulime për të praktikuar reagimin ndaj zjarrit, motit, urgjencave mjekësore dhe problemeve të tjera të sigurisë duke ju përmbajtur standardit të protokolleve të veprimit. Mbyllja e dymve, kamerat dhe partnerët tanë të zbatimit të ligjit përfshihen në planin e përgjithshëm.

Vizitorët

Personat që vizitojnë shkollat dhe faqet e programeve të UCS për arsye legjitime, janë gjithmonë të mirëpritur. Të gjithë vizitorët, duke përfshirë prindërit/kujdestarët, duhet të identifikohen me një dokument identifikimi tek personeli i zyrës përpara se të lejohen të hyjnë në objekt dhe të shkojnë në zyrë për të nënshkruar.

Individëve që u jepet leje për të hyrë përtej zyrës kryesore do tu lëshohet një distinktiv vizitori që duhet të mbahet i dukshëm në çdo moment. Të gjithë vizitorët janë subjekt i Rregulloreve të Bordit të Arsimit dhe duhet të largohen menjëherë pasi mbarojnë punë.

Kontrolli i Historisë Penale për Vullnetarët

Për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve, çdo vullnetar duhet të ketë në dosje, një formular të Kërkesës për Vullnetarët, të miratuar nga shkolla, shumë më përpara kohës së përfshirjes si vullnetar në veprimtaritë shkollore ose ato në lidhje me shkollën. UCS kryen kontrole të historisë kriminale të vullnetarëve nëpërmjet Policisë së Shtetit të Michigan-it. Të gjithë vullnetarëve u kërkohet të mbajnë një distinktiv të lëshuar nga zyra e shkollës, në çdo moment të hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga ndërtesa e shkollës.

UCS punon në lidhje të ngushtë me partnerët lokalë të zbatimit të ligjit për të ofruar një mjedis mësimor të sigurt dhe pozitiv. Për informacion rreth strategjive të menaxhimit të sigurisë së qarkut, ju lutem vizitoni: <http://uticak12.org/ucssafety>



QASJE E DYFISHTË NË SIGURI DHE SUCCESS

Në Utica Community Schools çdo individ luan një rol të rëndësishëm për sigurinë dhe suksesin e studentëve tanë.

PROTOKOLLET STANDARDE TË REAGIMIT:

Një përgjigje uniforme dhe e qartë për çfarëdo krize.

Në pritje! Në dhomë ose zonë, larg nga koridoret.

Të sigurtë! Brenda në dhomë me dyer të kyçura.

Të kyçur! Dyer të kyçura, drita të fikura dhe të fshehur.

Në lëvizje! (Drejt një vendi specifik)

Të strehuar! Strategji për rrezikun dhe sigurinë



SIGURIA NE SHKOLLE

INSTRUKTIMI DHE PRITSHMERIA

Trajnimi – Stafi është trajnuar rreth protokolleve që kanë të bëjnë me aksidentet, vlerësimin e rrezikshmërisë, CPR, ndihmën mjekësore dhe përdorimin e Defibrilatorit Automatik.

Plani i Veprimit i Emergjencës – Çdo shkollë ka një Plan Veprimi për Emergjencën që identifikon protokolle dhe përgjigje për një gamë të gjerë problemesh që kanë të bëjnë me sigurinë në shkollë.

Drejtori i Sigurimit dhe Shërbimeve të Menaxhimit – Ky rrol mbështet implementimin e protokolleve të sigurisë dhe praktikave të gjithë qarkut.

MJEDISI MESIMOR

Hyrje të sigurta – Të gjithë vizitorët duhet të paraqesin një dokument identifikimi përpara se të lejohen të hyjnë në shkollë. Të gjithë vizitorët duhet të hyjnë në shkollë nga hyrja kryesore.

Dyer me sistem identifikimi – Të gjitha dyert e jashtme janë të mbyllura. Hyrja në objekte është e lejuar vetëm për personelin e autorizuar që është i pajisur me skedë identifikuese elektronike.

Dyer me mbyllje të siguruar – Mekanizmat “NightLock” janë instaluar dhe bravat e deryve janë në procesin e zëvendësimit për një mbyllje më të sigurt.

Kamera sigurie – Kamerat aksesohen nga forcat e rendit në raste emergjence.

Forca të rendit të dedikuara – Oficerë të posaçëm të forcave të rendit për çdo shkollë të mesme.

Specialistë për sigurinë në shkollë – Ish oficerë të forcave të rendit, të punësuar nga qarku, janë të caktuar tek çdo shkollë Junior High dhe në të gjitha shkollat elementare.

Forcat e Rendit – Agjencitë lokale të Forcave të rendit punojnë drejtpërdrejt me të gjithë qarkun, për identifikimin dhe implementimin e praktikave optimale për një ambient mësimor të sigurt.

Gjuhë e Përbashkët – Protokollat e Standardizuara të Veprimit (SRP) janë adoptuar për tu siguruar që të gjithë në shkollë të dinë si të reagojnë në rast të një situatë emergjente.

SHENDETI MENDOR

Mirëqenia në UCS – Risorsa për të ofruar udhëzime dhe vetëdije për shërbimet e shëndetit mendor.

Komunikimi – Qarku po punon me këshilltarët e shkollave për të kuptuar gjuhën e përbashkët të komunikimit të sigurisë.

“SMART Moves & Dare” – Edukim i ofruar nga partnerët e forcave të rendit për të promovuar marrjen e vendimeve pozitive.

Trajnimi – Stafi është i trajnuar në “Trauma Informed and Resilient Schools” nëpërmjet “Starr Commonwealth”

Partnerizimi me “CARE of Southeastern Michigan” – Ofron rekomandime për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë me shërbimet e shëndetit mendor.

“OK2SAY” – Një program për sigurinë e nxënësve që i lejon ata të raportojnë në mënyrë konfidenciale informacione rreth çfarëdo aktiviteti kriminal ose potencialisht të dëmshëm për nxënësit ose për shkollën.

“Character Strong” – Një program K-12 i bazuar në studime rreth mirëqenies dhe një shërbim instruktimi profesional që ndikojnë pozitivisht në jetën e përditshme.

“MI-BEST” (Macomb Intermediate Behavioural & Emotional Support Team) – Shërbime këshillimore të ofruara nëpërmjet një sistemi rekomandues.

Armët në Mjediset, Pronat, Automjetet Shkollore ose Veprimtaritë e Sponsorizuara nga Shkolla

UCS ndalon çdo person të mbajë, të ruajë, të prodhojë ose të përdorë një armë në çdo mjedis që është nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e UCS duke përfshirë, por pa u kufizuar me, pronat e marra me qira, në pronësi ose të kontraktuara nga UCS, për veprimtari të sponsorizuar nga shkolla ose në një automjet në pronësi të UCS.

Ky ndalim zbatohet gjithsesi edhe nëse një person është i autorizuar me ligj të mbajë armë në ambiente jo shkollore, duke përfshirë edhe rastet kur personi ka leje për armëmbajtje të mbuluar. Më poshtë janë renditur përjashtimet e kësaj rregulloreje:

- Armët nën kontrollin e personelit të forcave të rendit. Artikujt e miratuar nga një drejtor si pjesë e një projekti apo prezantimi individual ose të një klase nën mbikëqyrjen e të rriturve, nëse përdoren për qëllime dhe në mënyra të miratuara (armët e zjarrit funksionuese dhe municionet nuk do të miratohen kurrë), shëmbëlltyra teatrale të përdorura në mjediset e përshtatshme, pistoletat sinjalizuese të fillimit të garave të përdorura në ngjarjet sportive të përshtatshme.
- Instrumentet ose pajisjet që kërkohen nga operacione të Qarkut, të cilat përfshijnë sigurinë e shkollës ose të qarkut.
- Personat që shkelin me vetëdije këtë rregullore mund të referohen tek forcat e rendit. Për informacion të mëtejshëm konsultoni Rregulloren 6120 që gjendet në faqen e internetit të UCS.

Dispozitivët e Identifikimit të Nxënësve

High School dhe Junior High

Garantimi i sigurisë dhe sigurimit për të gjithë nxënësit dhe stafin është një përparësi çdo ditë. Përveç përmirësimit të sigurisë, mbajtja e skedave të identifikimit nga nxënësit dhe stafi ofron një mjedis profesional dhe promovon gatishmërinë për Kolegjin dhe Karrierën për të gjithë nxënësit.

Përdorimi i skedave të identifikimit kërkohet në shumë mjedise pune dhe territore kolegjiale/universitare. Një skedë identifikimi dhe një rrip mbajtës për skedën do t'i jepen falas çdo nxënësi.

Arsyet për të cilat nxënësit i nevojitet një skedë identifikimi janë:

- Për të qëndruar në klasë
- Për të huazuar tekste mësimore dhe libra nga libraria e shkollës
- Për dalje nga shkolla përpara orarit të zakonshëm

- Për të lëvizur brenda shkollës, nga një ambient në tjetrin.
- Për të qëndruar në territorin shkollor përpara ose pas orarit normal të shkollës.
- Për të marrë pjesë në aktivitete shkollore, asamble, kërcime, etj..

Udhëzime rreth Skedave Identifikuese të Nxënësve

(Student ID Card)

Skeda identifikuese e një nxënësi e autorizon atë të qëndrojë në territorin e shkollës. ÇDO nxënës duhet të ketë me vete skedën e identifikuese kur është në shkollë.

Është shumë e rëndësishme që stafi i shkollës të jetë në gjendje të identifikojë të gjithë nxënësit në territorin shkollor. Identifikimi i stafit dhe nxënësve është një çështje sigurie dhe nuk do të komprometohet. Skedat e identifikimit të nxënësve, gjatë natës, mund të lihen në dollapin (*locker*) që i është caktuar nxënësit, për të siguruar që të mos harrohet në shtëpi.

Nxënësit duhet tu përmbahen udhëzimeve të mëposhtme kur përdorin skedën identifikuese:

- Skedat e identifikimit të nxënësve duhet të mbahen me vete dhe duhet të jenë të dukshme në çdo kohë. (d.m.th., të mos mbahen në çantë, xhep apo çantë shpine).
- Skeda identifikuese e nxënësit duhet t'i paraqitet çdo anëtar të stafit të shkollës ose personi të autorizuar nga shkolla, sipas kërkesës.
- Pjesa e përparme dhe e pasme e skedës së identifikimit të nxënësit nuk mund të ndryshohet (p.sh. shënime, foto etj.). Dëmtimi ose ndryshimi i skedës identifikuese është i ndaluar.
- Përdorimi i skedës identifikuese të një nxënësi tjetër është i ndaluar.
- Skedat e identifikimit të humbura, të vjedhura, të ndryshuara, të dëmtuara dhe/ose të deformatuara duhet të zëvendësohen menjëherë.

Nxënësit që nuk i përmbahen udhëzimeve të mësipërme janë subjekt i një penalizimi në kohën e drekës (ose pas orarit të rregullt shkollor) dhe një tarifë zëvendësimi prej 5.00 \$ në rastet kur një skedë identifikimi humbet. Nxënësit mund të blejnë një lidhëse të re nga shkolla ose jashtë shkolle.

Lidhëset "Tear away" rekomandohen. Nxënësit që nuk u përmbahen udhëzimeve dhe insistojnë të mos binden janë subjekt i pasojave të mëtejshme në shkollë.

Mbyllja Emergjente e Shkollave / Ditët me Mot të Ashpër

Në rast të motit të ashpër të paqëndrueshëm dhe/ose mungesës së energjisë elektrike, ngrohjes, ujit ose emergjencave të tjera, Shkollat Komunitare të Utikës mund të: mbyllën për gjithë ditën, mbahen të hapura por pa ofrim transportimi, vonojnë kohën e fillimit të mësimin dhe orarin e transportimit, dhe mund të mbarojnë mësimin para kohe.

Prindërit do të njoftohen për mbylljen emergjente të shkollave me telefon dhe/ose email nëpërmjet një sistemi të automatizuar. Në varësi të kushteve, telefonatat/email-et mund të dërgohen një natë më përpara ose herët në mëngjes në ditën e mbylljes.

Nëse nxënësit duhet të dalin nga mësimi para kohe, do të bëhen përpjekje për të kontaktuar prindërit/ kujdestarët ose personin që ata kanë regjistruar për tu përgjigjur në vend të tyre në rast emergjence. Ju lutem sigurohuni që fëmija juaj është në dijeni të planit të familjes suaj për rastet e mbylljes emergjente të shkollës.

Mbylljet e emergjencës do të transmetohen edhe në stacionet radiofonike WJR- 760 AM dhe WWJ-950 AM, në stacionet televizive WJBK-2, WDIV-4 dhe WXYZ- 7, në faqen e internetit të qarkut www.cticak12.org dhe në kanalet kabllore UCS - TV 15 dhe 22.

Mesazhet Telefonike të Automatizuara

Në rast të mbylljes emergjente të shkollave, prindërit/kujdestarët do të njoftohen me anë të një mesazhi telefonik të automatizuar duke përdorur numrat e listuar në seksionin e informacionit për rastet emergjente të nxënësit të tyre në "PowerSchool". Prindërve/ kujdestarëve u kërkohet të njoftojnë shkollën menjëherë për çdo ndryshim të informacionit të tyre në seksionin e emergjencës. Sistemi i automatizuar mund të përdoret edhe për njoftime të tjera të ndryshme.

Shëndeti dhe Mirëqenia e Nxënësit

Shkollat Komunitare të Utikës janë të angazhuara për të edukuar fëmijën në të gjitha drejtimet. Shërbimet për shëndetin dhe mirëqenien ndihmojnë nxënësin të zhvillojnë aftësi që mbështesin zakone të shëndetshme dhe dëshirën për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Risorsat e UCS për Mirëqenien

Ju mund të gjeni një mori informacionesh dhe burimesh rreth mirëqenies në faqen tonë të internetit nën "About Us". Faqja përfshin "Monday Moments" (këshilla për një fillim pozitiv të javës suaj), një seri episodesh të "Podcademy" sponsorizuar nga këshilltarët e UCS dhe burimet e komunitetit.

Promovimi i Shëndetit

Mënyra më e mirë për të parandaluar sëmundjet është të inkurajojmë zakone të shëndetshme si:

- **Larja e duarve** – Duart e papastra janë shkak i infeksioneve. Fëmijët gjithmonë duhet të lajnë duart para se të hanë dhe pasi të përdorin banjën ose të fshijnë hundën. Sigurohuni që fëmija juaj t'i lajë mirë të gjitha sipërfaqet e duarve të tij ose të saj me sapun dhe ujë, t'i shpërlajë mirë dhe t'i thajë me një peshqir.
- **Ushqyerja e mirë** – Ngrënia e ushqimeve të pasura me vlera ushqyese, veçanërisht në mëngjes, ndihmon fëmijët të përqendrohen.
- **Pushimi dhe gjumi** – shumica e fëmijëve kanë nevojë për të paktën tetë orë gjumë çdo natë.
- **Ushtrimet fizike** – Janë shumë të rëndësishme për shëndetin. Fëmijët mund të stërviten nëpërmjet lojërave në natyrë, sporteve të organizuara ose aktiviteteve familjare.
- **Higjiena e mirë** – fëmijët ndihen më rehat dhe kanë një qëndrim më të mirë për veten dhe detyrat e tyre shkollore kur janë të pastër dhe paraqiten mirë. Kontrolloni paraqitjen e fëmijës suaj para se të dalë nga shtëpia.



Mjekimi

Të gjitha mjekimet e nxënësve, në shtëpi duhet të administrohen nën mbikëqyrjen e një prindi/kujdestari. Kur është arsyeshmërisht e nevojshme, qarku do të administrojë dhe mbikëqyrë administrimin e mjekimeve të rekomanduara (vetëm ato të miratuara nga FDA) dhe mjekimet pa recetë (vetëm ato të miratuara nga FDA) në përputhje me Rregulloren 5325 – Administrimi i mjekimeve dhe Rregulloret përkatëse.

Prindërit/kujdestarët duhet të paraqesin një formular autorizimi pranë zyrës së shkollës në mënyrë që nxënësit të marrin mjekimin (vetëm nëse është i miratuar nga FDA) në shkollë ose gjatë aktiviteteve shkollore dhe mjekimet pa recetë në shkollë ose gjatë aktiviteteve shkollore (vetëm nëse janë të miratuara nga FDA).

Shkollat Komunitare të Utikës mbajnë të paktën dy auto-injektues funksionues të epinefrinës në çdo ndërtesë shkolle që është operative.

Kërkesat e Imunizimit

Në regjistrim, ligji shtetëror kërkon që prindërit t'i paraqesin shkollës të dhëna të hollësishme të imunizimit që përfshijnë muajin, ditën dhe vitin në të cilin fëmija u vaksinua kundër fruthit, shytave dhe rubeolës (MMR), varicelës, poliomielitit, hepatitit B, difterisë, pertussis (kollës së bardhë) dhe tetanozit (DTaP, DT, Td ose Tdap). Dokumente justifikimi për arsye të veçanta (*Waivers*) janë në dispozicion nëpërmjet Departamentit Shëndetësor të Macomb-it (*Macomb County Health Department*).

Gjithashtu, prindërve të fëmijëve që janë në kopsht, në klasë të shtatë ose të rinj në qark do tu kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë për të pranuar ose refuzuar shpërndarjen e informacionit të imunizimit me Departamentin Shëndetësor të Qarkut të Macomb-it (*Macomb County Health Department*). Përveç kësaj, të gjithë nxënësit që hyjnë në klasën e shtatë, pavarësisht nga koha e hyrjes në qark, janë të detyruar të përmbushin kërkesën aktuale për vaksinat e fruthit, shytave dhe rubeolës (MMR), difterisë, pertussis (kollës së bardhë) dhe tetanozit; varicelës, poliomielitit, hepatitit B dhe vaksinat e meningokokut, duke paraqitur një dokument imunizimi.

Rekordet e imunizimit ose një dokument justifikimi (*Waiver*) kërkohen përpara ditës së parë të shkollës. Nxënësit që nuk paraqesin rekordin e imunizimit ose një "Waiver", do të përjashtohen nga shkolla. Për më shumë informacion, telefononi Klinikën e Imunizimeve për Shkollat të Departamentit Shëndetësor të Qarkut të Macomb-it (*Macomb County Health Department School Immunization Clinic*) në numrin 586- 466-6840.

Kontrolli i Dëgjimit, Shikimit dhe Dhëmbëve

Për regjistrimin në "Kindergarten" kërkohet ekzaminimi i dëgjimit dhe shikimit. Këto ekzaminime mund të bëhen nga mjeku i fëmijës ose Departamenti Shëndetësor i Macomb-it (*Macomb County Health Department*).

Ekzaminimi i shikimit

Departamenti Shëndetësor i Macomb-it do të ofrojë ekzaminim të shikimit për nxënësit e klasës së shtatë dhe të nëntë ose me rekomandime të tjera.

Ekzaminimi i dhëmbëve

Programi i shëndetit oral për fëmijët e kopshtit (*Kindergarten Oral Health Assessment Program*) i Departamentit të Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore kërkon që për vitin shkollor 2024-2025, fëmijët e kopshtit duhet të ekzaminohen dhëmbët përpara hyrjes në Kindergarten.

Me përfshirjen e të gjithë departamenteve shëndetësore të Shtetit të Michigan-it, duke filluar nga viti shkollor 2025-2026, ekzaminimi i dhëmbëve do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e kopshteve.

Rikuperimi në Shtëpi

Kur është fëmija shumë i sëmurë për të ndjekur shkollën? Udhëzimet e mëposhtme, së bashku me këshillat e mjekut tuaj të familjes, do t'ju ndihmojnë të vendosni se kur fëmija duhet të rrijë në shtëpi:

- **Ftohja dhe/ose kolli** – një fëmijë me mukozë të irrituar që shkakton kollë dhe kullim të rëndë të hundës nuk mund të qëndrojë në shkollë.
- **Ethet** – ethet janë një paralajmërim se diçka nuk shkon. Një fëmijë duhet të qëndrojë në shtëpi për 24 orë pasi ethet kanë kaluar pa përdorimin e ilaçeve.
- **Reshi** – një skuqje e lëkurës ose njolla në lëkurë mund të jenë shenja e parë e shumë sëmundjeve. Në këtë rast kërkohet deklarimi i mjekut që ato nuk janë ngjitëse.
- **Dhimbjet e stomakut/të përzierat** – një fëmijë që është duke vjellë ose ka diarre duhet të mbahet në shtëpi dhe mund të kthehet në shkollë 24 orë pasi simptomat janë zhdukur.
- **Parazitët e kokës** – një fëmijë që ka parazitë në kokë duhet të mbahet në shtëpi derisa të përfundojë trajtimin për eliminimin e parazitëve dhe të konfirmohet nga zyrtarët e shkollës që ai/ajo është pastruar nga parazitët. Kontrolloni kokën e fëmijës para se të fillojë

shkolla në vjeshtë dhe rregullisht gjatë vitit shkollor ose nëse ai/ajo ankohet për kuarje koke. Shikoni rreth veshëve të fëmijës tuaj dhe pas qafës për vezë të parazitëve, të cilat janë shumë të vogla, të bardha, në formë ovale dhe janë të ngjitura në rrënjën e flokut pranë lëkurës. Vezët mund të duken si zbokth, por ato nuk lëvizin dhe hiqen me vështirësi. Njoftoni menjëherë zyrën e shkollës nëse fëmija juaj ka parazitë në kokë. Filloni trajtimin menjëherë duke u konsultuar me mjekun tuaj ose duke përdorur solucione që shiten pa recetë në farmaci. Për të parandaluar përhapjen e parazitëve të kokës, lani të gjitha rrobat e infektuara, aksesorët e flokëve, çarçafët dhe sipërfaqe të tjera me ujë të nxehtë dhe dezinfektues. Ju duhet të shoqëroni fëmijën tuaj dhe të firmosni në zyrën e shkollës kur ai/ajo është duke u kthyer në shkollë pas trajtimit për parazitët e kokës.

Trajtimi i Aksidenteve

Çdo nxënës i lënduar gjatë orëve të mësimi ose gjatë pjesëmarrjes në aktivitete sportive ose të sponsorizuara nga shkolla, duhet të raportojë menjëherë dëmtimin tek një instruktor dhe/ose në zyrën e shkollës. Një raport aksidenti do të përpilohet dhe prindërit/kujdestarët do të njoftohen kur është e nevojshme.

Nëse lëndimi/dëmtimi kërkon kujdes mjekësor profesional, prindërve/kujdestarëve do tu kërkohet të marrin fëmijën e tyre nga shkolla ose nga një institucion mjekësor. Nëse për nxënësin nevojitet trajtim mjekësor urgjent dhe prindi/kujdestari nuk mund të kontaktohet, shkolla do të telefonojë 911 për ta transportuar fëmijën në spital me ambulancë. Nëse një nxënës duhet të transportohet me ambulancë në spital, një zyrtar i shkollës do ta shoqërojë atë derisa një prind/kujdestar të paraqitet në spital. Spitali duhet të ketë miratimin paraprak të prindit/kujdestarit para se të trajtojë një të mitur.

Informacioni i Kontaktit Emergjent

Në fillim të çdo viti shkollor, dhe gjatë gjithë vitit, prindërve/ kujdestarëve u kërkohet të plotësojnë ose përditësojnë informacionin e emergjencës të fëmijës së tyre në "PowerSchool". Informacioni i ofruar do t'i mundësojë shkollës t'ju njoftojë në rast sëmundjeje/dëmtimi të papritur të fëmijës suaj ose për mbylljen e shkollës në rast emergjence. Duhet të regjistroni në "PowerSchool" numrat e telefonit të shtëpisë, celularit dhe të punës. Ju gjithashtu duhet të regjistroni emrat dhe numrat e telefonit të të afërmve ose miqve që janë të disponueshëm dhe që kanë pranuar të kujdesen përkohësisht për fëmijën tuaj

Në rastet kur prindi/kujdestari nuk mund të arrihet. Në situata emergjente, prindi/kujdestari njoftohet i pari i ndjekur nga kontakti i emergjencës i regjistruar nëse prindi/kujdestari nuk mund të arrihet.

Ndërgjegjësimi rreth Konkusioneve

Konkusioni është një lloj dëmtimi traumatik i trurit që ndryshon mënyrën normale të funksionimit të trurit. Një konkusion shkaktohet nga një rënie, goditje ose shkundje e kokës ose e trupit që shkakton një lëvizje ose shkundje të fortë të papritur të kokës dhe trurit. Një faqe informative rreth simptomave dhe masave që duhet të merren nëse dyshohet për një konkusion gjendet në faqen e internetit të qarkut <http://www.uticak12.org>, në faqen e formularëve, nën seksionin e atletikës. Për informacione të mëtejshme kontaktoni drejtorin e shkollës suaj.

Informacioni Shëndetësor

Nxënësit që kërkojnë mbështetje për invaliditet të përkohshëm ose të përhershëm, alergji, ose sëmundje, duhet të kontaktojnë drejtorin për shkollat elementare ose departamentin këshillimor për nxënësit e ciklit sekondar në fillim të vitit shkollor ose në çdo moment në të cilin paraqitet nevoja për mbështetje. Ky informacion do shpërndahet tek mësuesit dhe anëtarë të tjerë të stafit, sipas nevojës.

Syzet Mbrojtëse

Syzet mbrojtëse do tu jepen nxënësve dhe duhet të mbahen në kurset ku ato nevojiten.

Sigurimi për Nxënësin

Shkollat Komunitare të Utitës u ofrojnë nxënësve një sigurim bazë për aksidentet që mund të ndodhin në shkollë ose kur marrin pjesë në aktivitete të sponsorizuara nga shkolla.

Një nxënës duhet të raportojë çfarëdo aksidenti, menjëherë në zyrën e shkollës. Për marrjen e përfitimeve është e nevojshme që prindi të plotësojë një formular. Do të konsiderohen vetëm shërbimet që nuk mbulohen nga sigurimi familjar ose i punëdhënësit ose i grupit. Viktimës së aksidentit mund ti kërkohet të paguajë një kuotë. Periudha e sigurimit zgjat 52 jave nga data e lëndimit.

Mbrojtja e Ambientit Shkollor nga Droga dhe Alkoli.

Bordi i Arsimit është i ndërgjegjshëm që keqpërdorimi i drogërave është një problem serioz me implikacione legale, fizike dhe sociale për të gjithë komunitetin shkollor. Në përputhje me ligjin shtetëror dhe federal, Bordi i Arsimit, përkufizon si “Zonë Shkollore të Pastër nga Droga” hapësirën që shtrihet 1000 Feet (305 mt) nga kufiri i çfarëdo ambienti në pronësi të shkollës. Bordi i Arsimit ndalon rreptësisht përdorimin, mbajtjen, fshehjen, ofrimin ose shpërndarjen e çfarëdo droge ose mjete që lidhet me përdorimin e drogës, duke përfshirë alkoolin dhe marijuanën, në çfarëdo kohe, në territorin e shkollës brenda “Zonës Shkollore të Pastër nga Droga” dhe në çfarëdo aktiviteti në lidhje me qarkun. Përveç kësaj, Drejtori i Qarkut ose i deleguari i tij do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për tu siguruar që çdo individ i cili, me vetëdije, dorëzon ose shpërndan tek një person tjetër substanca të kontrolluara, të përcaktuara si të tilla dhe të ndaluara nga statuti i Michigan-it, brenda territorit shkollor, të ndiqet penalisht me zbatimin e plotë të ligjit.

Në bazë të ligjit të shtetit të Michigan-it MCL 750,473 dhe Rregulloreve qarkore 4240, 5100 dhe 5125: përdorimi i duhanit nga nxënësit ose të rriturit është rreptësisht i ndaluar në ambientet/pronat shkollore ose në autobusët e shkollës, në çdo kohë (24 orë në ditë/7 ditë në javë).

Njoftimi i Inspektimit për Asbest të Objekteve Shkollore

Çdo ndërtesë e Shkollave Komunitare të Utikës është inspektuar për praninë e materialeve që përmbajnë asbest, siç kërkohet nga Ligji për Përgjigjen Urgjente ndaj Rreziqeve të Asbestit (*Asbestos Hazard Emergency Response Act (AHERA)*). Një kopje e Planit të Inspektimit dhe Menaxhimit të Ndërtesave për çdo objekt është në dispozicion në zyrën kryesore të shkollës. Planet mund të inspektohen nga anëtarë të publikut dhe nga punonjësit e UCS gjatë orarit zyrtar të punës.

Njoftimi Paraprak për Aplikimin e Pesticideve

Shkollat Komunitare të Utikës japin një njoftim paraprak për prindërit në rast se një pesticid është duke u aplikuar me qëllim parandalimin ose menaxhimin e barërave të këqija ose dëmtuesve të tjerë si p.sh. milingonat.

Njoftimi do të përfshijë zonën që do të trajtohet, arsyen, datën e aplikimit, dhe informacionin për kontaktim. Njoftimi do të vendoset në hyrjen e shkollës që do të trajtohet dhe në faqen e internetit të shkollës. Prindërit gjithashtu mund të kontaktojnë shkollën e tyre në çdo kohë për të shqyrtuar rekordet historike në lidhje me programin e shkollës për menaxhimin e dëmtuesve.

Shërbimet Ushqimore

Shëndet dhe Mirëqenie

UCS është e angazhuar për të ofruar një mjedis të shëndetshëm shkollor që promovon shëndetin, mirëqenien dhe aftësinë e nxënësve për të mësuar duke promovuar ushqimin e shëndetshëm dhe aktivitetin fizik. Programi ynë i ushqyerjes së fëmijëve përputhet me kërkesat federale, shtetërore dhe lokale, dhe standardet e sigurisë ushqimore. Për më shumë detaje ju lutemi, konsultoni faqen e internetit <https://www.uticak12.org/domain/75>.

Menytë

Informacione rreth menyre, ushqimit dhe alergjenëve postohen në <https://uticak12.nutrislice.com/> dhe janë të disponueshëm në aplikacionin e Shkollave Komunitare të Utikës and "Nutrislice".

Mëngjesi

Një mëngjes i ushqyeshëm dhe i shijshëm ofrohet në të gjitha shkollat e qarkut. Oraret e shërbimit dhe informacione të tjera rreth mëngjesit janë të disponueshme në <https://www.uticak12.org/domain/75>. Ju lutem referojuni shkollës suaj për oraret e mëngjesit.

Dreka

Një drekë e plotë, e ushqyeshme dhe e shijshme është në dispozicion të të gjithë nxënësve në kafeterinë e shkollës. Gjithashtu, nxënësit mund të sjellin drekën e tyre dhe të blejnë qumësht.

Vaktet ushqimore të nxënësve të fillores duhet të porositen atë mëngjes nga mësuesi i nxënësit tuaj. Nxënësit e shkollave të mesme dhe të Junior High porosisin dhe blejnë drekën e tyre kur mbërrijnë në kafeteri.

Të gjitha shkollat e UCS operojnë një kampus të mbyllur gjatë ditës së shkollës. Nxënësit e fillores kombinojnë drekën dhe pushimin. Nxënësit e "High School" dhe të "Junior High" duhet të qëndrojnë në shkollë gjatë kohës së drekës.

Formularët e Aplikimeve për Përfitimet Arsimore dhe Ushqimin

Kemi kënaqësinë tu njoftojmë se Shteti i Michigan-it do të mbulojë koston e të gjitha vakteve ushqimore për vitin shkollor 2024–2025. Në mënyrë që shkollat tona të kualifikohen për fonde të tjera arsimore dhe federale, ne inkurajojmë prindërit të plotësojnë Formularin e Përfitimit Arsimor ose atë për Vaktet Shkollore dhe formularin e EBT për kohën e verës. Këto formularë mbulojnë edhe programe të tjera, të tilla si sportet me pagesë, internet me kosto të ulët, kosto të ulët për provimet EP, tarifat e aplikimit të kolegjit dhe më shumë. Nëse nuk e plotësoni këtë formular, mund të mos kualifikoheni për përfitime të tjera. Për një qasje konfidenciale ndaj përfitimeve, familjet mund të aplikojnë për këtë program on-line në <https://utica.familyportal.cloud> ose të plotësojnë një formular që disponohet në zyrën e shkollës. Formularët tradicional mund të kërkojnë rreth dy javë për tu procesuar.

Të gjitha vaktet përbëhen nga pesë përbërës: drithëra, mish/zëvendësues për mishin, fruta, perime dhe qumësht. Nxënësit duhet të marrin një minimum prej tre artikujsh, dhe njëri prej artikujve të jetë të paktën një gjysmë kupe fruta ose perime, që vakti të kualifikohet sipas dispozitës falas. Artikuj të tillë si biskotat, patatinat, pjatat e dyta, vetëm një qumësht apo pije në shishe nuk kualifikohen të jenë falas ose me çmim të reduktuar. Të gjithë artikujt “a-la-carte”, pijet në shishe, patatinat dhe pjatat e dyta duhet të paguhen nga nxënësi.

Pagesa për Ushqimin

Këtë vit, të gjitha vaktet ushqimore janë falas. Nxënësit duhet të paguajnë për artikujt “a-la-carte”, vaktet shtesë, dhe pijet që nuk përfshihen në programin ushqimor. Për informacion të mëtejshëm vizitoni faqen e internetit <https://www.uticak12.org/domain/75>

Alergjitë Ushqimore

Siguria e nxënësve është një përparësi për Shkollat Komunitare të Utikës. Nëse nxënësi juaj ka ndonjë alergji ushqimore, ju lutemi, kërkojini mjekut tuaj të plotësojë formularin e Nevojave Dietike të Departamentit të Arsimit të Michigan-it (*Michigan Department of Education Dietary Needs*) dhe kthejeni në zyrën e shkollës ose në zyrën e shërbimit ushqimor. Ne dëshirojmë të punojmë me prindërit/kujdestarët dhe nxënësit për të ndihmuar në plotësimin e nevojave të tyre por nuk jemi në gjendje tu ndihmojmë nëse nuk plotësoni këtë formular. Për pyetje rreth alergjive ushqimore dhe përzgjedhjes së

SHENDETI DHE MIREQENIA


menyve ju lutemi telefononi Zyrën e Ushqimit dhe Shërbimeve Ushqimore të UCS (*Food and Nutritional Services Office*) në 586-797-1180.

Çfarë Pritet nga Nxënësit në Mensë

- Të sillen mirë në tryezë dhe të tregojnë respekt për të tjerët.
- Të bashkëpunojnë me stafin e kafeterisë dhe me mbikëqyrësit e mensës.
- Të lënë tavolinën dhe dyshejen të pastër për nxënësit e tjerë.
- Të depozitojnë të gjitha plehrat dhe mbeturinat e riciklueshme në vendin e duhur.
- Të kthejnë të gjitha tabakatë dhe pajisjet në zonën e caktuar.
- Të mos sjellin enë qelqi në shkollë.
- Nxënësit e fillores duhet të qëndrojnë të ulur. Nëse u duhet të lëvizin, ata do të ndjekin udhëzimet mbikëqyrësit të mensës.

Shënim: Të gjitha rregullat e zbatueshme për një sjellje të përshtatshme në shkollë, të renditura në kapituj të tjerë të kësaj broshure janë në fuqi edhe në kafeteri.

Find us on Facebook
and Instagram
[/eatatucs](#)



Udhëzime për Pushimin e Nxënësve të Filllores

Nuk ka dyshim që ajri i freskët dhe ushtrimet fizike promovojnë zhvillimin fizik dhe intelektual të fëmijës. Pushimi është një pjesë e rëndësishme e programit të ciklit elementar në Shkollat Komunitare të Utikës dhe mbikëqyret nga një personel i autorizuar i shkollës. Një shënim nga mjeku është i nevojshëm për të justifikuar një nxënës nga pushimi për më shumë se dy ditë.

Fëmija juaj duhet të vijë në shkollë i veshur në mënyrë të përshtatshme për të luajtur jashtë, edhe në muajt e dimrit. Gjatë ditëve me mot të keq ose të ftohtë të ashpër, pushimi do të bëhet brenda.

Sendet e Humbura dhe të Gjetura

Nxënësit duhet të raportojnë sendet e humbura në zyrë. Çdo send i gjetur duhet të raportohet ose të silllet në zyrë, sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që ti kthehet personit që e ka humbur. Sendet që nuk i kërkon kush, në fund të vitit dhurohen për bamirësi ose hidhen nëse është e nevojshme.

TEKNOLOGJIA

Shkollat Komunitare të Utikës inkurajojnë dhe nxisin përdorimin e teknologjisë në mjediset arsimore. Për të siguruar që nxënësit, stafi dhe prindërit të përfitojnë plotësisht nga teknologjitë që janë në dispozicion, i gjithë përdorimi i teknologjisë në qarkun shkollor duhet të bëhet me autorizimin e duhur dhe t'i përmbahet rregullores së qarkut.

Përdorimi i teknologjisë duhet të mbështesë dhe të jetë në përputhje me qëllimet e deklaruara të qarkut shkollor. Keqpërdorimi i teknologjisë do të rezultojë në masa disiplinore, deri në humbjen e privilegjeve kompjuterike, pezullimin ose përjashtimin.

Udhëzimet për Teknologjinë:

- Nxënësit nuk do të përdorin teknologjinë nëse nuk janë të autorizuar nga personeli përkatës shkollor.
- Në kompjuterët e qarkut, mund të instalohen vetëm softuerë që janë ligjërish në pronësi të qarkut dhe të autorizuar nga një administrator i UCS.
- Aktivitetet e paligjshme/të papërshtatshme të çdo lloji janë rreptësisht të ndaluara.
- Nxënësit nuk do të përdorin teknologjinë e qarkut për blerje on-line apo për ndonjë qëllim tjetër që nuk ka të bëjë me qëllimet arsimore/personale të UCS.
- Asgjë nuk do të vendoset në një faqe interneti të shkollës pa miratimin paraprak të drejtorit të shkollës ose administratorit të qarkut. Faqet e internetit që përfaqësojnë Shkollat Komunitare të Utikës do të vendosen vetëm në serverët e rrjetit të autorizuar nga qarku.
- Krijimi i faqeve të internetit dhe/ose aktiviteteve të mësimit në distancë duhet të ketë një qëllim edukativ/menaxhues që lidhet me një detyrë, projekt, punë ose funksion që përmbush qëllimet e UCS.

Përdoruesit e teknologjisë do të:

- Përdorin teknologjinë sipas rregullave dhe rregulloreve të qarkut.
- Njoftojnë menjëherë stafin përkatës të Shkollave Komunitare të Utikës për faqet e internetit që kanë përmbajtje të dyshimtë.
- Përdorin rrjetet dhe teknologjinë në mbështetje të arsimit, në përputhje me qëllimet e qarkut
- Mbajnë sekret të gjitha fjalëkalimet.
- Respektojnë të gjitha ligjet e autorësisë (*copyright*).

- Raportojnë çdo mosfunksionim të pajisjeve menjëherë tek një anëtar i stafit të UCS.
- Raportojnë çdo keqpërdorim të rrjeteve dhe teknologjisë tek administratori.
- Përdorin pajisjet në mënyrë të përgjegjshme dhe respektojnë punën, dokumentet dhe programet individuale.
- Kthejnë çdo pajisje të huazuar kur kërkohet nga një anëtar i autorizuar i stafit të UCS.

Përdoruesit e Teknologjisë Nuk do të:

- Përdorin komponentët e kompjuterit ose të rrjetit në një mënyrë që i bën ato përkohësisht ose përgjithmonë të paoperueshëm.
- Lidhen me rrjetin e qarkut nëpërmjet një teknologjie së paautorizuar.
- Përdorin ose modifikojnë llogari të tjera, të dhëna, dokumente dhe/ose fjalëkalime pa autorizim.
- Përdorin teknologjinë e qarkut për qëllime personale fitimprurëse ose jofitimprurëse.
- Përdorin teknologjinë e qarkut për të bërë kopje të paligjshme të softuer, materialeve të shtypura ose materialeve të tjera të cilat nuk janë pronë e tyre.
- Përdorin rrjetet dhe/ose teknologjinë e qarkut për të shkarkuar dhe/ose ruajtur lojëra, video, muzikë apo fotografi që nuk janë pjesë e një projekti edukativ të qarkut.
- Përdorin teknologjinë e qarkut për të dërguar, marrë, shtypur ose publikuar mesazhe që janë nxitëse, ofenduese në natyrë, seksiste, raciste ose të papërshtatshme në çfarëdo mënyre. Kur përdoret teknologjia e qarkut, kërkohet gjuhë e rregullt dhe sjellje e përshtatshme.
- Përdorin teknologjinë e UCS për të shpërndarë materiale që: janë në shkelje të Ligjit për Privatësinë dhe të Drejtat Arsimore (Educational Rights and Privacy Act); rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve; janë pornografike, të ndyra ose diskredituese; shkaktojnë ndërprerje të aktiviteteve shkollore; janë kopjime të punës së tjerëve; janë reklamime komerciale; kanë përmbajtje politike ose nuk miratohen nga administratori i shkollës dhe/ose administratori i uebit.

Pajisjet Elektronike Jo-Shkollore të Komunikimit

((ECD)Elektronik Communication Devices)

Përdorimi personal i celularëve Jo-Shkollorë ose pajisjeve të tjera elektronike të komunikimit (ECD) nga nxënësit është i ndaluar, gjatë gjithë kohës që ata janë në shkollë ose në një automjet të qarkut. Nxënësit e Junior High ose ata të High School mund të mbajnë ECD gjatë orarit shkollor, me kusht që të mos jenë të dukshme dhe të mos përdoren për qëllime arsimore pa lejen e një mësuesi apo administratori. Nxënësit e fillores mund të sjellin me vete pajisje të tilla por duhet ti mbajnë ato pajisje në çantë ose në dollap. Përdorimi i pajisjeve

personale duhet të bëhet vetëm në kohën para dhe pas orarit shkollor dhe vetëm kur nxënësit janë jashtë ndërtesës së shkollës.

ECD-të nuk do të përdoren gjatë kohës së mësimit, drekës, pushimit midis lëndëve ose në autobusin e shkollës pa lejen e një zyrtari të shkollës.

Përdorimi i ECD-ve për të fotografuar ose për tu lidhur në internet nuk lejohet pa lejen e një mësuesi ose administratori. Shkollat Komunitare të Utikës nuk mbajnë përgjegjësi për vjedhjen, humbjen apo dëmtimin e asnjë ECD-je. Ndaj nxënësve që shkelin rregulloren për përdorimin e ECD-ve do të merren masa disiplinore të përshtatshme.

Protokolli i Përdorimit të Pajisjeve Elektronike në Testimet Shtetërore

Nxënësve u kërkohet të përdorin vetëm pajisjet elektronike të siguruar nga qarku gjatë seancave të testimit. Nxënësve nuk u lejohet të kenë qasje në pajisjet elektronike personale, jo-testuese kur janë në një seancë testimi aktive ose kur janë në pushim

Shembuj Pajisjesh Elektronike

Shembuj të pajisjeve elektronike përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me:

- Çdo pajisje elektronike që mund të përdoret për të regjistruar, transmetuar, ose për të marrë informacione, që nuk përdoren për testimin, p.sh: tablet, iPad, e-reader (Kindle).
- Orë inteligjente (p.sh: Fitbits; Apple, Garmin, Samsung watches; çdo orë me qasje në aplikacione të tjera ose në internet) telefona inteligjentë dhe celularë.
- Kufje Bluetooth, kufje inteligjente (p.sh: Beats, iPods), ose farëdo lloj kufjesh me qasje në aplikacione të tjera ose në internet.
- Syze inteligjente (p.sh: Google Glass)
- Kompjuter ose laptop, që nuk përdoren për testim

Protokollet për Nxënësit

Të gjitha pajisjet personale të nxënësve duhet të lihen në shtëpi ose do të mbahen në një vend të sigurt të përcaktuar nga administratori i objektit për të gjitha testimet shtetërore. Nxënësve nuk u lejohet të përdorin, të veshin ose të kenë qasje në asnjë pajisje elektronike personale, jo-testuese, gjatë testimit ose në pushim ndërkohë që një seancë aktive testimi është në zhvillim e sipër.

Këto pajisje elektronike përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me "smartphone", celularë, orë inteligjente, kufje "Bluetooth", kufje që lejojnë qasje në

teknologjinë e asistentëve zanorë, dhe kompjuterët dhe/ose tabletët që nuk përdoren aktivisht për testim. Nëse ndonjë pajisje elektronike personale futet në mjedisin e testimit, një anëtar i stafit do ta marrë, fikë, etiketojë pajisjen me emrin e nxënësit dhe do ta vendosë atë në një vend të sigurt.

Nëse një pajisje elektronike është e nevojshme për arsye mjekësore për një nxënës që po testohet, pajisja duhet të mbahet nga administratori i testit, ose testi duhet të administrohet për nxënësin në një mjedis të veçantë ku mund të jenë vetëm administratori i testit dhe nxënësi, i cili duhet të monitorohet aktivisht në çdo kohë gjatë testimit.

Për më shumë,

- Nxënësve nuk u lejohej të përdorin pajisjen testuese për asnjë qëllim tjetër përveç testimit, gjatë kohëzgjatjes së testit.
- Nxënësve nuk u lejohej qasja në asnjë faqe interneti apo aplikacion tjetër gjatë testimit, ose për ndonjë qëllim tjetër pas testimit, ndërkohë që janë në sallën e testimit.
- Stafit duhet të sigurohet që të gjitha pajisjet e testimit të konfigurohen siç duhet dhe që të gjitha aplikacionet e tjera të jenë të çaktivizuara para se të fillojë testimi.
- Fotografimi apo video regjistrimi nuk lejohen gjatë testimit.

Nxënësit që sjellin pajisje elektronike të tjera në sallën e testimit ose që përdorin këto pajisje gjatë testimit do të shkaktojnë anulimin dhe pavlefshmërinë e testit të tyre.

Pasojat e Nxënësve për Shkeljen e Protokolleve

Nëse një nxënës ka qasje në një pajisje elektronike jo-testuese dhe/ose teknologji "të veshur" në çfarëdo momenti gjatë një seance testimi, edhe nëse nxënësi e ka dorëzuar testin e tij, testi i atij nxënësi është kompromentuar dhe do të konsiderohet i pavlefshëm për shkak të shkeljes së protokollit, edhe kur nxënësi nuk e ka përdorur pajisjen elektronike. Nxënësi do të largohet nga mjedisi i testimit dhe prindi ose kujdestari do të informohet për incidentin. Përveç asaj, nxënësit do t'i nënshtrohen disiplinës shkollore deri në pezullim ose përjashtim për shkelje të Rregullores së Përdorimit të Pranueshëm të Teknologjisë në Qark dhe Kodit të Sjelljes së Nxënësve.

Sigurimi i Pajisjes së Nxënësit

Shkollat Komunitare të Utikës janë krenare për pajisjen e nxënësve 1-1 me teknologji. Në varësi të klasës, fëmija juaj është pajisur me një iPad ose një Laptop së bashku me kabujt e rikarikimit dhe pajisjet e tjera shtesë, nëse ka. Fëmija juaj është përgjegjës për pajisjen në çdo moment.

Në raste dëmtimi të pajisjes, sipas rregullores së qarkut, një shumë dëmshpërblimi do të kërkohet për riparimin ose zëvendësimin e pajisjes

Për të ndihmuar familjet në rastet e dëmtimit aksidental të pajisjes qarku ofron një sigurim vjetor për pajisjen e lëshuar nga shkolla. Sigurimi u ofrohet të gjitha familjeve në fillim të vitit shkollor. Për informacion të hollësishëm rreth sigurimit dhe kuotës së pagesës, ju lutemi vizitoni faqen e internetit <http://uticak12.org/device>

Udhëtimi për dhe nga Shkolla

Udhëtimi Këmbësor

Nxënësit këmbësorë, kur udhëtojnë për në shkollë ose kur kthehen në shtëpi nga shkolla, duhet të ndjekin rregullat e zakonshme të sigurisë së këmbësorëve, p.sh.:

- Duke ecur në trotuare kudo që është e mundur
- Duke kaluar rrugët në kryqëzime, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe
- Duke respektuar sinjalet e kalimit (Sinjalet e kalimit janë përgjegjësi e komunës lokale dhe janë të pozicionuara në disa kryqëzime të mëdha.)

Udhëtimi me B biçikletë

Nxënësit që shkojnë dhe kthehen nga shkolla me biçikletë duhet të ndjekin rregullat e zakonshme të sigurisë së këmbësorëve, rregullat e trafikut dhe ligjet lokale. Çdo shkollë vendos dhe komunikon procedurat e udhëtimit me biçikletë dhe vendndodhjen e parkimit të biçikletave në territorin e shkollës gjatë kohës që nxënësi është në mësim. UCS nuk lejon, motoçikletat, "mopeds" dhe "skateboards" në territorin e shkollës.

Udhëtimi me një Automjet Familjar

Shoferët e automjeteve duhet të ndjekin rregullat e qarkullimit të nxënësve të vendosura nga shkolla përkatëse, duke përfshirë edhe ndjekjen e udhëzimeve të personelit të shkollës. Prindërit/kujdestarët që i shoqërojnë fëmijët e tyre në shkollë duhet të sigurohen që korsitë e autobusit dhe të zjarrit janë të lira duke parkuar ose qëndruar vetëm në zonat e caktuara.

Nxënësit që Ngasin Automjetet

Nxënësit e shkollave të mesme që kanë të drejtë të ngasin makinën dhe që parkojnë në territorin e shkollës duhet të regjistrojnë automjetin e tyre dhe të marrin një leje parkimi nga shkolla. Këta nxënës duhet të ndjekin rregullat e qarkullimi dhe duhet të parkojnë në zonat e caktuara brenda territorit shkollor.

Parkimi është një privilegj, jo një e drejtë dhe bazohet në sjelljen dhe frekuentimin e mirë në shkollë. Nxënësit duhet të aplikojnë në zyrën e drejtorit të shkollës për lejen e drejtimit të automjeteve në shkollë. Nxënësit që udhëtojnë për në shkollë me një automjet duhet të

TRANSPORTIMI

regjistrojnë automjetin e tyre në zyrë dhe të marrin një leje parkimi e cila duhet të mbahet në një vend të dukshëm në xhamin frontal të makinës. Nxënësit duhet të parkojnë në vendin e tyre të caktuar të parkimit.

Të gjitha automjetet Brenda territorit të shkollës janë subjekt i kontrollit me ose pa shkak. Nxënësve nuk u lejohej të përdorin automjetet e tyre gjatë orarit të shkollës, për asnjë arsye.

Nxënësve që janë në një "Shared Time Program" (ndjekin një nga lëndët mësimore në një shkollë tjetër të mesme të UCS) u sigurohet transporti me autobus për në shkollën e dytë. Nxënësve nuk u lejohej të udhëtojnë me makinë në shkollën ku ndjekin atë lëndë, në UCSI ose UCMST. Drejtuesit e automjeteve të paautorizuara dhe ata që nuk respektojnë këto rregulla do të nënshtrohen masave disiplinore.



Transporti me Autobusë të UCS

Rregulloret dhe udhëzimet e Bordit të Arsimit të UCS (*UCS Board of Education*) dhe të Bordit të Arsimit të Shtetit të Michigan-it (*Michigan State Board of Education*) konsiderohen në shqyrtimin dhe kualifikimin e një nxënësi për transportim me autobus, duke u bazuar gjithashtu edhe në distancën e shkollës nga shtëpia dhe kushtet e sigurisë për këmbësorët. Zyra e shkollës mund t'ju informojë nëse rruga juaj është e përfshirë në një linjë autobusi të qarkut shkollor. Linjat mund të ndryshojnë gjatë vitit shkollor për t'ju përshtatur regjistrimeve. Transportimi me autobusin e shkollës është një privilegj. Nxënësit mund ta humbasin këtë privilegj nëse shfaqin sjellje të parregullta në autobus ose në një ndalesë autobusi.

Informacion Rreth Autobusit

- Nxënësit zbresin/marrin autobusin në korsitë e caktuara të autobusëve pranë hyrjes së shkollës.
- Nxënësit duhet të jenë në ndalesën e caktuar për afërsisht dhjetë minuta para kohës së planifikuar të mbërritjes së autobusit, të presin në mënyrë të rregullt dhe të jenë vigjilentë ndaj trafikut kur hyjnë ose dalin nga autobusi.
- Për dy javët e para të shkollës, nxënësit e kopshtit dhe të klasës së parë që udhëtojnë me autobus duhet të mbajnë një etiketë që tregon emrin, adresën dhe numrin e autobusit të tyre.
- Sjellja e nxënësve gjatë udhëtimit për në shkollë dhe nga shkolla duhet të jetë një vazhdim i sjelljes së mirë në klasë. Qoftë në ndalesën e autobusit, qoftë në autobusin që udhëton për në shkollë ose në një udhëtim jashtë territorit të shkollës, nga nxënësit pritet një sjellje e rregullt.

Udhëzime rreth Udhëtimit me Autobus

- Ndiqni udhëzimet e shoferit të autobusit, tregoni respekt ndaj shoferit dhe pasagjerëve të tjerë.
- Qëndroni ulur gjatë gjithë kohës dhe mbani të gjitha pjesët e trupit tuaj brenda zonës së ndenjësve.
- Gjatë kohës në autobus nuk ju lejohet të hani, të pini ose të përtypeni.
- Mbani në prehër të gjitha sendet e transportuara, si çantat e shpinës, instrumentet muzikore, etj.
- Hyni dhe dilni nga autobusi në mënyrë të rregullt në ndalesën e autobusit që është caktuar për ju.
- Ndalohet komunikimi me zë të lartë, përdorimi i fjalorit vulgar, komentet dhe gjestet abuzive ose nënçmuese, bullizmi, ngacmimi, gjuha e urrejtjes ose kërcënimet e dhunës.
- Nuk lejohet përdorimi i pajisjeve të komunikimit elektronik (si celularët ose kamerat).
- Megjithëse, nuk ka caktime preferenciale për vendet, shoferi i autobusit ose administratori mund të caktojë vende specifike.
- Vetëm nxënësit që kanë të drejtë transportimi mund të shkojnë në shtëpi me një nxënës tjetër. Nxënësit duhet të kenë një leje të nënshkruar nga të dy palët e prindërve/kujdestarëve dhe nga drejtori. Vendi është i rezervuar për nxënës të caktuar.



Për informacion rreth transportimit me autobus,
kontaktoni Departamentin e Transportit të UCS.
586-797-7100.

Pjesëmarrja dhe Suksesi i Nxënësve

UCS ka krijuar një sërë shërbimesh dhe rregulloresh që mbështesin arsimimin e nxënësve. Frekuentimi dhe pjesëmarrja janë thelbësore për të përfituar nga mundësitë që u ofrohen nxënësve në UCS.

Frekuentimi

Frekuentimi i rregullt, paraqitja në kohë dhe pjesëmarrja aktive në klasë kontribuojnë në suksesin e nxënësve. Familjet inkurajohen të konsiderojnë shkollën si një përparësi duke promovuar një shëndet të mirë, nëpërmjet planifikimit të takimeve mjekësore dhe dentare jashtë orarit të mësimit dhe duke marrë pushime në ditët kur shkolla nuk është operative.

Raportimi i Mungesave

Kur një nxënës do të mungojë, prindërit/kujdestarët duhet të raportojnë mungesën para se të fillojë orari i mësimit. Thirrjet në linjën e raportimit të mungesave mund të bëhen 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Gjatë orëve që shkolla është e mbyllur thirrjet do të procesohen nga një mekanizëm automatik.

Arsyet e mëposhtme do të pranohen si justifikim për mungesat:

- një sëmundje e nxënësit,
- shtrimi në spital,
- pushimi në shtrat i rekomanduar nga mjeku,
- paraqitja e detyrueshme në gjykatë për një takim të planifikuar,
- vdekja e një familjari të afërt,
- pushimet familjare që janë planifikuar dhe miratuar,
- takimet mjekësore dhe lejet administrative.

Të gjitha mungesat e tjera do të konsiderohen të pajustificuara. Dokumentim ose forma të tjera verifikimi mund të kërkohen për justifikimin e mungesave.

Prindërit/Kujdestarët do të informohen për mungesat e pajustificuara nga një nëpunës i shkollës ose nga sistemi telefonik automatik. Nëse mungesa është për një nga arsyet e renditura në listën e justifikimeve të pranueshme, Prindi/Kujdestari ka kohë deri në fund të ditës së nesërme të mësimit për korrigjimin e mungesës. Kini parasysht që, nxënësit e Junior dhe High School që mungojnë në mësim, mund të humbin pikët e pjesëmarrjes ose vlerësohen me "0" në detyrën ditore.

Sëmurja Gjatë Orarit të Mësimit

Një nxënës që sëmuret gjatë orarit të mësimit duhet të raportojë në zyrën kryesore. Nëse nxënësi juaj sëmuret gjatë orarit të mësimit, shkolla do të përdorë informacionin e emergjencës të nxënësit në PowerSchool dhe do të përpiqet t'ju njoftojë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që prindërit/kujdestarët ta mbajnë të përditësuar informacionin e emergjencës në PowerSchool

Dalja e Parakohshme nga Mësimi

Një nxënës duhet të qëndrojë në shkollë deri në fund të orarit ditor të mësimit ose deri kur të marrë leje nga zyra e shkollës për një dalje të parakohshme. Nëse lind nevoja që një nxënës të largohet nga shkolla gjatë orarit të mësimit, ju lutemi ndiqni procedurën e mëposhtme:

- Njoftoni zyrën përpara me telefon ose me një shënim për arsyen dhe kohën e largimit.
- Në kohën e caktuar, prindi/kujdestari ose një person tjetër i cili është i regjistruar në PowerSchool si kontakt emergjent i nxënësit, duhet të paraqitet në zyrë dhe të marrë nxënësin nga shkolla.
- Të gjithë të rriturit duhet të jenë të përgatitur të paraqesin një dokument Identifikimi me fotografi.
- Nxënësi do të dalë nga klasa kur të mbërrijë prindi ose personi i autorizuar nga prindi si kontakt emergjent.

Ju lutemi evitoni planifikimin e takimeve gjatë kohës së testeve të standardizuara, të tilla si testimi M-STEP, përveçse kur është absolutisht e nevojshme. Prindërit do të njoftohen përpara për kohën e testimit.

Mungesat e Paracaktuara

Mungesa nga shkolla për udhëtime familjare gjatë ditëve të planifikuara të shkollës nuk është e këshillueshme. Megjithatë, nëse udhëtimi familjar është i nevojshëm, prindërit/kujdestarët duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim tek drejtori i shkollës për mungesat e paracaktuara të paktën një javë përpara. Kërkesat për udhëtime familjare më të gjata se dhjetë ditë, brenda një semestri, nuk do të aproohen për justifikim.

Për mungesat e paracaktuara që aproohen, nxënësit dhe prindërit/kujdestarët e tyre duhet të konsultohen me mësuesit/et e lëndëve për plotësimin e detyrave të prapambetura. Për nxënësit e Junior dhe High School, detyrat e plotësuara duhet të dorëzohen menjëherë pas kthimit nga pushimet ose udhëtimi familjar

Mungesat dhe Detyrat e Prapambetura

Kur një nxënës mungon në mësim, ai/ajo duhet të plotësojë detyrat e prapambetura. Me përjashtim të rasteve të mungesave të paracaktuara në të cilat plotësimi i detyrave kërkohet menjëherë pas kthimit, nxënësve do tu jepet për plotësimin e detyrave, një afat kohor jo më i shkurtër se koha e mungesës në mësim.

PJESEMARRJA DHE SUKSESI

Kërkesat për detyra shtëpie mund të bëhen për një mungesë që zgjat dy ose më shumë ditë si për mungesat e justifikuara ashtu dhe për ato të pajustificuara. Kërkesat për detyra shtëpie kërkojnë 24 orë për tu procesuar. Gjithashtu në marrëveshje me mësuesin, është e mundur për nxënësin të përfundojë edhe detyrat e klasës.

Nëse nxënësi mungon në shkollë për dhjetë ose më shumë ditë të njëpasnjëshme për shkak të një paaftësie fizike ose sëmundjeje., prindi/kujdestari, nëpërmjet drejtorit të shkollës mund të krijojë mundësinë që nxënësi të studiojë në shtëpi.

Përditësimi i të Dhënave të Kontaktimit

Për të siguruar një komunikim të rregullt midis shkollës dhe familjes për çështjet e mungesave, ju lutemi sigurohuni që të dhënat tuaja të kontaktimit janë të përditësuara në PowerSchool.

Shkolla Fillore

Mbërritja e përditshme në shkollë

Mbikëqyrja e përgjithshme fillon 10 minuta para fillimit të shkollës. Nxënësit nuk do të vijnë në shkollë përpara asaj kohe, përveçse kur janë të regjistruar në Kopshtin e Fëmijëve të Moshës Shkollore. ((SACC) School Age Child Care)

Nëse një nxënës arrin me vonesë në shkollë, prindi duhet ta shoqërojë atë në zyrën e shkollës dhe duhet të firmosë që nxënësi të lejohet të shkojë në klasë.

Dalja e Përditshme nga Shkolla

Kërkohet që nxënësit të merren nga shkolla menjëherë në kohën kur dalin, përveç rasteve kur janë të përfshirë në një aktivitet të autorizuar nga prindërit dhe të mbikëqyrur ose të regjistruar në Kopshtin e Fëmijëve të Moshës Shkollore. ((SACC) School Age Child Care)

Pezullimi

Nëse një nxënës është pezulluar nga shkolla, ai/ajo duhet të plotësojë detyrat dhe provimet e prapambetura dhe do të vlerësohet me notë të plotë, të pa reduktuar.

Problemet me Pjesëmarrjen

Kur mësuesi ose shkolla vënë re mungesa ose vonesa të tepërta të nxënësit, mësuesi ose një zyrtar tjetër i shkollës mund të sinjalizojë prindin/kujdestarin.

Pas mungesës së dhjetë (10), prindi do të marrë një komunikim me shkrim nga drejtori.

Pas mungesës së pesëmbëdhjetë (15), prindi do të marrë një komunikim me shkrim nga drejtori dhe do të paraqitet në një takim me drejtorin.

PJESEMARRJA DHE SUKSESI

Pas mungesës së njëzetë (20), prindi do të marrë një komunikim me shkrim nga drejtori. Personeli i shkollës mund të shkallëzojë çështjen tek MISD (*Macomb Intermediate School District*) për mungesa të theksuara të pa arsyeshme. (*Në bazë të [MCL – Section 380.1561](#))

mungesat e theksuara mund të rezultojnë në një çështje legale me pasoja për nxënësin ose për prindin).

Masa të tjera mund të aplikohen për trajtimin e mungesave të theksuara. Në rast se një nxënës mungon për arsye shëndetësore kronike ose shtrim në spital të verifikuar nga një dokument mjekësor, drejtori do të trajtojë çdo rast veçanësisht.

Shkolla e Mesme e Ulët

(*Junior High School*)

Ndihmoheni fëmijën tuaj të evitohet mungesat e theksuara

Konsiderohen “mungesa të theksuara” mungesat e njëpasnjëshme që zgjasin më shumë se 10 ditë shkollore, brenda një semestri. Ju lutemi kini parasysh që mungesat e theksuara mund të influencojnë negativisht arsimimin dhe mund të rezultojnë në një shkallëzim të çështjes në një procedure legale (*truancy*) me pasoja për prindërit ose nxënësin.

Mungesat e Tepërta

Shkolla do të njoftojë prindin/kujdestarin për mungesat e tepërta në mënyrat e mëposhtme:

- Mungesat regjistrohen çdo ditë nga mësuesi dhe/ose sekretari i frekuentimit në çdo shkollë. Kur një mungesë nuk justifikohet, një telefonatë e automatizuar do të bëhet në numrin e kontaktit kryesor, të listuar në PowerSchool. Një prind/kujdestar është përgjegjës për njoftimin e zyrës së shkollës nëse ky numër telefoni ose ndonjë informacion tjetër kontakti ndryshon. Një prind/ kujdestar do të ketë kohë deri në fund të ditës së nesërme të shkollës për të justifikuar mungesën ose korigjuar një mungesë.
- Nxënësit dhe prindërit janë përgjegjës për të ndjekur dhe shqyrtuar rregullisht, nëpërmjet “PowerSchool”, frekuentimin e nxënësve.
- Kur një nxënës ka grumbulluar nga shtatë deri në 10 mungesa* në çfarëdo lënde brenda një semestri, zëvendës drejtori i shkollës do të takohet me nxënësin. Zëvendës drejtori mund ta shfrytëzojë këtë rast për të paralajmëruar nxënësin për çdo lëndë në të cilin ai ka pesë ose më shumë mungesa. Një letër e nënshkruar nga nxënësi dhe zëvendës drejtori do të dërgohet me email në shtëpi (me postën e SH.B.A nëse nuk ka adresë email në dosje).

PJESEMARRJA DHE SUKSESI

- Kur një nxënës ka grumbulluar 11 mungesa* në çfarëdo lënde, brenda një semestri, një letër do të dërgohet nëpërmjet email-it (ose me postën e SH.B.A. nëse nuk ka një adresë e-mail në dosje) ku deklarohet që, mungesat e nxënësit janë aq të shumta saqë mund të rezultojnë në referimin e nxënësit tek një oficer i neglizhencës shkollore (*Truancy Officer*)
*Mungesat për arsyet e renditura më poshtë nuk do të konsiderohen në shumën totale të mungesave: mungesat e aprovuara nga shkolla (ekskursionet, aktivitetet e qeverisjes studentore, etj.), vdekja/ funerali i një pjesëtari të afërt të familjes (nëna, babai, vëllai ose motra), prezantimi në gjykatë kur verifikohet me një dokument, pezullimet, dhe mungesat për të cilat një prind/kujdestar ka paraqitur dokumentacion mjekësor justifikues brenda pesë ditëve shkollore nga mungesa, nuk do të konsiderohen në shumën e përgjithshme të mungesave. Gjendjet kronike mjekësore mund të pasqyrohen në një shënim nga mjeku që vërteton se nxënësi ka një gjendje mjekësore të vazhdueshme që mund të bëhet shkak i mungesave në shkollë.
- Kur nxënësi bën 14 deri në 16 mungesa, zëvendës drejtori do të telefonojë familjen për të diskutuar mungesat e theksuara.
- Njëzet (20) mungesa të pajustificuara do të shkaktojnë aktivizimin e procedurës për neglizhencë.

Shkolla e Mesme

Rregullat e shkollës së mesme për pjesëmarrjen në shkollë aplikohen duke filluar nga klasa e 9-të edhe kur klasa e 9 të përfshihet në shkollën e mesme të ulët (*Junior High*). Nxënësit e klasave 9, 10, 11, 12, nën mbikëqyrjen e prindërve/kujdestarëve, mund të marrin më shumë përgjegjësi për një pjesëmarrje të rregullt në shkollë. Rritja e përgjegjësisë sjell edhe mundësi të reja për veprimtari edukative jashtë klasës gjatë ditës shkollore. Nxënësit duhet të ruajnë një ekuilibër midis pjesëmarrjes në mësim dhe këtyre mundësive të reja. Ata duhet të ndërgjegjësohen për pjesëmarrjen në mësim dhe rreth faktit që mungesat e theksuara mund të rezultojnë në një rishqyrtim të kreditit të tyre.

Kur nxënësi merr pjesë në aktivitete që shkaktojnë mungesë në mësim, nxënësi është përgjegjës për planifikimin e mungesës. Nxënësit këshillohen të mos planifikojnë pjesëmarrje në aktivitete jashtëshkollore brenda orarit mësimor. Gjithsesi, ata që kanë aprovimin e prindit/kujdestarit për aktivitete jashtëshkollore brenda orarit mësimor duhet të aprovohen edhe nga zyra e shkollës. Për aktivitetet brenda shkollës, nxënësit duhet të kërkojnë leje nga mësuesi i lëndës përpara mungesës dhe planifikojnë plotësimin e detyrave të prapambetura sipas kërkesave të mësuesit. Mungesat për aktivitete brenda shkollës nuk do të konsiderohen në numrin e përgjithshëm të mungesave të nxënësit.

Nxënësit duhet të kontrollojnë “PowerSchool” çdo ditë për mungesat. Nxënësit duhet të angazhohen për korrigjimin e pasaktësive në regjistrimin e mungesave, p.sh., të lajmërojnë prindin/kujdestarin kur një mungesë nuk është justifikuar sipas procedurës së posaçme.

Rishqyrtimi i Kreditit

Çfarë është Rishqyrtimi i Kreditit?

Rishqyrtimi i Kreditit është një proces i posaçëm që përdoret për restaurimin e mungesave kronike. Mungesat konsiderohen kronike kur shuma totale e mungesave të një nxënësi (të arsyeshme, të paarsyeshme dhe të theksuara) është më e madhe se dhjetë (10) për çdo lëndë, brenda një semestri. Në rishqyrtimin e kreditit, çdo tre (3) vonesa konsiderohen si një mungesë pa arsye. Nxënësit që nuk restaurojnë mungesat nëpërmjet rishqyrtimit të kreditit do të vlerësohen me “F” në çdo lëndë në të cilën kanë mungesa të theksuara.

Lajmërimi dhe Procesi i Restaurimit të Kreditit

- Mungesat regjistrohen çdo ditë nga mësuesi dhe/ose sekretari i frekuentimit në çdo shkollë. Kur një mungesë nuk justifikohet, një telefonatë e automatizuar bëhet në numrin e kontaktit kryesor, të listuar në “PowerSchool”. Një prind/kujdestar është përgjegjës për njoftimin e zyrës së shkollës nëse ky numër telefoni ose ndonjë informacion tjetër kontakti ndryshon. Një prind/ kujdestar do të ketë kohë deri në fund të ditës së nesërme të shkollës për të justifikuar mungesën ose korrigjuar një mungesë të gabuar.
- Nxënësit dhe prindërit janë përgjegjës për të ndjekur dhe shqyrtuar frekuentimin e nxënësve, rregullisht, nëpërmjet “PowerSchool”.
- Kur një nxënës ka grumbulluar shtatë (7) deri në (10) dhjetë mungesa, në çfarëdo lënde (në rastin e GLK-UAIS, në çfarëdo blloku) brenda një semestri, zëvendës drejtori i nxënësit do të takohet me nxënësin. Zëvendës drejtori mund ta shfrytëzojë këtë rast për të paralajmëruar nxënësin për çdo lëndë në të cilin ai ka pesë (5) ose më shumë mungesa. Paralajmërimi duhet t’i bashkëngjitet letrës që do të dërgohet në shtëpi. Kur nxënësi grumbullon shtatë deri në dhjetë mungesa nuk do të ketë takim tjetër. Një letër e nënshkruar nga nxënësi dhe zëvendës drejtori do të dërgohet me email në shtëpi (me postën e SH.B.A nëse nuk ka adresë email në dosje).
- Kur një nxënës ka grumbulluar 11 mungesa, në çfarëdo lënde, brenda një semestri, nxënësi do të informohet nëpërmjet një takimi me sekretaren / zëvendës drejtorin që, ai/ajo është vendosur në një kontratë për restaurimin e kreditit. Kontrata përmban dy kushte. Kushti i parë është që nxënësi të kalojë lëndën me një notë jo më të ulët se “D”.

PJESEMARRJA DHE SUKSESI

Kushti i dytë është që nxënësi duhet të përmirësojë pjesëmarrjen në mësim duke evituar mungesat në të gjitha lëndët

- Mungesat për arsyet e renditura më poshtë nuk do të konsiderohen në shumën totale të mungesave: mungesat e aprovuara nga shkolla (ekskursionet, aktivitetet e qeverisjes studentore, etj.), vdekja/ funerali i një pjesëtari të afërt të familjes (nëna, babai, vëllai ose motra), prezantimi në gjykatë kur verifikohet me një dokument, pezullimet, dhe mungesat për të cilat një prind/kujdestar ka paraqitur dokumentacion mjekësor justifikues brenda pesë ditëve shkollore nga mungesa, nuk do të konsiderohen në shumën e përgjithshme të mungesave. Kushtet kronike mjekësore mund të pasqyrohen në një shënim nga mjeku që vërteton se nxënësi ka një gjendje mjekësore të vazhdueshme që mund të bëhet shkak i mungesave në shkollë.
- Nxënësit që nuk e respektojnë kontratën për restaurimin e kreditit do të vlerësohen me notën "F". Nëse arsyetja e vlerësimi me "F" janë rezultatet e dobëta në mësim, krediti për atë lëndë humbet, dhe nxënësi mund ta rikuperojë nëpërmjet procedurës së rikuperimit të kreditit. Nëse nxënësi u vlerësua me "F" për arsye të mungesave të theksuara, ai/ajo mund të kërkojë të testohet, sipas rregullave të qarkut, në mënyrë që të fitojë kredit për atë lëndë. Nëse për lëndën në fjalë, nuk parashikohet opsioni i testimit, atëherë, vlerësimi i provimit final të lëndës duhet të jetë jo më pak se 77% për të fituar kredit për atë lëndë. Një nxënës që nuk testohet me sukses ose që vlerësohet në provimin final të lëndës me një notë më të ulët se 77%, do të vlerësohet përfundimisht me "F" në atë lëndë dhe do të humbasë kreditin.
- Nxënësi (nëse është mbi 18 vjeç) ose prindi/kujdestari mund të apelojnë humbjen e kreditit për arsye mungesash të theksuara duke kërkuar një takim me zëvendës drejtorin e shkollës, brenda dhjetë (10) ditëve nga data që nxënësi është lajmëruar për humbjen e kreditit dhe vendosjen në një kontratë restaurimi të kreditit. Qëllimi i mbledhjes është paraqitja e provave që tregojnë që kuota e mungesave të nxënësit është më e ulët se dhjetë (10) dhe që nxënësi ose prindi nuk janë lajmëruar për mundësinë e humbjes së kreditit. Zëvendës drejtori, do të shqyrtojë evidencat e paraqitura dhe do të ri konfirmojë ose anulojë humbjen e kreditit. Vendimi i zëvendës drejtorit është përfundimtar dhe i pa apelueshëm.

Të Gjitha Shkollat e Mesme

Mungesat e Pajustificuara dhe Pezullimet

1. Kur nxënësi ka një mungesë të pajustificuar në një lëndë, dhe që është verifikuar si e tillë, ai nxënës:
 - Nuk do të kreditohet për pjesëmarrjen në atë lëndë, në atë ditë
 - Nuk do të lejohet të rikuperojë detyrat e prapambetura
2. Kur nxënësi ka një vonesë të pajustificuar në një lëndë, dhe që është verifikuar si e tillë, ai nxënës:
 - Nuk do të kreditohet pjesërisht për pjesëmarrjen në atë lëndë, në atë ditë
 - Nuk do të lejohet të rikuperojë detyrat e prapambetura
3. Kur nxënësi është pezulluar nga një lëndë, dhe pezullimi është verifikuar, ai nxënës:
 - Nuk do të kreditohet për pjesëmarrjen në atë lëndë, në atë ditë
 - Nuk do të lejohet të rikuperojë detyrat e prapambetura për kredit të plotë
 - Do të lejohet të bëjë provimin final të semestrit për kredit të plotë.

Kodi i Sjelljes së Nxënësit

Nxënësit e sjellshëm ndihmojnë në krijimin e një ambienti mësimor shkollor të efektshëm. Siguria dhe mirëqenia e nxënësve varen nga respektimi i rregullave të mëposhtme, të cilat zbatohen gjatë kohës që nxënësit janë në shkollë, në pronën e shkollës, në vajtje-ardhje nga shkolla ose në çfarëdo aktiviteti shkollor.

Nxënësit pritet të jenë të sjellshëm dhe të tregojnë respekt për të gjithë shokët e klasës dhe të gjithë të rriturit. Gjuha dhe sjellja e nxënësve duhet të jenë të respektshme për të gjithë.

Masat disiplinore mund të ndryshojnë në varësi të situatave. Pasojat për shkeljen e rregullave përfshijnë por nuk kufizohen vetëm me masat administrative, pezullimin, përjashtimin apo projektet e posaçme të punës.

Nëse një ligj është shkelur, forcat lokale të rendit do të kontaktohen. Pasi të përfshihen forcat e rendit, masat e tyre mund të përfshijnë kufizimin fizik ose arrestimin, nëse është e nevojshme.

Qytetaria

Të qenit një qytetar i mirë është thelbësore për procesin arsimor. Notat e lëndës së qytetarisë mund të përcaktojnë pjesëmarrjen në asamble, vallëzime, pjesëmarrje në klube, evente atletike dhe aktivitete të tjera. Nxënësit që kanë nota të dobëta në lëndën e qytetarisë mund të përjashtohen nga veprimtaritë e veçanta shkollore.

Liria e Shprehjes

Nxënësit kanë të drejtë të ushtrojnë lirinë e fjalës. Kjo përfshin të drejtën e shpërndarjes ose të afishimit të materialeve të shkruara, peticioneve, distinktivëve, tabelave ose shenjave të tjera që i përshtaten kohës, vendit dhe sjelljes në mënyrë të arsyeshme.

Përjashtimet përfshijnë informacionet që janë:

1. Të turpshme.

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

2. Diskredituese.
3. Të pahijshme ose vulgare.
4. Promovues të produkteve ose shërbimeve që sipas ligjit, nuk lejohen për të miturit.
5. Konsiderohen fjalë fyese ose diskredituese, shprehjet të cilat dëmtojnë ose ofendojnë njerëz të tjerë (pra, kërcënime me dhunë, shpifje rreth karakterit të një personi ose fesë dhe origjinës së tij etnike).
6. Ka gjasa të qarta dhe të dukshme që për shkak të përmbajtjes, mënyrës së shpërndarjes ose të shfaqjes, do të shkaktojë një shqetësim material të konsiderueshëm në veprimtaritë shkollore, një shkelje të rregullave të shkollës ose kryerjen e një akti të paligjshëm.

Shpërndarja dhe/ose shfaqja e materialeve të përshkruara në cilëndo nga kategoritë e mësipërme, është e ndaluar në mjediset e shkollës në çdo kohë, veprimtari shkollore ose të sponsorizuar nga shkolla, brenda ose jashtë shkollës.

Çdo nxënës që dëshiron të shpërndajë ose të publikojë materiale të sponsorizuara, jo shkollore, duhet të paraqesë një kopje të materialit për miratim tek drejtori i shkollës, të paktën njëzet e katër (24) orë përpara kohës së dëshiruar të shpërndarjes/publikimit, së bashku me informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin dhe informacionin e kontaktimit të nxënësit ose të organizatës.
2. Datën(at) dhe kohën(ët) e parashikuara të publikimit dhe/ose shpërndarjes.
3. Vendin ku materiali do të publikohet dhe/ose shpërndahet.
4. Klasën(at) e nxënësve për të cilët parashikohet publikimi dhe/ose shpërndarja.

Botimet studentore sponsorizohen gjithashtu për tu dhënë nxënësve mundësinë për të mësuar, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e të rriturve, të drejtat dhe përgjegjësitë e shtypit në një shoqëri të lirë.

Do të ndalohen rreptësisht publikimet dhe reklamat përkatëse të cilat:

1. Janë paragjyquese për një grup etnik, fetar, racial ose të çfarëdo përcaktimi tjetër.
2. Diskredituese për një grup njerëzish ose një person të caktuar.
3. Pikësynojnë vendosjen e supremacisë së një denominimi, sektit ose pikëpamje fetare të veçantë mbi çdo denominim tjetër fetar, sekt apo pikëpamje.
4. Mbështesin përdorimin ose reklamojnë disponimin e çfarëdo substance ose materiali për të cilat ka arsye të besohet që:
 - Përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm për shëndetin e nxënësve.
 - Përmbajnë paturpësi ose materiale të cilat, në çfarëdo mënyre, konsiderohen të dëmshme nëse paraqiten tek nxënës lehtësisht të influencueshëm.

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

- Nxisin dhunën, mbështesin përdorimin e forcës ose promovojnë shkeljen e ligjit ose të rregullave të shkollës.

Gjithashtu do të ndalohen rreptësisht publikimet:

1. Për të cilat nuk mund të identifikohet nxënësi ose organizata përgjegjëse për shpërndarjen.
2. Që kërkojnë fonde për organizata apo institucione jo-shkollore ndërkohë që kërkesa nuk është miratuar nga Drejtori i Marrëdhënieve me Komunitetin.
3. Që promovojnë, kundërshtojnë ose favorizojnë cilindo kandidat për zgjedhje në Bordin e Arsimit ose adoptimin e shpërndarjes së bondeve, propozimeve ose pyetjeve të paraqitura në çfarëdo fushate zgjedhore.

Mosrespektimi i udhëzimeve të mësipërme do të ndëshkohet nëpërmjet marrjes së masave disiplinore në përputhje me procedurat e vendosura në këtë broshurë. Për më shumë informacion, ju lutemi konsultoni rregulloren 6100.

Veshja dhe Paraqitja e Përshtatshme në Shkollë

Shkollat Komunitare të Utikës krenohen me nxënësit e tyre dhe inkurajojnë veshjen e përshtatshme në shkollë dhe zhvillimin e zakoneve të mira të higjienës dhe rregullit. Një veshje dhe paraqitje e rregullt dhe e pastër e nxënësve kontribuon në një mjedis shkollor pozitiv. Veshja dhe paraqitja e nxënësve nuk duhet të jenë shqetësuese për procesin mësimor. Shqyrtoni udhëzimet e mëposhtme kur zgjidhni veshjet për në shkollë:

1. Nuk lejohen veshje ose këpucë të pahijshme, të grisura ose të pasigurta, që tërheqin një vëmendje të tepruar ndaj atij që i vesh ose me shkrime ose simbole të parespektshme ose përçmuese.
2. Nuk lejohen, veshjet e plazhit, bluzat me jakë tejet të hapur, kanotierat, bluzat pa mëngë ose të ngushta, veshjet e tejudkshme, fundet ose pantallonat e shkurtra, pizhamet, veshjet e ngushta që zbulojnë shpatullat ose belin.
3. Veshja e fundeve të gjata deri në gju është e pranueshme. Veshja e këpucëve është e detyrueshme.
4. Veshjet për ambiente të jashtme, të tilla si palltot dhe kapelet, nuk do të vishen në shkollë.
5. Ndalohen rreptësisht veshjet që promovojnë substancat ose drogërat e paligjshme, veprimtaritë e paligjshme, dhunën, duhanin ose alkoolin.
6. Veshjet ose mbulesat e kokës të përdorura si identifikues të një grupi të cilat promovojnë çrregullimin e atmosferës së ambientit shkollor, janë të ndaluara.
7. Veshja në përputhje me bindjet fetare ose kulturore është e pranueshme.

8. Bizhuteritë dhe aksesorët që mund të konsiderohen të rrezikshëm nuk lejohen.
9. Kostumet (si ato të karnavaleve apo të tjera të ngjashme) dhe pajisjet e tyre nuk lejohen, përveçse kur autorizohen nga administrata e shkollës.

Rregullat e Qarkullimit nëpër Korridoret e Shkollës

Nxënësit duhet të sillen në mënyrë të rregullt dhe të sjellshme në korridoret e shkollës.

Nxënësit që qarkullojnë nëpër korridore gjatë orës së mësimi duhet të jenë të pajisur me një leje qarkullimi të lëshuar nga një anëtar i stafit të shkollës.

Për nxënësit, të cilët nuk u përmbahen rregullave do të merren masa të përshtatshme.

Dollapët e Shkollës

Në fillim të vitit shkollor, çdo nxënësi të "High School" dhe të "Junior High" i lëshohet një dollap dhe i kërkohet të blejë një dry shkollë në librari. Gjithashtu, drynj dhe dollapë u lëshohen edhe nxënësve që ndjekin lëndët e edukimit fizik.

Dollapët janë pronë e shkollës

1. Të gjithë dollapët e caktuar për nxënësit janë pronë e Shkollave Komunitare të Utikës.
2. Shkolla nuk heq dorë në asnjë moment nga kontrolli ekskluziv i dollapëve të saj.
3. Një nxënës që përdor një dollap që është pronë e Shkollave Komunitare të Utikës, supozohet të mos ketë asnjë pritshmëri privatësie në atë dollap apo përmbajtjen e atij dollapi.
4. Drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj do të ketë kujdestarinë e të gjitha kodeve për të gjithë dollapët dhe/ose bravat.
5. Nxënësve u ndalohet kyçja e dollapëve pa miratimin paraprak të drejtorit të shkollës ose të zëvendësit të tij/saj.

Përdorimi i Ligjshëm i Dollapëve të Shkollës

Shkolla vë në dispozicion dollapët për nxënësit e saj, për një përdorim të përkohshëm.

Nxënësit duhet të përdorin dollapët ekskluzivisht për të ruajtur materialet shkollore dhe sendet personale të autorizuar si veshjet e jashtme, këpucët, mjete të kujdesit personal ose ushqimin e drekës.

1. Nxënësit nuk do të përdorin dollapët për ndonjë qëllim tjetër, përveç rasteve kur autorizohen paraprakisht dhe në mënyrë specifike nga drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj.

2. Nxënësit kanë përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e dollapëve të tyre dhe nuk do ti përdorin dollapët e tyre në bashkësi me nxënës të tjerë, dhe as do tu japin kodin e dollapit nxënësve të tjerë, përveç rasteve kur autorizohet nga drejtori ose zëvendësi i tij/saj.
3. Nëse drejtori ose zëvendësi i tij/saj cakton më shumë se një nxënës për një dollap, kodi i dollapit nuk do t'i jepet askujt tjetër përveç partnerit të caktuar.

Kontrolli i Përmbajtjes së Dollapëve

Kontrollet e papritura të dollapëve të shkollave dhe të përmbajtjes së tyre kanë një ndikim pozitiv në dekurajimin e shkeljeve të rregullave dhe rregulloreve të shkollës. Gjithashtu, promovojnë mirëmbajtjen e pronës shkollore dhe rrisin sigurinë për nxënësit dhe personelin.

Në këtë mënyrë, Bordi i Arsimit autorizon drejtorin e shkollës ose zëvendësin e tij/ saj të kontrollojë në çdo kohë dollapët dhe përmbajtjen e dollapëve, pa njoftim dhe pa pëlqimin e prindit apo kujdestarit. Drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj nuk është i detyruar, por mund të kërkojë ndihmën e një oficeri të forcave të rendit për të kontrolluar dollapët.

Forcat e rendit mund të kontrollojnë me ndihmën e një qeni të stërvitur të policisë. Drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj do të mbikëqyrë kontrollin. Gjatë një kontrolli në dollap, drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj do të respektojë të drejtat e privatësisë së nxënësit në lidhje me çdo send të gjetur që nuk është i paligjshëm ose në shkelje të rregullores së shkollës.

Kërkimi dhe sekuestrimi i sendeve të paautorizuara ose të paligjshme

Autoritetet shkollore janë të autorizuara të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të ruajtur sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve duke zbatuar, ndër të tjera, rregulloret e Bordit të Arsimit dhe kodin e sjelljes së nxënësve. Brenda limitit të përgjegjësive, personeli i qarkut mund të kontrollojë nxënësit, pronën e nxënësve dhe pronën e shkollës në mënyrën e lejuar nga ligji.

Gjatë kontrolleve të dollapëve, drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj mund të sekuestrojë çdo artikull të paligjshëm ose të paautorizuar, artikuj në shkelje të rregullores së Bordit të Arsimit ose çdo gjë tjetër të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj si një kërcënim potencial për sigurinë e të tjerëve.

Artikuj të tillë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm me: produktet e duhanit, artikuj që lidhen me tymosjen ose drogën, armët e zjarrit, eksplozivët, armët e rrezikshme, materialet e djegshme, substancat e kontrolluara ilegale ose materialet që janë të ngjashme në paraqitje me substancat e kontrolluara ose intoksikantë të tjerë, artikujt kontrabandë, helmet dhe sendet e vjedhura.

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

Oficerët e Forcave të Rendit duhet të njoftohen pas sekuestrimit të artikujve të rrezikshëm, ose sekuestrimit të artikujve që shkollat janë të detyruara të raportojnë tek agjencitë e zbatimit të ligjit, sipas Rregullores Shtetërore për Informacionet e Sigurisë në Shkollë (*Statewide School Safety Information Policy*).

Çdo artikull i sekuestruar nga drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj duhet të hiqet nga dollapi dhe të mbahet nga zyrtarët e shkollës si provë në procedime disiplinore dhe/ose t'i dorëzohet oficerëve të zbatimit të ligjit.

Prindi/kujdestari i një nxënësi të mitur, ose një nxënës që është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i rritur, do të njoftohen nga drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj për sendet e marra nga dollapi.

Bordi i Arsimit autorizon gjithashtu përdorimin e qenve të stërvitur për zbulimin e drogës dhe pajisjeve. Qentë e stërvitur përdoren për të zbuluar praninë e drogës në zonat e dollapëve dhe në vende të tjera ku mund të fshihen materiale të tilla. Kontrolli me ndihmën e qenve të stërvitur bëhet në bashkëpunim me autoritetet e forcave të rendit dhe qeni nuk përdoret për të kontrolluar nxënës të veçantë pa pasur një dyshim ligjërish të mjaftueshëm ose një mandat ose leje nga prindi/kujdestari.

Disiplina

E drejta e një nxënësi për një arsim publik mbart me vete përgjegjësinë për të njohur dhe respektuar rregullat e shkollës. Objektivi kryesor i disiplinës dhe kontrollit të nxënësve është krijimi i një mjedisi të sigurt shkollor në të cilin mundësohet përqendrimi i plotë në aktivitetet mësimore. Disiplina mund të përkufizohet si kontrolli i sjelljes nga individit ose nga një autoritet i jashtëm. Rregulloret e Bordit të Arsimit (autoritet i jashtëm) dhe në disa raste, ligjet shtetërore, vendosin standardet e sjelljes dhe pasojat për shkeljet. Qëllimi i disiplinës është që nxënësit të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, produktivë dhe të vetë-disiplinuar brenda dhe jashtë shkollës duke marrë përgjegjësi personale (autoritet individual) për sjelljen e tyre.

Shkollat Komunitare të Utikës e trajtojnë disiplinën si një çështje individuale për çdo nxënës. Nxënësit duhet të trajtohen individualisht sipas moshës, pjekurisë së tyre dhe historisë disiplinore, pavarësisht nga përvoja, aftësia, paaftësia interesat dhe vlerat e nxënësit. Nxënësit që kualifikohen për arsimin special dhe shërbimet përkatëse sipas Ligjit për Arsimin e Individëve me Aftësi të Kufizuara ((*IDEA*) *Individuals with Disabilities Education Act*) ose sipas nenit 504 të Ligjit për Rehabilitimin (*Rehabilitation Act*) të vitit 1973, do tu

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

nënshtrohen rregulloreve disiplinuese të qarkut të zbatuara në një mënyrë që përputhet me të drejtat e tyre, sipas ligjit federal dhe shtetëror.

Masat disiplinore mund të ndryshojnë në varësi të çështjeve. Procedurat disiplinuese që përdoren për trajtimin e shkeljes së rregullave përfshijnë: masat restauruese, ndalimin, pezullimin nga shkolla dhe përjashtimin. Shkollat Komunitare të Utikës do të zbatojnë rregulloret dhe procedurat e saj disiplinuese në përputhje me kërkesat e ligjit të Michigan-it.

Bordi i Arsimit ndalon rreptësisht ndëshkimin trupor si një metodë të pranueshme për disiplinimin e nxënësve. Një punonjës shkolle, vullnetar ose kontraktor, mund të përdorë forcë fizike të arsyeshme, sipas nevojës, për mbajtjen e rregullit dhe për të kontrolluar një mjedis shkollor ose të lidhur me shkollën, me qëllim ofrimin e një mjedisi të favorshëm për sigurinë dhe mësimin

Disiplina më e mirë ka natyrë parandaluese. Personeli i shkollës dhe prindërit, duke punuar së bashku mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë vetë-kontrollin dhe vetë-disiplinimin.

Procesi i Rregullt

Procesi i rregullt është një e drejtë themelore e të gjithë individëve. Për këtë arsye, në Qark janë zbatuar procedura të shëndosha nga ana kushtetuese dhe ligjore.

Për raste disiplinore që pasohen nga masa restauruese, mbajtje ose përjashtim nga shkolla për më pak se pesë ditë, prindërit mund të kërkojnë një seancë apeli me drejtorin. Drejtori do të caktojë një takim brenda pesë ditëve nga dita e kërkesës. Pas takimi drejtori do të marrë një vendim brenda dy ditëve nga kjo seancë. Vendimi i drejtorit është përfundimtar.

Bazuar në ligjet shtetërore dhe federale që qeverisin arsimin, drejtorëve të Shkollave Komunitare të Utikës u delegohet autoriteti për të pezulluar ose përjashtuar përkohësisht një nxënës nga shkolla. Në akte të tilla, procedurat e mëposhtme do të jenë në fuqi:

1. Rregulli i përgjithshëm parashikon që përpara pezullimit ose përjashtimit nga shkolla, administratori i shkollës do të informojë nxënësin rreth arsyeve për të cilat po konsiderohet masa disiplinore dhe nëse nxënësi nuk i pranon arsyet ai/ajo duhet të shpjegojë faktet që ka administratori. Gjithashtu nxënësit do t'i jepet mundësia të japë versionin e tij/saj të fakteve dhe të konsiderojë secilin prej shtatë faktorëve personalë që gjenden të renditur në rregulloren shkollore 5100.
2. Nëse prezenca e një nxënësi në shkollë krijon rrezik për personat ose për pronat, ose për ndërprerjen e procedurave mësimore, administratori i shkollës mund të pezullojë nxënësin menjëherë, dhe sa më shpejt që të jetë e arsyeshme, të mundësojë për nxënësin procesin e rregullt që është shpjeguar më lart.

3. Nëse pas procesit të rregullt, administratori vërteton që nxënësi është përfshirë në veprime të ndaluara nga rregullorja e shkollës, administratori mund të vendosë masën disiplinore të pezullimit nga shkolla për një periudhë jo më të gjatë se dhjetë (10) ditë shkollore. Drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj do të njoftojë në fillim prindërit/kujdestarët me telefon ose personalisht rreth masës disiplinore të pezullimit, arsyeve dhe kushteve të pezullimit. Njoftimi verbal për prindërit/kujdestarët do të ndiqet nga një komunikim me shkrim.

Procedurat e apelimit në dispozicion të prindërve ose kujdestarëve:

1. Si hap i parë, prindërit mund të kërkojnë një seancë apeli me drejtorin brenda periudhës së përjashtimit nga shkolla. Drejtori afirmon, modifikon ose anulon masën disiplinore brenda dy ditëve shkollore nga data e takimit.
2. Nëse përjashtimi është për më shumë se pesë (5) ditë ose ka një rekomandim për një kohë më të gjatë se dhjetë ditë, prindërit/kujdestarët mund të apelojnë vendimin e drejtorit të shkollës tek Drejtori i qarkut ose zëvendësi i tij/saj brenda pesë (5) ditëve shkollore nga koha e vendimit për përjashtim. Brenda pesë(5) ditëve shkollore nga kërkesa e apelimit, Drejtori i përgjithshëm ose zëvendësi i tij/saj do të mbajë një seancë apeli.
3. Drejtori i Qarkut do të afirmojë, modifikojë ose anulojë vendimin e drejtorit të shkollës brenda (3) tre ditëve shkollore nga seanca e apelimit. Rekomandimet për më shumë se (10) dhjetë ditë mund të rezultojnë në pezullim nga Drejtori i qarkut (11-59 ditë) ose përjashtim nga Drejtori i qarkut (60-180 ditë). Vendimi i Drejtorit të qarkut është përfundimtar.
4. Nëse rekomandimi është për përjashtim të përhershëm, prindërit/kujdestarët mund të apelojnë vendimin e drejtorit të shkollës tek Drejtori i qarkut ose zëvendësi i tij/saj brenda pesë (5) ditëve shkollore nga vendimi i drejtorit të shkollës për përjashtimin e nxënësit. Brenda pesë (5) ditëve shkollore nga kërkesa e apelimit, Drejtori i qarkut ose zëvendësi i tij/saj do të mbajë një seancë apeli. Drejtori i qarkut do të konfirmojë, modifikojë ose anulojë rekomandimin e drejtorit të shkollës brenda tre ditëve shkollore nga seanca e apelimit. Nëse Drejtori i qarkut konfirmon rekomandimin për përjashtim të përhershëm, prindi/ kujdestari mund të apelojë vendimin e Drejtorit të qarkut tek Bordi i Arsimit. Vendimi i Bordit të Arsimit është përfundimtar.

Rregullorja e Sjelljes së Nxënësit balancon detyrimin e Qarkut Shkollor për ruajtjen e sigurisë dhe mjedisit të favorshëm arsimor me detyrimin që qarku ka

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

për tu mësuar sjelljen e duhur nxënësve të cilët përfshihen në sjellje të pahijshme ose të papërshtatshme. Rregullorja e Sjelljes së Nxënësve përcakton rregullat e trajtimit të sjelljeve të parregullta më serioze dhe që shfaqen më shpesh. Veprimet e ndaluara të renditura në rregulloren e sjelljes nuk do të konsiderohen si një listë gjithëpërfshirëse ose si një kufizim i autoritetit të zyrtarëve të shkollës në trajtimin e duhur të shkeljeve të rregulloreve specifike të një ndërtese shkollore, ose shkeljeve të tjera që influencojnë negativisht funksionimin e sistemit shkollor, funksionimin e duhur të procesit arsimor, apo shëndetin dhe sigurinë e nxënësit. Një nxënës që shfaq cilëndo nga sjelljet e ndaluara të renditura në këtë rregullore do të disiplinohet me masat e parashikuara në Rregulloren e Sjelljes së Nxënësve

Masat disiplinore për sjelljet e ndaluara të renditura në vijim do të aplikohen kur një nxënës:

1. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar brenda pronës së shkollës
2. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar në një automjet, duke përfshirë ato të përdorur për qëllime shkollore
3. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar gjatë një aktiviteti, funksioni ose veprimtarie shkollore
4. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar gjatë udhëtimit nga dhe për në shkollë
5. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar që përfshin një nxënës tjetër i cili/e cila po udhëton nga dhe për në shkollë
6. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar jashtë territorit shkollor, që është e ndaluar me ligj ose që sipas gjyqimit të administratorit të shkollës, është e një rëndësie të tillë që e bën prezencën në shkollë të atij nxënësi, një rrezik për shëndetin dhe sigurinë e nxënësve të tjerë dhe punonjësve dhe/ose shqetëson në mënyrë të konsiderueshme funksionimin e procesit arsimor.
7. Merr pjesë në një veprimtari të ndaluar ndërkohë që nxënësi nuk është i regjistruar në qarkun shkollor ose është i regjistruar në një qark tjetër shkollor, të tillë që do të shkaktonte pezullim ose përjashtim nëse kishte ndodhur kur nxënësi po ndiqte shkollën në qarkun tonë shkollor.

Sjelljet e Papranueshme / Veprimet e Ndaluar

Mbështetja e Veprimeve të Papranueshme / Ndaluar

Nxënësi nuk do të mbështesë përdorimin ilegal të drogës, violencën ose sjelljeve të tjera shqetësuese.

Alkoli, Duhani, Droga dhe Substancat Kimike

Nxënësi nuk do të shesë, blejë, mbajë, shpërndajë, marrë ose japë, pranojë, përdorë, ose të jetë nën influencën (limiti i legalizuar i nivelit të influencës nuk kërkohet. Konsultoni Rregulloren 5125), e duhanit, pijeve alkolike, substancave narkotike, drogërave të paligjshme, substancave që përmirësojnë performancën (Siç përkufizohet në Rregulloren 5165), mjekimeve të pa rekomanduara nga mjeku, substanca që janë ose duken si drogë, ose substanca që modifikojnë sjelljen brenda territorit dhe pronave të shkollës, në automjetet e shkollës ose në veprimtaritë shkollore.

Nxënësi nuk do të shesë, shpërndajë ose transferojë ose, tentojë të shesë, shpërndajë, ose transferojë asnjë lloj droge (me ose pa rekomandim mjekësor), ilaçi, vitaminë, ose substance kimike (p. sh. qetësuesit e dhimbjeve, stimuluesit, pilulat për dietën, pilulat “PEP”, pilulat “NoDoz”, mjekimet për koll, laksativët, mjekimet për stomakun ose tretjen e ushqimeve, etj.). Nxënësi nuk do të përdorë ose mbajë këto substanca për qëllime të papërshtatshme.

Zjarrvënia e Qëllimshme

Nxënësi nuk do të djegë ose tentojë të djegë asnjë pronë shkollore; ndezë zjarr me vetëdije në pronën e shkollës; shkaktojë ose tentojë të shkaktojë një shpërthim në pronën shkollore. Nxënësi nuk do të bëjë veprime zjarrvënëse të ndaluara nga ligji i Michigan-it, paragrafi MCL 750.71 deri në MCL 750.80. Shkeljet që kanë të bëjnë me zjarrvënien do të trajtohen nga rregullorja 5105 e qarkut.

Bullizmi

Nxënësi nuk do të angazhohet në sjellje, qoftë me shkrim, qoftë verbale apo fizike, që në mënyrë të paarsyeshme shqetësojnë pjesëmarrjen në shkollë të një tjetri ose Dëshirën e një tjetri për të marrë pjesë në aktivitetet shkollore, siç përcaktohet në Rregulloren 5145.

Shitblerja

Nxënësi nuk do të shesë ose blejë asnjë artikull nga një nxënës tjetër në shkollë, përveç artikujve në dyqanin e nxënësve që janë autorizuar nga drejtori i shkollës.

Detyrimi me forcë, zhatja dhe shantazhi

Nxënësi nuk do të kryejë ose të përpiqet të kryejë detyrim me forcë, zhatje ose shantazh. Një nxënës nuk do të angazhohet në veprimtari ose përpjekje për sigurimin e parave ose sendeve të tjera me vlerë nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit dhe/ose dhunës, dhe nuk do të ushtrojë forcë kundrejt një personi tjetër, për ta detyruar të kryejë një veprim të padëshiruar nëpërmjet kërcënimeve dhe/ose dhunës.

Aktet Kriminale

Nxënësi nuk do të kryejë ose angazhohet në asnjë sjellje që përkufizohet si krim nga ligji federal ose shtetëror ose nga një urdhëresë lokale.

Sjelljet Kriminale Seksuale

Nxënësi nuk do të shfaqë sjellje kriminale seksuale. Konsiderohen si "Sjellje Kriminale Seksuale" sjelljet të cilat përbëjnë një shkelje të paragrafit 750.520b deri në 750.520e, dhe të paragrafit 750.520g të Përmbledhjes së Ligjeve të Michigan-it. Shkeljet që përbëjnë sjellje kriminale seksuale do të trajtohen nga rregullorja 5105.

Dëmtimi, Vjedhja ose Përvetësimi i Pronës

Nxënësi nuk do të dëmtojë, vjedhë, përvetësojë ose tentojë të dëmtojë, vjedhë, përvetësojë me vetëdije pronën e shkollës ose të një personi tjetër.

Persekutimet Diskriminuese

Nxënësi nuk do të shfaqë sjellje të tilla si ngacmimet seksuale ose veprimet seksuale të padëshirueshme, ose kërkesat për favore seksuale. Gjithashtu, nxënësi nuk do të përfshihet në sjellje të tjera fizike ose verbale që diskriminojnë gjininë, racën, fenë, gjatësinë, peshën, statusin martesor, ose pa-aftësinë, ose kufizimet fizike (p.sh. komentet raciale ose seksuale, kërcënimet ose sharjet).

Çrregullimi i veprimtarive ose hapësirave shkollore

Nxënësi, në asnjë lloj mënyre (violencë, forcë, zhurmë, detyrim, kërcënim, rezistencë pasive...etj.), nuk do të shkaktojë çrregullim ose pengim të veprimtarive shkollore. Nxënësi nuk do të përfshihet në asnjë sjellje të tillë nëse sjellja, arsyeshmërisht, ka gjasa të krijojë çrregullim ose pengim. Gjithashtu, nxënësi nuk do të përfshijë ose nxisë nxënës të tjerë në sjellje të tilla, me qëllim krijimin e çrregullimeve ose pengimin e veprimtarive shkollore. Sjelljet e renditura më poshtë nuk përbëjnë një listë gjithëpërfshirëse të sjelljeve që shkaktojnë shkelje të kësaj rregulloreje por janë një ilustrim i tipologjisë së atyre sjelljeve. Duhet të jetë e qartë që, çdo sjellje që shkakton ose ka gjasa të shkaktojë çrregullim ose pengim të procesit mësimor, është e ndaluar.

Sjelljet e ndaluara përfshijnë por nuk kufizohen me:

1. Okupimin ose zënien e çfarëdo objekti ose territori shkollor, tërësisht ose pjesërisht, pa lejen e një nëpunësi të shkollës, dhe që bëhet pengesë për përdorimin nga të tjerët.
2. Bllokimin e trafikut të këmbësorëve ose automjeteve, hyrjes ose daljes së çfarëdo korridori, dhome, ose objekti shkollor, pa lejen e drejtorit të shkollës.

3. Parandalimin, përpjekjet për të parandaluar ose ndërhyrë në zhvillimin dhe funksionimin normal të çfarëdo ore mësimi, aktiviteti, mbledhje, ose kuvendi.
4. Nxitjen, shkaktimin ose pjesëmarrjen në një trazirë që pengon veprimtaritë arsimore të tjerëve ose që kërcënon shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e të tjerëve në përgjithësi në territorin ose pronën e shkollës ose në një aktivitet të sponsorizuar nga shkolla.

Veshja

Nxënësi nuk do të vishet ose krihet në një mënyrë që, sipas gjykimit të administratorit të shkollës, është e pasigurtë për vetë nxënësin ose për të tjerët, ose që shqetëson procesin mësimor.

Pajisjet Elektronike të Komunikimit

Përdorimi ose mbajtja nga nxënësit e pajisjeve elektronike të komunikimit, pa lejen e drejtorit të objektit, është e ndaluar në ambiente të tilla si banjat, dhomat e veshjes, zyrat, dhe ambiente të tjera në të cilat nxënësit dhe punonjësit e shkollës kanë prishmëri të arsyeshme të privatësisë.

Mos-ndjekja e Udhëzimeve të Personelit të Shkollës

Nxënësi nuk do të refuzojë të ndjekë udhëzimet dhe direktivat e nëpunësve të shkollës/qarkut (duke përfshirë mësuesit zëvendësues dhe stazhistë), vullnetarëve, shoqëruesve ose të atyre që janë në një pozitë mbikëqyrëse.

Mungesa e Bashkëpunimit

Nxënësi nuk do të refuzojë bashkëpunimin me administratorin dhe/ose personelin e shkollës, gjatë hetimit të një shkelje të mundshme të kësaj rregulloreje, rregulloreve të tjera, dhe/ose rregullave të shkollës. Nxënësi nuk do të bëjë dëshmi të rreme ose të paraqesë prova të rreme tek administrata dhe/ose personeli i qarkut shkollor. Nxënësi nuk do të refuzojë të dëshmojë ose refuzojë të bashkëpunojë në çfarëdo mënyre tjetër me personelin e qarkut shkollor, në çfarëdo procedure disiplinore.

Alarme të Rreme

Nxënësi nuk do të shkaktojë, me vetëdije, një alarm të rremë zjarri ose të bëjë një raportim të rremë të një zjarri, bombe ose katastrofe.

Akuza të Rreme

Nxënësi nuk do të shpifë, ose të bëjë akuza të rreme, verbale ose me shkrim, kundër një nxënësi tjetër, personelit të shkollës/qarkut (duke përfshirë mësuesit zëvendësues dhe stazhistët), pjesëtarëve të Bordit të Edukimit ose vullnetarëve.

Falsifikimi i të Dhënave

Nxënësi nuk do të përdorë të dhënat e një personi tjetër ose falsifikojë oraret, datat, notat, adresat, ose të dhëna të tjera në formularët ose dëftesat e qarkut/shkollor

Përleshjet / Pjesëmarrja në Përleshje

Me fjalën përleshje kuptohet një ndeshje dashakeqe e natyrës fizike (jo sportive) ose verbale e dhunshme. Pasojat për pjesëmarrësit në një përleshje mund të arrijnë deri në procedim për sulm fizik.

Kumari

Nxënësi nuk do të marrë pjesë në lojëra fati ose aftësie për qëllime monetare, përfitimi, dhe/ose zhvatjeje.

Veprimtaritë e Grupeve ose Bandave

Nxënësi nuk do të marrë pjesë në veprimtari të grupeve ose bandave të cilat mbështesin drogërat e paligjshme, dhunën, ose sjelljet çrregulluese. Veprimtaritë e bandave janë të trajtuara në imtësisht në rregulloren 5135.

Dhuna Verbale (*Hate Speech*)

Nxënësi nuk do të përdorë dhunë ose kërcënim, verbal ose me shkrim, që shpreh paragjykim në bazë të përkatësisë etnike, besimit fetar, orientimit seksual, dhe aspekteve të tjera të ngjashme.

Hazing (*Rituali i antarësimit të një fillestari*)

Nxënësi nuk do të marrë pjesë në "hazing" (në raste të tilla si kalimi i një nxënësi nga një shkollë, veprimtari ose nivel shkollor, në një tjetër), në asnjë mënyrë që mund të shkaktojë dhimbje emocionale apo fizike, përlulje apo siklet. Një shpjegim i detajshëm i "Hazing" gjendet në rregulloren 5140.

Materialet e papërshtatshme

Nxënësi nuk do të mbajë, krijojë dhe/ose shpërndajë materiale pornografike dhe/ose materiale të tjera të papërshtatshme.

Sjelljet e Paturpshme

Nxënësi nuk do të përfshihet në sjellje që shkelin standardet e përgjithshme shoqërore. Sjellje të tilla përfshijnë paturpësinë, ekspozimin e pahijshëm ose vulgar (Përmbledhja e Ligjeve të Michigan-it 750.335a), përdorimin e gjuhës vulgare të folur dhe të shkruar, në fotografi, karikatura ose gjeste të cilat janë ofenduese dhe shkelin standardet e përgjithshme shoqërore të përshtatshmërisë.

Gjuha ose Shprehja Verbale

Nxënësi nuk do të përdorë shprehje verbale profane dhe/ose të turpshme.

Treguesit me Lazer

Të gjithë nxënësve, u ndalohet përdorimi ose mbajtja e treguesve me lazer në hapësirat dhe veprimtaritë shkollore, pa lejen direkte të drejtorit të shkollës.

Mjetet Motorike

Përveç rasteve kur ka një leje parkimi nga shkolla, nxënësit nuk i lejohet të përdorë ose parkojë mjete motorike (duke përfshirë motorçikletat dhe moped-ët) në premiset e shkollës.

Rekordi i Sjelljeve të parregullta Përpara Regjistrimit

Një nxënës që përveç regjistrimit në shkollën e zonës ku banon, gëzon të drejtën të regjistrohet edhe në shkolla të tjera, mund të përjashtohet ose pezullohet për një shkelje që ka ndodhur ndërkohë që ai nxënës ishte:

1. Banues në një qark tjetër
2. I regjistruar në një shkollë tjetër
3. Jashtë orarit shkollor
4. Jashtë premisave të shkollës kur sjellja e parregullt ishte e tillë që, po të ndodhte ndërkohë që nxënësi ishte i regjistruar në qarkun shkollor, do të shkaktonte përjashtim ose pezullim.

Pajisjet e Përdorura për Vetëmbrojtje

Nxënësi nuk do të mbajë, përdorë ose kalojë tek të tjerët një pajisje vetëmbrojtjeje (p.sh. gaz djegës, topuz, armë trulllosëse, pajisje që shkaktojnë goditje elektrike) që mund të shkaktojë dëmtim fizik ose shqetësim tek një person tjetër.

Sulmi Fizik

Nxënësi nuk do të kryejë sulm fizik që përkufizohet si një veprim me dashje për të shkakuar dëmtim fizik tek një person tjetër nëpërmjet forcës ose dhunës.

Sulmi fizik kundrejt një punonjësi, vullnetari ose të punësuarit të qarkut

shkollor, siç përcaktohet në paragrafin 1311a të Kodit të Rishikuar Shkollor, do të trajtohet nga rregullorja 5105.

Kontakti Fizik dhe Shfaqjet Afektive në Publik

Nxënësi nuk do të përfshihet në kontakte fizike të tilla si përqaqimet, puthjet, mbajtja për dore etj..

Siguria

Nxënësi nuk do të përfshihet në asnjë sjellje ose veprim që vë në rrezik të tjerët, duke përfshirë këtu edhe sjelljet e pavetëdijshme që dëmtojnë nxënësit ose personelin.

Mashtrimi Akademik (*Plagiarism*)

Nxënësi nuk do të përfshihet në mashtrim akademik. Mashtrimi përfshin por nuk kufizohet me shkëmbimin e ndihmës së pa autorizuar dhe me përfitimin ose ofrimin e përparësive të padrejta të çfarëdo forme në punën akademike. Nxënësi nuk do të kopjojë, duke përfshirë gjuhën, strukturat, idetë dhe/ose mendimet e një tjetri dhe nuk do të prezantojë materialin e kopjuar si punë të veten origjinale.

Ngacmimet Seksuale

Nxënësi nuk do të shfaqë sjellje të tilla si ngacmimet seksuale, veprimet seksuale të padëshirueshme, kërkesat për favore seksuale, dhe veprime të tjera verbale, të shkruara ose fizike të një natyre seksuale. Ngacmimet seksuale gjenden të përkufizuara në rregulloren 5130.

Pezullimi i Nxënësve nga Premisat dhe Veprimtaritë Shkollore

Nxënësi, ndërkohë që është i pezulluar, nuk do të hyjë në pronën e qarkut shkollor pa autorizimin e administratorit të shkollës. Nxënësi, ndërkohë që është i pezulluar, nuk do të ndjekë ose marrë pjesë në asnjë veprimtari, funksion ose aktivitet shkollor që mbahet brenda ose jashtë premisave të shkollës, pa autorizimin e administratorit të shkollës.

Kërcënimet

Nxënësi nuk do të bëjë kërcënime të asnjë lloji (për dëmtim, vrasje, qëllim me armë, bombardim, etj.), në asnjë formë (verbale, jo verbale, të shkruar, të vizatuar, etj.) kundrejt nxënësve, pronave dhe/ose personelit të Shkollave Komunitare të Utikës.

Shkelja e Pronës / Qendrimi Brenda Pronës pa një Arsyë

Nxënësi nuk do të qëndrojë në territorin ose objektet shkollore përveçse për pjesëmarrje në procesin arsimor të qarkut shkollor. Gjithashtu, nxënësi nuk do të shëtisë në ambientet e shkollës (p.sh. korridoret, klasat, tualetet, etj) pa një arsye.

Sulmi Verbal

Nxënësi nuk do të kryejë sulm verbal të përkufizuar si çfarëdo kërcënimi verbal të qëllimshëm që shkakton një frikë të arsyeshme për rrezik dëmtimi, dhe që ka gjasa të shkaktojë dëmtim.

Shkelja e Rregullores për Përdorimin e Pranueshëm të Pajisjeve

Nxënësi nuk do të shkelë ose tentojë të shkelë rregulloret e qarkut shkollor, rregullat administrative, dhe direktivat që kanë të bëjnë me qarkun shkollor

ose pajisjet kompjuterike personale dhe sistemet telefonike. Shkelja e çfarëdo rregulli ose përgjegjësie mund të shkaktojë humbjen e privilegjeve të përdorimit të pajisjeve teknologjike dhe masa të tjera disiplinore ose legale që përfshijnë tërheqjen e pajisjes.

Shkelja e Rregullave Direktivave Specifike të Objekteve

Nxënësi nuk do të kryejë ose marrë pjesë në asnjë veprim që është i ndaluar nga rregulloret dhe direktivat specifike të një shkolle.

Armët

1. Armët e Rrezikshme – Nxënësi nuk do të mbajë, përdorë ose pasojë tek të tjerët një armë të rrezikshme siç përkufizohet nga paragrafi 1313(4) i Kodit të Rishikuar Shkollor dhe nga “*U.S Code, Title 18, 921*” dhe që kontrollohet nëpërmjet Rregullores 5105.
2. Armët dhe Instrumentat e Rrezikshëm – Nxënësi nuk do të mbajë, përdorë ose pasojë tek të tjerët një thikë tehu i të cilës është i gjatë 3” ose më pak, një shkop gome, vegla të përdorura në artet marciale, pistoleta uji ose boje, çakmakë, shkrepe, fishekzjarrë, bomba tymi ose me ere të keqe, tregues me lazer, eksplozivë ose objekte të tjera që mund të konsiderohen si armë ose që mund të shkaktojnë dëmtime trupore.
3. Armët e Rreme – Nxënësi nuk do të mbajë, përdorë, ose pasojë tek të tjerët asnjë objekt që duket si armë (p.sh., thikat e gomës, lojërat në formë arme, pistoletat e përdorura për sinjalizimin e fillimit të garave sportive, etj.).

Masat Disiplinore

Masat disiplinore mund të ndryshojnë sipas situatës. Administratorët e shkollës do të hetojnë çështjen me hollësi përpara marrjes së vendimit të një mase disiplinore, duke ofruar një proces të rregullt për të gjithë personat e përfshirë në çështje, dhe duke lajmëruar prindërit/kujdestarët. Përveçse kur specifikohet ndryshe, pasojat për të gjitha veprimet e ndaluara shtrihen nga ndërhyrjet administrative deri tek përjashtimi i përhershëm, në varësi të një numri faktorësh të konsideruar si: niveli i shkeljes, ndikimi që shkelja ka në shkollë dhe në bashkësinë shkollore, rregulloret e Bordit të Arsimit dhe ligjet shtetërore ose federale.

Konsiderimet Para Zbatimit të Masës Disiplinore

Në përputhje me ligjin shtetëror dhe me rregulloren e bordit arsimor, dhe përveç siç specifikohet më poshtë, përpara se nxënësi të pezullohet, përjashtohet përkohësisht ose përfundimisht, administratorët e qarkut të ngarkuar me vendimin e masës disiplinore do të konsiderojnë secilin nga faktorët e mëposhtëm:

1. Moshën e nxënësit
2. Historinë disiplinore të nxënësit
3. Nëse nxënësi ka aftësi të kufizuara

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

4. Rëndësinë e sjelljes ose shkeljes së kryer nga nxënësi
5. Nëse sjellja ose shkelja e kryer nga nxënësi kërcënoi sigurinë e cilitdo nxënës ose të personelit të shkollës
6. Nëse masat restauruese do të përdoren për trajtimin e sjelljes ose shkeljes së kryer nga nxënësi
7. Nëse një masë më e lehtë është e përshtatshme për trajtimin e sjelljes ose shkeljes së kryer nga nxënësi.

Fakti që këto faktorë janë konsideruar duhet të dokumentohet në dosjen e vendimit të çështjes disiplinore. Përveç siç shpjegohet më poshtë, qarku ka autoritetin të pezullojë ose përjashtojë nxënësin përkohësisht ose përfundimisht nga shkolla. Në ushtrimin e këtij autoriteti, ekziston një bindje e diskutueshme që një pezullim (më shumë së 10 ditë), përjashtim i përkohshëm ose përfundimtar nuk është i justifikueshëm derisa administrata të demonstrojë që ka konsideruar secilin nga faktorët e rradhitur më lart. Obligimi për të konsideruar faktorët e renditur më lart nuk do të aplikohet për një nxënës që përjashtohet përfundimisht nga shkolla për shkeljen e ligjit shtetëror që trajton armëmbajtjen në territorin shkollor.

Qarku do të konsiderojë praktikën restauruese si një alternativë ose së bashku me pezullimin/përjashtimin e një nxënësi.

Praktikat Restauruese

Personeli i shkollës do të konsiderojë masat restauruese si zëvendësues ose në kombinim me përjashtimin nga shkolla (pezullimin/përjashtimin). Masat restauruese mund të përfshijnë takime midis të dëmtuarit dhe kundërvajtësit, të kërkuara nga i dëmtuari; që miratohen nga prindi ose kujdestari ligjor i të dëmtuarit ose, nga i dëmtuari nëse është të paktën 15 vjeç; me pjesëmarrjen vullnetare të të dëmtuarit, një mbrojtësi të të dëmtuarit, anëtarit kundërvajtës të komunitetit të shkollës dhe përkrahës të të dëmtuarit dhe të kundërvajtësit; dhe që i japin mundësi kundërvajtësit të pranojë përgjegjësinë për dëmin që u është shkaktuar të prekurve nga sjellja e parregullt dhe të marrë pjesë në përcaktimin e pasojave për riparimin e dëmit.

Të pranishmit, të ashtuquajtur ekipi i masave restauruese, mund t'i kërkojnë nxënësit të përgjigjet për një ose më shumë nga pikat që vijojnë: të kërkojë falje; të marrë pjesë në shërbim komunitar restaurues ose këshillim; ose të paguajë dëmshpërblim. Pasojat e përcaktuara do të përfshihen në një akt marrëveshjeje që përcakton afatet kohore për përfundimin e pasojave dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit.

Masat restauruese duhet të kenë përparësi në konsiderimin (si zëvendësues ose në kombinim me) e korrigjimit të shkeljeve të tilla si konfliktet ndërpersonale, bullizmi, konfliktet verbale dhe fizike, vjedhja, dëmtimi i

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

pronës, shqetësimi i mësimit, ngacmimet dhe bullizmi kibernetik. Për të zgjidhur çështjen mund të përdoren edhe masa të tjera restauruese të bazuara në kërkime, të cilat nuk janë përshkruar më sipër.

Masat Administrative

Masat disiplinore që nuk rezultojnë në një pezullim nga shkolla dhe që përfshijnë, por nuk kufizohen me praktikën restauruese, mund të jenë të tilla si përjashtimi i një nxënësi nga ora e mësimit, pezullimi nga veprimtaritë mësimore në përgjithësi, qortimi, korigjimi, qëndrimi në shkollë me përcaktim para dhe pas orarit shkollor, detyra shtesë në klasë dhe tërheqja e privilegjit të pjesëmarrjes në veprimtaritë dhe funksionet që zhvillohen pas orarit mësimor.

Pezullimi i Përkohshëm nga Mësuesi (*Snap Suspension*)

Nëse gjatë orës së mësimit, lëndës, ose një veprimtarie tjetër shkollore, mësuesi ka arsye të besojë që nxënësi është përfshirë në një veprimtari që pengon mësimin për vetë nxënësin ose për nxënës të tjerë, ose që nxënësi është sjellë në një mënyrë qartësisht të rrezikshme për veten apo për të tjerët, mësuesi mund të pezullojë nxënësin nga ajo orë mësimi, lëndë ose veprimtari për një kohë që mund të zgjasë deri në një ditë të plotë mësimore.

Qëndrimi në Shkollë me Përcaktim

Një mësues ose drejtori ka të drejtë të caktojë një kohë qëndrimi në shkollë për një nxënës para ose pas orarit të shkollës për arsye disiplinore ose plotësim të detyrave akademike. Njoftimi për qëndrimin e përcaktuar të nxënësit në shkollë jepet një ditë përpara, në të gjitha rastet e përcaktuara dhe nxënësi mund të mbahet në shkollë për një kohëzgjatje të arsyeshme. Është përgjegjësi e prindit/kujdestarit të organizojë transportimin për nxënësin në rastet e qëndrimit të përcaktuar në shkollë.

Projekte Pune të Veçanta

Një mësues ose administrator mund të caktojë projekte pune të veçanta si pasojë e një sjelljeje të parregullt. Projekte të tilla kanë për qëllim të konfirmojnë rëndësinë e mirësjelljes.

Pezullimi nga Shkolla

Pezullimet nga shkolla do të administrohen nga drejtori ose zëvendësi i tij/saj. Pezullimet afatshkurtra mund të ndryshojnë nga (1) një deri në (10) dhjetë ditë, në varësi të rëndësisë ose shpeshtësisë së shkeljes. Kur një pezullim është i nevojshëm dhe nëse nxënësi pezullohet nga shkolla, prindërit/kujdestarët do të njoftohen para përfundimit të ditës shkollore. Nxënësit e pezulluar nuk lejohen në pronën e qarkut shkollor ose nuk pranohen në ndonjë funksion shkollor gjatë kohës së pezullimit.

Nxënësit e pezulluar do të lejohen të kompensojnë punën e humbur siç parashikohet më sipër në këtë në këtë doracak. Përjashtimi afatgjatë dhe deri

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

në përjashtimin e përhershëm nga shkolla mund të rekomandohet nga drejtori i shkollës ose zëvendësi i tij/saj tek drejtori i qarkut.

Pezullimi nga Drejtori i shkollës

Pezullimi nga drejtori i shkollës përkufizohet si përjashtim i një nxënësi nga veprimtaritë e shkollës dhe qarkut shkollor, për arsye disiplinore, nga drejtori i shkollës për një periudhë prej (10) dhjetë ditësh shkollore ose më pak.

Prindërit/kujdestarët mund të apelojnë vendimin e drejtorit duke kërkuar që drejtori të rishqyrtojë përjashtimin nga shkolla. Për përjashtimet që zgjasin më pak se (5) pesë ditë, vendimi i drejtorit është përfundimtar. Për përjashtimet që zgjasin më shumë se (5) pesë ditë, prindërit/kujdestarët kanë të drejtë të kërkojnë një seancë apeli me Drejtorin e qarkut ose zëvendësin e tij/saj. Vendimi i drejtorit të qarkut është përfundimtar (Shih paragrafin mbi Procedurën e Rregullt). Një pezullim i tillë mund të bëhet në pritje të një hetimi të sjelljes së një nxënësi dhe rekomandimit për masa të tjera disiplinore.

Pezullimi nga Drejtori i Qarkut

Kodi i Rishikuar i Shkollës i Michigan-it (*Michigan Revised School Code*) përcakton Pezullimin nga Drejtori i Qarkut si përjashtimin e një nxënësi nga aktivitetet e shkollës dhe të qarkut për arsye disiplinore deri në 59 ditë. Ky lloj pezullimi fillon kur drejtori i një shkolle bën një rekomandim me shkrim tek drejtori i qarkut, ku specifikohet që veprimi i një nxënësi duhet të trajtohet me përjashtim për një periudhë më të gjatë se (10) dhjetë ditë. Drejtori i Qarkut mund të konfirmojë këtë rekomandim dhe të caktojë një

Përjashtim nga Drejtori i Qarkut që zgjat nga 11 deri në 59 ditë (shih paragrafin e mëposhtëm në këtë doracak.), ulë rekomandimin në (10) dhjetë ditë ose më pak, ose anulojë vendimin duke e eliminuar krejtësisht pezullimin (shih paragrafin mbi Procedurën e Rregullt).

Përjashtimi nga Drejtori i Qarkut

Kodi i Rishikuar i Shkollës i Michigan-it (*Michigan Revised School Code*) e përcakton Përjashtimin nga Drejtori i Qarkut si përjashtim të një nxënësi nga veprimtaritë e shkollës dhe qarkut shkollor për arsye disiplinore për një periudhë që zgjat 60 deri në 180 ditë. Ky lloj pezullimi fillon kur drejtori i një shkolle bën një rekomandim me shkrim tek drejtori i qarkut ku specifikohet që veprimi i një nxënësi duhet të trajtohet me përjashtim për një periudhë më të gjatë se (10) dhjetë ditë. Drejtori i Qarkut mund të: konfirmojë këtë rekomandim dhe të caktojë një Pezullim nga Drejtori i Qarkut që zgjat nga 11 deri në 59 ditë ose një Përjashtim nga Drejtori i Qarkut (shih paragrafin e mëposhtëm në këtë doracak.), ulë rekomandimin në dhjetë(10) ditë ose më

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

pak, ose anulojë vendimin duke e eliminuar krejtësisht pezullimin Vendimi i Drejtorit të Qarkut është përfundimtar. (shih paragrafin mbi Procedurën e Rregullt).

Përfundimi nga Bordi i Arsimit

Kodi i Rishikuar i Shkollës i Michigan-it (*Michigan Revised School Code*) e përcakton Përfundimin nga Bordi i Arsimit si një përfundim të përhershëm të një nxënësi nga të gjitha shkollat dhe aktivitetet publike të Michigan-it.

Ky lloj përfundimi fillon kur një drejtor shkolle rekomandon drejtorin e qarkut që veprimet e nxënësit meritojnë përfundimin definitiv sipas rregullores së qarkut dhe të Kodit të Rishikuar të Shkollës të Michigan-it (*Michigan Revised School Code*). Drejtori i qarkut mund të: konfirmojë këtë rekomandim duke rekomanduar Bordin e Arsimit që nxënësi të përfundohet përgjithmonë, ndryshojë rekomandimin në një pezullim ose përfundim nga drejtori i qarkut ose pezullim nga drejtori i shkollës, ose të refuzojë rekomandimin duke anuluar të gjitha masat disiplinore. Bordi i Arsimit mund të: konfirmojë rekomandimin e drejtorit të qarkut dhe të përfundojë përgjithmonë nxënësin, të ndryshojë rekomandimin në një pezullim/përfundim nga drejtori i qarkut ose në një pezullim nga drejtori i shkollës, ose të refuzojë rekomandimin dhe të anulujë masën disiplinore. Vendimi i Bordit Arsimor është përfundimtar.

Hetimet Policore

Shkollat Komunitare të Utitës kooperojnë me autoritetet policore lokale për mbrojtjen e interesave dhe të mirëqenies së të gjithë qytetarëve dhe të komunitetit shkolle.

Prindërit/Kujdestarët do të lajmërohen nëse forcat e rendit kërkojnë të marrin në pyetje ose arrestojnë nxënësin e tyre në shkollë. Koha e lajmërimit të Prindërve/Kujdestarëve do të varet nga rrethanat. UCS ka detyrim dhe do të raportojë tek Departamenti Arsimor i Michigan-it dhe tek forcat e rendit krimet dhe ngjarjet e specifikuar nga ligji.

Transferimi i Rekordëve Disiplinore

Ligji i Michigan-it kërkon që qarqet shkollore të regjistrojnë në rekordin e përhershëm të nxënësit (CA-60) përfundimet e përhershme për shkelje të Statutit të Michigan-it që ndalon mbajtjen e një arme të rrezikshme, zjarr-vënien ose sjelljet seksuale kriminale 380.1311(3); Rregulloren 5105 të UCS. E njëjta gjë kërkohet për nxënësit e përfunduar përgjithmonë për sulm fizik kundër një të rrituri, sulm verbal ose kërcënim me bombë (MCL 380.1311a(3); Rregulloret e UCS (5100 dhe 5105). Rekordet disiplinore (CA-60) do të transferohen në çdo shkollë private apo publike në të cilën një nxënës transferohet dhe në të cilën ai/ajo është duke u regjistruar. Pezullime dhe përfundime të tjera regjistrohen në regjistrin disiplinor të nxënësve dhe janë në dispozicion të shkollave të tjera nëse një nxënës transferohet/lëviz.

Hazing

Shkollat Komunitare të Utikës kanë rregullore që ndalojnë “hazing” si për nxënësit ashtu edhe për punonjësit e UCS.

“Hazing” është i rrezikshëm në natyrë dhe mund t'i vërë subjektet në rrezik dëmtimi fizik ose emocional. Si pasojë, “hazing” është absolutisht i ndaluar. Sipas përcaktimit, konsiderohet si “Hazing” çdo veprim ose detyrim i një tjetri – duke përfshirë viktimën – për të kryer akte që rrezikojnë sigurinë fizike të një nxënësi apo punonjësi, shkaktojnë siklet mendor ose fizik, shkaktojnë përrulje, përqeshje ose përçmim, të nxënësit ose punonjësit, pavarësisht nga dëshira e atij personi për të marrë pjesë.

Ndaj kujtudo që merr pjesë në “hazing” do të ndërmerren masa disiplinore të përshtatshme.

Bullizmi në Përgjithësi dhe ai Kibernetik

Për të ruajtur një atmosferë pozitive shkollore që promovon të mësuarit, ndihmon në krijimin e një mjedisi të sigurt mësuesor dhe zhvillon vetëvlerësimin dhe dinjitetin e nxënësve, Shkollat Komunitare të Utikës nuk do të tolerojnë sjelljen e bullizmit. Bullizmi në çfarëdo forme dhe praktike, është absolutisht i ndaluar, pa konsiderim për subjektin e trajtuar ose motivet shtytëse.

Ndaj nxënësve që marrin pjesë në bullizëm do të merren masa disiplinore të përshtatshme. Përkufizohet si bullizëm: çdo veprim i shkruar verbal ose fizik ose, çdo komunikim elektronik që ka për qëllim ose që konsiderohet nga një person i arsyeshëm si një veprim që mund të shkaktojë dëmtimin e një (1) ose më shumë nxënësve, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, duke kryer cilindo nga veprimet e mëposhtme:

1. Duke ndërhyrë në mënyrë të konsiderueshme në mundësitë arsimore, përfitimet ose programet e një ose më shumë nxënësve.
2. Duke ndikuar negativisht në aftësinë e një nxënësi për të marrë pjesë ose për të përfituar nga programet ose aktivitetet arsimore të qarkut shkollor ose të shkollës publike, duke shkaktuar tek nxënësi një frikë të arsyeshme për dëmtim fizik ose duke shkaktuar stres emocional të konsiderueshëm.
3. Duke pasur një efekt të dëmshëm faktik dhe thelbësor për shëndetin fizik ose mendor të një nxënësi.
4. Duke shkaktuar shqetësim të konsiderueshme ose ndërhyrje të konsiderueshme në funksionimin e rregullt të shkollës.

5. Bullizmi shpesh ndodh kur një nxënës ekspozohet në mënyrë të përsëritur dhe gjatë një periudhe kohore, ndaj veprimeve negative nga ana e një ose më shumë nxënësve.

Informacione shtesë gjenden në Rregulloren 5145 Kundër Bullizmit dhe në faqen e internetit të UCS.

Bandat Studentore

Bandat dhe veprimtaritë e bandave janë të ndaluara në, tek dhe nga, çdo premisë në pronësi ose në përdorim të qarkut shkollor dhe çdo veprimtari në lidhje me qarkun. Bandat dhe veprimtaritë e bandave janë gjithashtu të ndaluara deri në masën që ato lidhen, ndërhyjnë, ose kërcënojnë të ndërhyjnë, në veprimtari të shkollës apo në lidhje me qarkun, edhe në rastet kur ato ndodhin jashtë ambienteve të shkollës (për shembull, në internet).

Termi “bandë”, i përdorur në këtë rregullore, do të thotë: një grup prej dy ose më shumë personash, qëllimet apo veprimtaritë e të cilëve përfshijnë kryerjen e një akti(s) të paligjshëm ose një shkelje të rregulloreve, procedurave apo rregullave të qarkut, ose mbrojtjen e anëtarëve të saj kundër një bande apo grupi tjetër personash.

Nxënësve të qarkut u ndalohet të angazhohen në banda ose veprimtari përkatëse, në të cilat përfshihen:

1. Veshja ose krehja në një mënyrë të tillë që, sipas gjykimit të arsyeshëm të një administratori të qarkut, mësuesi ose nxënësi, komunikon përkatësinë ose anëtarësimin në një bandë.
2. Komunikimi, verbal ose jo-verbal (p.sh., gjestet, shtrëngimet e duarve, etj.) në një mënyrë të tillë që, sipas gjykimit të arsyeshëm të një administratori të qarkut, mësuesi ose nxënësi, komunikon përkatësinë ose anëtarësimin në një bandë.
3. Kryerja e një akti në mbështetje të interesit dhe veprimtarisë së një bande ose në lidhje me një bandë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me shtytjen e të tjerëve për anëtarësim, pjesëmarrje në çfarëdo veprimtarie përkatëse të një bande, frikësimi ose kërcënimi i një personi ose nxitja e një personi tjetër për të përdorur forcën, frikësimin ose kërcënimet.

Raportimi i Shqetësimeve

Nxënësit që kanë shqetësime në lidhje me çfarëdo sjelljeje apo kontakti fizik nga një person i punësuar nga qarku, një nxënës ose ndonjë person tjetër, duhet të raportojnë menjëherë këtë shqetësim tek Drejtori i shkollës, këshilltari, një i rritur i besueshëm ose tek Drejtori i Qarkut.

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

Nxënësit gjithashtu, duhet të diskutojnë shqetësimet e tyre edhe me prindërit/kujdestarët. Nxënësit inkurajohen të raportojnë çdo sjellje të sikletshme, që i bezdis ose që është në kundërshtim me një mjedis të qëndrueshëm mësimor.

Çdo person që merr një ankesë për një sjellje që është perceptuar si ngacmim seksual duhet të raportojë menjëherë atë shqetësim tek Drejtori i shkollës, Administratori Ekzekutiv i Shkollave ose tek zëvendësi i Drejtorit të Qarkut.

Rregullorja dhe Procedura e Ngacmimit Seksual

Ngacmimi seksual i nxënësve nga nxënës të tjerë ose nga punonjësit e Shkollave Komunitare të Utikës është i paligjshëm sipas ligjit të Michigan-it dhe ligjit federal, dhe është në kundërshtim me angazhimin e qarkut për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm mësimor. Rregullorja e qarkut kërkon që të gjitha marrëdhëniet midis nxënësve, mësuesve, punonjësve të tjerë të rritur dhe personave të tjerë në qark të zhvillohen me respekt për nxënësin si individ dhe të jenë të një natyre që nuk e bën nxënësin të ndihet në siklet. Ngacmimi seksual përfshin, por nuk kufizohet vetëm me pikat në vijim:

1. Kërkesa seksuale të padëshirueshme.
2. Presion i fshehtë ose i hapur për aktivitet seksual.
3. Angazhimi në kontakte fizike të papërshtatshme, të tilla si përkëdheljet ose pickimet, etj.
4. Komentet seksuale të papërshtatshme, ku përfshihen shakatë me përmbajtje seksuale të cilat krijojnë një mjedis arsimor ndrojtës, negativ ose ofendues.
5. Kërcënimi ose sugjerimi që edukimi dhe/ose përparimi i nxënësit varet nga fakti që nxënësi i nënshtrohet apo jo kërkesave seksuale apo toleron ose jo sjellje të tilla të papërshtatshme.

Informacione të mëtejshme për sulmin ose ngacmimin seksual gjenden në Rregulloret 5100 dhe 5105 të UCS.

Armët, Sjellja Kriminale Seksuale, Zjarrvënia dhe Agresioni Fizik kundrejt një Punonjësi

Sjelljet e mëposhtme, siç parashikohen nga ligjet shtetërore, janë subjekt i përjashtimit të përhershëm nga të gjitha shkollat publike në Shtetin e Michigan-it:

1. Mbajtja e një arme të rrezikshme*
2. Zjarrvënia
3. Sjellja Kriminale Seksuale**
4. Sulmi fizik në shkollë nga një nxënës i klasës së gjashtë ose më lart kundrejt një punonjësi, vullnetari ose kontraktori të shkollës

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

Ligji i Michigan-it kërkon përjashtimin e përhershëm të një nxënësi për mbajtje të një arme të rrezikshme në shkollë, nëse nuk ka prova të qarta dhe bindëse për një nga arsyet që vijojnë:

1. Nxënësi nuk e mbante objektin për ta përdorur si armë ose për t'ia dorëzuar një personi tjetër që ta përdorte si armë.
2. Nxënësi nuk ishte në dijeni të mbajtjes së armës.
3. Nxënësi nuk ishte në dijeni ose nuk kishte arsye të dinte se objekti përbënte një armë të rrezikshme.
4. Nxënësi mbante armën me sugjerimin, kërkesën, urdhrin ose lejen e shprehur të shkollës ose policisë.

Ekziston një bindje e diskutueshme që përjashtimi i përhershëm për mbajtjen e një arme të rrezikshme që është e ndryshme nga një armë zjarri (siç përcaktohet nga 18 UCS §921) në një ambient shkollor ku ndalohet armëmbajtja, nuk është i justifikueshëm nëse nuk plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

1. Qarku vërteton me shkrim që të paktën një nga faktorët e renditur më lart është vërtetuar në mënyrë të qartë dhe bindëse; dhe
2. Nxënësi nuk ka histori pezullimi apo përjashtimi.

Nxënësit me përjashtim të përhershëm siç është e lejueshme nga rregullorja e Bordit dhe ligji i Michigan-it, do t'i referohen agjencisë lokale të policisë dhe departamentit të posaçëm të qarkut për shërbimet sociale ose agjencisë komunitare të shëndetit mendor. Prindi ose kujdestari ligjor dhe nxënësi do të njoftohen gjithashtu për referimin. Për informacion të mëtejshëm konsultoni Rregulloret 5100 dhe 5105 që mund të gjenden në faqen e internetit të UCS.

**Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm që në Michigan, në varësi të rrethanave, marrëdhënia seksuale konsensuale me këdo nën moshën 16 vjeç mund të konsiderohet sjellje seksuale kriminale.

Përkufizimi i Armëve të Rrezikshme

Konsiderohet si një armë e rrezikshme: çdo armë zjarri, kamë, stiletto, thikë me një teh me gjatësi mbi tre inch (3"), një thikë xhepi që hapet me një mekanizëm, një shufër hekuri ose një dorezë prej bronzi.

Një nxënës që mban armë të konsideruara të rrezikshme, në pronën e shkollës, duhet të përjashtohet nëse ai/ajo nuk mund të vërtetojë një nga pikat e mëposhtme në mënyrë të qartë dhe bindëse:

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

1. Objekti ose instrumenti i mbajtur nga nxënësi nuk ishte mbajtur për tu përdorur si armë, apo për tu dorëzuar direkt ose indirekt tek një person tjetër për ta përdorur si armë.
2. Nxënësi nuk ishte në dijeni që mbante një armë.
3. Nxënësi nuk dinte ose nuk kishte arsye të dinte që objekti ose instrumenti që mbante konsiderohej si një armë e rrezikshme.
4. Arma mbahej nga nxënësi me sugjerimin, urdhrin, kërkesën ose lejen e shprehur të autoriteteve shkollore apo policore.

Në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren e Bordit, qarku ruan autoritetin për përjashtimin definitiv të nxënësve nga shkolla.

Përkufizimi i një Arme zjarri

Konsiderohet si armë zjarri çdo armë (duke përfshirë pistoletat sinjalizuese të garave sportive) e cila do të projektohet, është projektuar ose mund të përshtatet për të gjuajtur një plumb nëpërmjet veprimit të një eksplozivi; çdo pajisje shkatërruese ose çdo bombë me gaz shpërthyes, zjarrvënës ose helmues, granatë, raketë që ka një forcë shtytëse më të madhe se katër (4) oz (*ounces*), raketë që ka një ngarkesë shpërthyes ose zjarrvënëse më të madhe se një çerek (1/4) oz (*ounces*), minë, ose pajisje të ngjashme; ose ndonjë armë tjetër siç është përshkruar në 18 USC §921. UCS ndalon gjithashtu mbajtjen dhe përdorimin e "airsoft gun" ose "BB gun" në ambientet e shkollës.

Përkufizimi i Sulmit Fizik

Përkufizohet si një sulm fizik, përpjekja për të shkaktuar ose shkaktimi i qëllimshëm i një dëmtimi fizik të një tjetri nëpërmjet forcës ose dhunës.

Përkufizimi i Zjarrvënies

Zjarrvënia është një sjellje e dënueshme që gjithashtu përbën një shkelje penale të seksioneve 750.71 deri në 750.80 të Përmbledhjes së Ligjeve të Michigan-it (*Michigan Compiled Laws*).

Sjellja Seksuale Kriminale

Sjellja Seksuale Kriminale është një sjellje e dënueshme që gjithashtu përbën një shkelje të seksioneve 750.520b deri në 750.520e, dhe seksionit 750.520g të Përmbledhjes së Ligjeve të Michigan-it (*Michigan Compiled Laws*).

Ri-Pranimi në Shkollë (*Reinstatement*)

Nxënësit e përjashtuar përgjithmonë nga shkolla për arsye të trajtuara në këtë rregullore mund të kërkojnë të ri-pranohen. Një kërkesë e tillë për ri-pranim në shkollë nuk është subjekt i aplikimit të të drejtave, por është subjekt në varësi të

KODI I SJELLJES SE NXENESIT

vendimeve të Bordit të Arsimit. Një kërkesë për ri-pranim duhet të paraqitet me shkrim pranë Bordit të Arsimit nëpërmjet Drejtorit të Qarkut ose zëvendësit të tij/saj. Vendimi përfundimtar për ri-pranim merret nga Bordi i Arsimit.

1. Një individ që ishte në klasën e pestë ose më poshtë në momentin e përjashtimit të përhershëm dhe që është përjashtuar për mbajtje të armëve të zjarrit ose për kërcënim të një personi tjetër me armë të rrezikshme nuk duhet të ri- pranohet në shkollë përpara përmbushjes së 60 ditëve shkollore pas datës së përjashtimit.
2. Një individ që ishte në klasën e pestë ose më poshtë në momentin e përjashtimit të përhershëm dhe që është përjashtuar për një arsye të përcaktuar në nenin 1311(2) të Kodit Shkollor të Rishikuar (*Revised School Code*) të Shtetit të Michigan-it që është e ndryshme nga mbajtja e armëve të zjarrit ose kërcënimi i një personi tjetër me armë të rrezikshme, nuk duhet të ri- pranohet përpara përmbushjes së 10 ditëve shkollore pas datës së përjashtimit
3. Një individ që ishte në klasën e gjashtë ose më lart në kohën e përjashtimit të përhershëm për një vepër penale të trajtuar në rregulloren 5105, nuk duhet të ri- pranohet përpara përmbushjes së 180 ditëve shkollore pas datës së përjashtimit.

Afatet kohore dhe procedurat për depozitimin e një kërkesë për ri pranim dhe për pranimin do të jenë në përputhje me dispozitat e seksioneve 1311(6) dhe 1311a(5) të Kodit Shkollor të Rishikuar (*Revised School Code*) të Shtetit të Michigan-it. Pas ndërmarrjes së një veprimi nga Bordi i Arsimit për një kërkesë për ri pranim, duhet të kalojnë 90 ditë shkollore përpara paraqitjes së një kërkesë tjetër në lidhje me të njëjtin nxënës.

Për informacion të mëtejshëm konsultoni rregulloret 5100 dhe 5105 që mund të gjenden në faqen e internetit të UCS.

Referime: (*Gun-Free School Act - 1994*) i modifikuar nga PL 1103-382 dhe Michigan PA 250-1995.

Rregullorja e Mos-Diskriminimit

Në përputhje me Ligjin për të Drejtat Civile (*Title VI - Civil Rights Act*) të vitit 1964, Ndryshimet në arsim (*Title IX - Education Amendments*) të vitit 1972, seksionin 504 të Ligjit për Rehabilitimin (*Rehabilitation Akt*) të vitit 1973, Ligjin për Diskriminimin në bazë të Moshës (*The Age Discrimination Akt*) të vitit 1975, Ligjin për Amerikanët me Aftësi të Kufizuara (*Title II - Americans with Disabilities Akt*) të vitit 1990, Ligjin për të Drejtat Civile Elliot-Larsen (*Elliot-Larsen Civil Rights Akt*) dhe Ligjin për të Drejtat Civile të Personave me Aftësi të Kufizuara (*Persons with Disabilities Civil Rights Akt*), rregullorja e Shkollave Komunitare të Utikës siguron që asnjë person, nuk vuan diskriminim ose përjashtim nga pjesëmarrja në programet dhe shërbimet, nuk i mohohen përfitimet, ose mundësitë mësimore, ndihma për punësim ose punësimi dhe nuk diskriminohet në zbatimin e rregulloreve për sjelljen e nxënësve dhe frekuentimin, në bazë të racës, ngjyrës, fesë, origjinës kombëtare apo prejardhjes, gjinisë, moshës, paaftësisë, gjatësisë, peshës ose statusit martesor.

Çdo person që dyshon për një praktikë diskriminuese duhet të kontaktojë:

Drejtorin Ekzekutiv të Burimeve Njerëzore të Shkollave Komunitare të Utikës
11303 Greendale Sterling Heights, MI 48312
Tel: 586-797-1000

Procedurat e ankesave për shkelje të Ligjit për të Drejtat Civile (*Title VI - Civil Rights Akt*) të vitit 1964, Ndryshimet në arsim (*Title IX - Education Amendments*) të vitit 1972, seksionin 504 të Ligjit për Rehabilitimin (*Rehabilitation Akt*) të vitit 1973, Ligjin për Diskriminimin në bazë të Moshës (*The Age Discrimination Akt*) të vitit 1975, Ligjit për Amerikanët me Aftësi të Kufizuara (*Title II - Americans with Disabilities Akt*) të vitit 1990, Ligjit për të Drejtat Civile Elliot-Larsen (*Elliot-Larsen Civil Rights Akt*) dhe Ligjit për të Drejtat Civile të Personave me Aftësi të Kufizuara (*Persons with Disabilities Civil Rights Akt*), janë si më poshtë:

Çdo person që beson se Shkollat Komunitare të Utikës ose ndonjë pjesë e organizatës shkollore, ka zbatuar në mënyrë të papërshtatshme parimet dhe/ose rregulloret e (1) Ligjit për të Drejtat Civile (*Title VI - Civil Rights Akt*) të vitit 1964, (2) Ndryshimet në arsim (*Title IX - Education Amendments*) të vitit 1972, (3) Ligjit për Rehabilitimin seksionit 504 - (*Rehabilitation Akt*) të vitit 1973, (4) Ligjit për Diskriminimin në bazë të Moshës (*The Age Discrimination Akt*) të vitit 1975, (5) Title II - Ligjit për Amerikanët me Aftësi të Kufizuara

MOS-DISKRIMINIMI

(*Americans with Disabilities Act*) të vitit 1990, (6) Ligjit për të Drejtat Civile Elliot-Larsen (*Elliot-Larsen Civil Rights Act*) dhe (7) Ligjit për të Drejtat Civile të Personave me Aftësi të Kufizuara (*Persons with Disabilities Civil Rights Act*) mund të paraqesë një ankesë tek:

Drejtori Ekzekutiv i Burimeve Njerëzore i Shkollave Komunitare të Utikës
11303 Greendale Sterling Heights, MI 48312
Tel: 586-797-1000

Personi që beson se ekzistojnë baza të vlefshme për ankim mund të diskutojë ankesën në mënyrë verbale dhe jo-formale me drejtorin e shkollës ose Drejtorin Ekzekutiv të Burimeve Njerëzore, i cili nga ana e tij do të hetojë ankesën dhe do të kthejë një përgjigje brenda pesë (5) ditëve zyrtare.

Ankuesi mund të fillojë procedurat formale duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

Hapi i Parë

Një deklaratë me shkrim e ankesës, e nënshkruar nga ankuesi i dorëzohet Drejtorit Ekzekutiv të Burimeve Njerëzore brenda pesë (5) ditëve zyrtare nga marrja e përgjigjes për ankesën jo-formale. Drejtori Ekzekutiv i Burimeve Njerëzore do të hetojë më tej çështjen e ankimit dhe do t'i përgjigjet me shkrim ankuesit brenda pesë (5) ditëve zyrtare.

Hapi i Dytë

Një ankues që dëshiron të apelojë vendimin e Drejtorit Ekzekutiv të Burimeve Njerëzore mund të paraqesë një deklaratë apelimi të nënshkruar tek Drejtori i Qarkut brenda pesë (5) ditëve zyrtare pas marrjes së përgjigjes nga Drejtori Ekzekutiv. Drejtori i Qarkut ose zëvendësi i tij/saj do të takohet me të gjitha palët e përfshira, do të formulojë një konkluzion dhe do t'i përgjigjet me shkrim ankuesit brenda dhjetë (10) ditëve zyrtare pas kësaj mbledhjeje.

Drejtori Ekzekutiv i Burimeve Njerëzore, do t'i japë ankuesit, nëse ai e kërkon, një kopje të procedurës së Qarkut për ankesat, dhe do të hetojë të gjitha ankesat në përputhje me këtë procedurë. Një kopje e secilit prej Akteve dhe rregulloreve mbi të cilat bazohet njoftimi mund të gjendet në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Burimeve Njerëzore.

Raportimi i Shkeljeve

Prindërit dhe nxënësit që kualifikohen që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur mund të paraqesin një ankesë në:

Student Privacy Policy Office (Zyra e Rregullores për Privatësinë e Nxënësve)
U.S. Department of Education
400 Maryland Ave. SW Washington, D.C. 20202-4605